



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **II-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2025.**

Seanca mbahet më **28.02.2025 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigjeje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2024 (ref.nga EKZ)
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit nga DUMM për vënie në diskutim publik Draft-Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033 (ref. nga DUMM)
7. Shqyrtimi i raportit të konsultimeve publike për periudhën janar-dhjetor 2024 (ref.nga zyra për informim)
8. Informim lidhur me trajtimin e qeneve endacak (ref.nga DSHPE)

01Nr. 06-4947 2025
Klinë, me 18.02 2025



Kryesuesi i Kuvendit,
Fadil Gashi



Na osnovu člana 43, 45. i 47. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, člana 47. Statuta opštine Klina br. 01-110-1232/2010. Član 5 Administrativnog uputstva MAPL br. 02-2015 za održavanje sednica skupštine opštine kao i član 4 Pravilnika o radu Skupštine i opštinskih komisija, predsedavajući Skupštine Opštine, vrši sledeće:

OBAVEŠTENJE

Pozivaju se svi članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da učestvuju na 2 redovnu radnu sednicu Skupštine za 2025 godinu.

Sednica se održava 28.02.2025 (petak), u sali Skupštine opštine Klina sa početkom u 10 časova.

U vezi sa pitanjem neučešća na sednici, referisete se na odredbu člana 39. ZLS.

Za ovu sednicu predložen je ovaj:

DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Pitanja i odgovori,
4. Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog odbora,
5. Razmatranje i usvajanje Izveštaja o radu Izvršne vlasti za 2024. godinu (ref. iz EKZ)
6. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke DUMM-a za javnu raspravu o Nacrtu opštinskog razvojnog plana 2025-2033 (ref. od DUMM-a)
7. Razmatranje izveštaja o javnoj konsultaciji za period januar-decembar 2024 (ref. iz kancelarije za informacije)
8. Informacije u vezi sa tretmanom pasa lualica (ref. iz DSHPE)

01Br. 06-49471 2025
Klina, 18.02. 2025



Predsedavajući Skupštine
Fadil Gashi



DATE:	14.02.2025
PËR:	Kuvendin Komunal Klinë
NGA:	z. Enver Berisha, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit-Klinë
TEMA:	Propozim për Vendim

PROPOZIM

Data-De

Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal Klinë, nr. 06-21104/21, të datës 01.07.2021, për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025 – 2033 për Komunën e Klinës, Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 05/ 2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor, neni 7, paragrafi 2, mbi shqyrtimet publike, me konstatim dhe aprovim zyrtar të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozojmë Kuvendit Komunal për marrjen e vendimit për vënie në shqyrtim publik të draft Planit Zhvillimor Komunal 2025-2023 në seancën e muajit shkurt 2025.

ARSYETIM

Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033 është dokument strategjik i cili ofron zgjidhje të problemit të përgjithshëm në Komunë. Ky draft-plan përcakton kushtet zhvillimore në të gjitha aspektet në territorin e komunës, projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit publik sipas akteve dhe normave ligjore.

Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033 është një plan strategjik multisektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Ky plan zhvillimor përfshinë planin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë të caktuar tetë (8) vjeçare.

Akti i dërgohet:

- Kuvendit Komunal Klinë,
- DUMM
- Arkivit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	12.02.2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Enver.K.Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit - Komuna e Klinës
CC:	Zemun Elezaj, Kryetar i Komunës së Klinës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt-“Plani Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033”

I nderuar z. Berisha,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 (paragrafi 1.9, nën paragrafi 1.9.1) Komuna e Klinës ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 27.12.2024 me numër të protokollit 8601/24, kërkesën “për marrjen e pëlqimit për hapjen e shqyrtimit publik” të Projekt “Plani Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033”.

Sipas nenit (9 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projekt “Plani Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033” me “Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+” dhe me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Klinës sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoritetit Komunal për Planifikimit dhe Menaxhim Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.

Me respekt,





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

01-Nr. 06-3575 /2025

Klinë më dt: 03.02/2025

PËR: Komitetin për Politikë dhe Financa.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj,



NGA : Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z. Enver Berisha.

LËNDA: Kërkesë për hyrjen në rendin e ditës shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2024

Kërkojmë që të na mundësohet hyrja në rendin e ditës shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2024.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



REPUBLIC OF KOSOVO		REPUBLICA KOSOVA	
MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA			
Per periudhën e...		31, 01, 2025	
Njësia org. Unit Organ. Jed.	...	...	Vlera Amount Iznost
01-	052-3425	/25	

RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2024

Janar, 2025

PËRMBAJTJA

Hryja	Error! Bookmark not defined.
1. Ecuria e procesit të konsultimeve publike për periudhën janar-dhjetor 2024, sipas planifikimit vjetor 2024	8
3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve).....	7
4. Tabela e detajuar me numrin e takimeve, pjesëmarrësve dhe Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime.....	8
5. RAPORTI PËR TAKIMET PUBLIKE TË KRYETARIT ME QYTETARË.....	9
6. Raportit për takimet publike me qytetarë në Komunën e Klinës/Tabela e përgjithshme dhe Verifikimi i të dhënave.....	11
7. RAPORTI PËR KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKT-AKTET KOMUNALE (TAKIMET KONSULTATIVE).....	13
8. Raportit për konsultimet publike për projekt-aktet komunale (takimet konsultative) në Komunën e Klinës.....	15
9. RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE KAB 2025-2027.....	18
10. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027..	20
11. RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR BUXHETIN E VITIT.....	23
12. Raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Buxhetin e vitit 2024.....	25
13. Konsultimi publik i Buxhetit për vitin 2024, më të dhënat/kërkesat nga qytetarët të pranuar në email dhe në formë fizike.....	27
14 Përmbledhje.....	30

HYRJE

Konsultimi publik përfaqëson një proces të rëndësishëm të dialogut të hapur dhe të vazhdueshëm midis institucioneve publike dhe publikut të gjerë. Ky proces synon të përfshijë qytetarët, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, si dhe në përpunimin e dokumenteve administrative. Duke kërkuar në mënyrë aktive informacion dhe angazhim nga të gjithë aktorët e interesuar, institucionet publike krijojnë një platformë për të siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe vendimmarrje të informuar. Qëllimi i përgjithshëm i konsultimit publik është të angazhojë grupet kryesore të palëve të interesuara, siç janë qytetarët, organizatat jofitimprurëse (OJQ-të), agjencitë, autoritetet dhe grupet e nënpërfaqësuar dhe palët e ndryshme të interesit për të dhënë kontributin e tyre në proceset e planifikimit, hartimit dhe implementimit të politikave publike që ndikojnë në jetën e qytetarëve, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

Komuna e Klinës në këtë fushë të konsultimeve publike viteve të fundit ka krijuar përvoja të vlefshme në aspektin e organizimit, duke avancuar në mënyrë sistematike si në aspektin ligjor ashtu edhe në aspektin e mbajtjes së konsultimeve për një komunikim sa më të mirë me të gjitha palët e duke e intensifikuar angazhimin e saj në rritjen e numrit të takimeve por edhe në inkadrimin e kërkesave të tyre si në planet buxhetore po ashtu edhe në dokumentet strategjike.

Përkundër përpjekjeve në rritje, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje e diskutim të drejtpërdrejtë me komunën edhe pse është në rritje kohëve të fundit, vazhdimisht kërkohet më shumë angazhim nga vetë qytetarët për të arritur në nivel të kënaqshëm dhe bashkëpunim më proaktiv i audiencave ndaj konsultimeve dhe projekteve të komunës e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit.

Me qëllim të krijimit të kushteve për zbatimin e UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNA, Komuna ka krijuar mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale me anët të trajnimeve për zyrtaren përgjegjëse dhe grupet punuese të konsultimeve, kurse në raste të veçanta, siç është buxheti ka qenë i angazhuar edhe eksperti i jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të mbajtjes së konsultimeve duke filluar nga analiza gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në këtë proces si dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

Në kohën e mbajtjes së konsultimeve publike, ashtu siç parashihen edhe me planifikimin e konsultimeve për vitin paraprak, agjenda mund të jetë e ngarkuar, megjithatë komuna e Klinës inkurajon palët e interesuara të shprehin shqetësimet e tyre dhe të japin sugjerime që bashkërisht të kontribuojmë në përmirësimin e këtij procesi pas çdo proceduare të iniciuar për konsultim publik.

Mbesim të përkushtuar si institucion që gjatë këtij cikli të politikëbërjes, do të zhvillojmë mekanizma të cilët do të ndikojnë në eliminimin e pengesave dhe sigurimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara.

ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024, SIPAS PLANIFIKIMEVE

Kryetari i Komunës së Klinës në bashkëpunim me drejtoritë komunale, njësi e iniciues të tjerë të politikave, Zyrtaren përgjegjëse për Konsultim Publik si dhe Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, duke respektuar UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNA, kanë përmbushur agjendën e konsultimeve publike sipas planifikimit të konsultimeve për vitin 2024, e hartuar në janar, datë 15.01.2024, dokumenti me numër protokolli 02 Nr. 401-4743/24.

Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar e planifikimit të konsultimeve;

Nr.	Emri i konsultës	Koha e mbajtjes së konsultës
1.	DRAFT - RREGULLORE PËR TARIFA, GJOBA DHE NGARKESA KOMUNALE	MARS 2024
2.	DRAFT – RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUZE TË ZONIMIT PËR KOMUNËN E KLINËS	MARS 2024
3.	DRAFT - RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN, SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E VENDEVE TE PUNËS NE KOMUNËN E KLINËS	MARS 2024
4.	DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026).	MARS – PRILL 2024
5.	DRAFT-PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 – 2026.	PRILL 2024
6.	DRAFT – PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2024-2032	PRILL 2024

7.	DRAFT – STATUTI I QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “NËNË TEREZA”	PRILL - MAJ 2024
8.	PLOTËSIM/NDRYSHIMI I HARTAVE ZONALE TË KOMUNËS SË KLINËS	MAJ 2024
9.	TAKIMI I PARË PUBLIK ME QYTETAR I KRYETARIT TE KOMUNËS	QERSHOR 2024
10.	VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR PLANIN ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË KLINËS 2024-2032	QERSHOR – KORRIK 2024
11.	TAKIMET PUBLIKE PËR KORNIZEN AFATMESME BUXHETORE (4-5 dëgjime për KAB)	QERSHOR 2024
12.	TAKIMI PUBLIK PËR KORNIZEN AFATMESME BUXHETORE – KUVEND	QERSHOR 2024
13.	TAKIMET PUBLIKE PËR BUXHETIN E VITIT 2025	GUSHT 2024
14.	TAKIMET PUBLIKE PËR BUXHETIN E VITIT 2025 – KUVEND (4-5 dëgjime buxhetore)	SHTATOR 2024
15.	RREGULLORE PËR TRANSPARENCË TË KOMUNËS SË KLINËS dhe PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2025 – 2029	DHJETOR 2024
16.	TAKIMI I DYTË I KRYETARIT TË KOMUNËS ME QYTETARË	DHJETOR 2024
17.	DRAFT-PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS 2025-2030	I SHTUAR NGA DREJTORIA E URBANIZMIT NË FUND TË VITI 2024 DHE KONSULTIMI PUBLIK KA ZGJATUR DERI MË 6 JANAR 2025.

Gjatë takimeve konsultative sipas planifikimit, u trajtuan tema të rëndësishme që prekin zhvillimin e komunës, përfshirë:

- ✓ Planifikimin buxhetor dhe investimet kapitale
- ✓ Infrastrukturën publike dhe shërbimet komunale
- ✓ Zhvillimin ekonomik dhe mbështetjen për bizneset lokale
- ✓ Çështjet mjedisore dhe menaxhimin e mbeturinave
- ✓ Arsimin, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale

Zyrtari/a Përgjegjës për Konsultim Publik si dhe të grupet punuese kanë hartuar për secilin konsultim publik planin e brendshëm të organizmit të konsultimit, agjendën, identifikimin e palëve, identifikimin e mjeteve të komunikimit, identifikimi i burimeve, mjeteve, formave dhe mënyrave të nevojshme për procesin e konsultimit publik si dhe përmbylljen e procesit me inkuadrimin e kërkesave në lidhje me hartimin e politikave publike apo nismat administrative, elemente këto që përbejnë gjithë planifikimin e procesit të konsultimit me publikun.

Përveç takimeve të drejtpërdrejta me publikun në ambiente të ndryshme, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët nga 20 deri në 30 ditë në ueb faqen zyrtare të komunës, me vjegëz dhe kategori të veçantë të krijuar **“Konsultimet Publike”**, si dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë së Republikës së Kosovës:

Komuna Klinë: <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/>

Republika e Kosovës
Klinë

kerku këtu ALB ▼

Ballina Komuna Kuvendi Lajmet Qyteti Drejtoritë Konkursët & Njoftimet Investimet Prokurimi Dokumente Kontakti
e-Prokurimi E-Prokurimi Njoftimet

KONSULTIMET PUBLIKE

2025	2024	2023	2022	2021	2020	Tjera
	Procesverbal nga takimi i dytë (2) i konsultimit publik për RREGULLOREN PËR TRANSPARENÇË TË publikuar: 19/12/2024				Procesverbal nga takimi i dytë (2) i konsultimit publik për RREGULLOREN PËR TRANSPARENÇË TË publikuar: 19/12/2024	
	Procesverbal nga takimi i parë (1) i konsultimit publik për RREGULLOREN PËR TRANSPARENÇË TË publikuar: 19/12/2024				Procesverbal nga takimi i parë (1) i konsultimit publik për RREGULLOREN PËR TRANSPARENÇË TË publikuar: 19/12/2024	
	DRAFT-PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDISINË 2023-2030 publikuar: 17/12/2024				Njoftim për Konsultim Publik për Draft-Planin Lokal i Veprimit në Mjedisinë 2023-2030 publikuar: 17/12/2024	

Platformën e konsultimeve publike – Qeveria e Kosovës: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Materiali për konsultim publik iu është mundësuar të gjithë të interesuarve të merret në formë fizike në **Zyrën e Shërbimit për Punë të Kuvendit**, po ashtu ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të **Komunës së Klinës** si dhe në **Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike**. Në përputhje me këtë planifikim të konsultimeve publike, komuna e Klinës ka arritur ti **organizoj njëmbëdhjetë (11) prej tyre**:

1. Draft - Rregullore komunal për Tarifa, Gjoha dhe Ngarkesa në Komunën e Klinës,
2. Draft - Rregulloren për Organizimin, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës,
3. Draft- Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 – 2027), dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 – 2026),
4. Draft-Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026,
5. Draft – Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Nënë Tereza”,
6. Takimi i parë Publik me Qytetar i Kryetarit të Komunës,
7. Takimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore,
8. Takimi Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore nga Kuvendi Komunal,
9. Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Zhvillimor të Komunës së Klinës 2024-2032,
10. Takimet Publike për Draft-Buxhetin e vitit 2024,
11. Takimet Publike për Draft-Buxhetin e vitit 2024 nga Kuvendi Komunal,
12. Rregullore për Transparencë të Komunës së Klinës dhe Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025 – 2029,
13. Takimi i dytë Publik me Qytetar i Kryetarit të Komunës.
14. Draft-Planin Komunal të Veprimit në Mjedis 2025-2030,

Në planifikimin e konsultimeve për vitin 2024, sipas arsyeshmërisë së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, nuk kanë kaluar në fazën e konsultimit publik këto tre dokumente;

Draft – Rregullore Komunale për Bonuse të Zonimit për Komunën e Klinës e planifikuar të dal në Konsultim Publik, në muajin mars të vitit 2024, nuk është iniciuar me arsyetimin se ka qenë vit i cili mund të iniciohet procedura e revidimit të hartave zonale, gjë e cila rregullorja e bonuseve të iniciohet pas revidimit të hartave zonale.

Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 nuk i ka kaluar ligjshmëria e Kuvendit Komunal Klinë, të cilin MAPL e ka kthyer si vendim për rishqyrtim.

Plotësim/Ndryshimi i Hartat Zonale është iniciuar procedura fillestare në Kuvendin Komunal, vendimi i të cilit nuk ka kaluar ligjshmërinë. Andaj, nuk është ka vazhduar më

tutje dhe si i tillë nuk është organizuar konsultim publik me arsyetimin e rekomanduar nga ministria e linjës që të shkohet me revidim paraprakisht.

Ndërsa, në përputhje me nevojat po ashtu të drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në muajin dhjetor 2024, ka hartuar **Draft-Planin Komunal të Veprimit në Mjedis 2025-2030**, i cili ka kaluar procedurën e konsultimit publik, të përfunduar në janar 2025. Ky dokument nuk ka qenë pjesë e Planifikimeve për vitin 2024. Të gjitha procedurat e lartë përmendura janë të bëra publike sipas afateve kohore në web faqen zyrtare, me të gjitha dokumentet përcjellëse si njoftimin, procesverbalin, raportin etj, tek vjegëza **“Konsultimet Publike”**, linku; <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/?page=2024>.

Shtojca nr. 2 – Tabela e detajuar me numrin e takimeve, pjesëmarrësve dhe Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime.
Takime te drejtpërdrejta	35 Takime te drejtpërdrejta për periudhën janar – dhjetor 2024.	782 pjesëmarrës, 56 Gra, 726 Burra.	135 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa. 219 Kërkesa të regjistruara.
Platforma elektronike	33 Konsultime për periudhën janar – dhjetor 2024.	1 pjesëmarrës.	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa në Platformën e Konsultimeve Publike.
Me email	33 Konsultime për periudhën janar – dhjetor 2024.	7 pjesëmarrës, si dhe 54 të tjerë me petition.	46 kërkesa kanë qenë nëpërmjet emailit.

Dokumentet të cilat i janë nënshtruar konsultimit publik në web faqen e Qeveris së Kosovës për Konsultime Publike janë të gjitha prej tyre, mirëpo vlen të cekët që kjo web faqe ka qenë mjaft problematike të përdoret dhe shpesh herë jashtë funksionit. Si dëshmi, bashkëngjitet linku;

<https://konsultimet.rksgov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosePage=0>

RAPORTI PËR TAKIMET PUBLIKE TË KRYETARIT ME QYTETARË

Kryetari i Komunës së Klinës, ka mbajtur dy takime të rregullta me qytetarë, bazuar në UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR

NË KOMUNA, neni 18, “Takimet publike”, ku thuhet se; Çdo vit komuna mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. Takimi i parë obligativ mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa takimi i dytë në gjashtëmujorin e dytë. Andaj, në tabelën më poshtë janë dhënë detaje lidhur me njoftimin, takimet procesverbalet etj.

Tabela 1. Raportit për takimet publike me qytetarë në Komunën e Klinës;

Tabela e Përgjithshme			
Numri i takimeve publike me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në takimet publike (në total)	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M/F)	Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
2 Takime	Në takimin e parë morën pjesë 55 persona, Në takimin e dytë morën pjesë 39 persona, Total 94 persona.	Total 94 persona. 4 Gra, 90 Burra.	Dy procesverbale.

Verifikimi i të Dhënave			
Takimi Publik	Data e Takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Takimi i parë me qytetarë	25.06.2024	Web faqen zyrtare	Web faqen zyrtare
Takimi i dytë me qytetarë	26.12.2024	Web faqen zyrtare	Web faqen zyrtare

Linku i njoftimit të takimit të parë i publikuar; https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/Scan_2018_02_13_12_32_29_083.pdf

Linku i procesverbalit të takimit të parë i publikuar; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/Procesverbal-nga-takimi-i-kryetarit-te-komunes-me-qytetare-25.-06.-2024.pdf>

Linku i njoftimit të takimit të dytë i publikuar; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/12/Scan011.pdf>

Linku i procesverbalit të takimit të dytë i publikuar; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2025/01/Procesverbal-nga-takimi-i-dyte-i-kryetarit-te-komunes-me-qytetare-26.-12.-2024.doc>

Procesverballi i takimit të dytë të kryetarit të komunës me qytetarë, për momentin ekziston i publikuar vetëm në formatin word, pasi takimi ka qenë me datën 26.12.2024, ndërsa pritet të miratohet në seancën e rregullt të punës së Kuvendit Komunal Klinë, me datën 31 janar 2025. Pas miratimit ai do të publikohet edhe në formatin scan me numër protokolli,

RAPORTI PËR KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKT-AKTET KOMUNALE (TAKIMET KONSULTATIVE)

Komuna e Klinës për periudhën janar-dhjetor 2024, ka organizuar në total tetë (8) takime konsultative, të gjitha të bëra publike në vjeggëzën “Konsultimet Publike”, ku janë të ndara në pjesë të veçanta Njoftimet, Procesverbalet, Raportet, Projekt-propozimet, si dhe Planet e Konsultimeve. Dokumentet janë të publikuara në formatin e miratuar, SCAN, si dhe formatin e përpunimit WORD. Në këto procedura shpesh herë jemi përballur me problemet e funksionimit të web faqes zyrtare PLATFORMA E KONUSLTIMEVE PUBLIKE, e cila gjendet në kuadër të zyrës për Qeverisje të Mirë. Me qëllim të krijimit të kushteve për zbatimin e UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNA, Komuna ka krijuar mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale me anët të trajnimeve për zyrtaren përgjegjëse dhe grupet punuese të konsultimeve, kurse në raste të veçanta, siç është buxheti ka qenë i angazhuar edhe eksperti i jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të mbajtjes së konsultimeve.

Tabela 2. Raportit për konsultimet publike për projekt-aktet komunale (takimet konsultative) në Komunën e Klinës;

Tabela e përgjithshme						
Plani i konsultimeve është hartuar dhe publikuar në fillim të vitit (PO/JO)	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projekt akteve për të cilat është organizuar konsultim publik	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (total) (M.F)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara
PO	8 Projekt-akte Komunale.	Për të gjitha projekt aktet është organizuar konsultim publik.	Total 196, 97 Gra, 99 Bura.	42 Total persona kanë dhënë komente, një prej tyre OJQ.	66 Kërkesa të regjistruara, 64 të pranuara,	8 Raporte të konsultimit të hartuara dhe publikuara.

				12 Gra, 30 burra.	37 të refuzuara, 3 pjesërisht të pranuar.	
--	--	--	--	--------------------------	--	--

Verifikimi i të dhënave				
Emërtimi i Projekt-aktit	Data e mbajtjes së konsultimit	Linku i publikimit të njoftimit, procesverbalit dhe raportit	Numri i pjesëmarrësve në total dhe i ndarë sipas gjinisë	Numri total i rekomandimeve /propozimeve si dhe të ndarë në ato të miratuara dhe jo të miratuara
1. DRAFT - RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN, SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E VENDEVE TE PUNËS NE KOMUNËN E KLINËS.	08.03.2024 25.03.2024	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 1 takim i organizuar.	Total 41 pjesëmarrës, 13 Gra, 28 Burra.	41 Kërkesa të regjistruara, 8 të pranuar, 32 të refuzuara, 1 pjesërisht e pranuar.
2. DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026).	28.03.2024 11.04.2024	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 1 takim i organizuar.	Total 15 pjesëmarrës, 12 Gra, 3 Burra.	23 Kërkesa të regjistruara, 19 të pranuar, 3 të refuzuara, 1 pjesërisht e pranuar.
3. DRAFT - RREGULLORE PËR TARIFA, GJOBA DHE NGARKESA KOMUNALE.	17.04.2024 03.05.2024	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 1 takim i organizuar.	Total 27 pjesëmarrës, 5 Gra, 22 Burra.	22 Kërkesa të regjistruara, 22 të pranuar, 0 të refuzuara.

4. DRAFT-PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 – 2026.	24.04.2024 24.05.2024	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 2 takime të organizuara.	Total 35 pjesëmarrës, 30 Gra, 5 Burra.	0 Kërkesa të regjistruara.
5. VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR PLANIN ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË KLINËS 2024-2032.	15.07.2024 15.08.2024	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 1 takim i organizuar.	Total 20 pjesëmarrës, 6 Gra, 14 Burra.	2 Kërkesa të regjistruara, 2 të pranuar, 0 të refuzuara.
6. DRAFT – STATUTI I QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “NËNË TEREZA”.	08.11.2024 29.11.2024	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 1 takim i organizuar.	Total 20 pjesëmarrës, 11 Gra, 9 Burra.	1 Kërkesa të regjistruara, 1 e refuzuar, 0 të pranuar.
7. RREGULLORE PËR TRANSPARENCË TË KOMUNËS SË KLINËS dhe PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2025 – 2029.	25.11.2025 20.12.2025	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 2 takime të organizuara.	Total 26 pjesëmarrës, 12 Gra, 14 Burra.	15 Kërkesa të regjistruara, 13 të pranuar, 1 të refuzuara, 1 pjesërisht e pranuar.
8. DRAFT-PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS 2025-2030.	17.12.2024 06.01.2025	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë. 1 takim i organizuar.	Total 12 pjesëmarrës, 8 Gra, 4 Burra.	0 Kërkesa të regjistruara.

Shtojca e veçantë e linçeve për projekt-aktet komunale (takimet konsultative), ku janë të publikuara njoftimet, procesverbalet dhe raportet;

1. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për DRAFT - RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN, SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E VENDEVE TE PUNËS NE KOMUNËN E KLINËS;

Njoftimi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/03/Njoftimi-Konsulltim-Publik.pdf>

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/04/Raporti-mbi-komentet-e-pranuara-per-rregullorene-brendshme.pdf>

Procesverbali; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/04/Procesverbali-i-debatit-publik.pdf>

2. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për DRAFT - DRAFT- STRATEGJIN KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026);

Njoftimi; https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/04/Scan_2018_02_21_15_36_48_229.pdf

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/RAPORTI-NGA-PROCESI-I-ORGANIZIMIT-TE-KONSULTIMIT-PUBLIK-PER-DRAFT-STRATEGJIA-KOMUNALE-PER-MBROJTJE-NGA-DHUNA-NE-FAMILJE-2024-%E2%80%93-2027-DHE-PLANI-I-VEPRIMIT-PER-MBROJTJE-NGA-DHUNA-NE-FAMILJE.pdf>

Procesverbali; https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/BRN30055CAC5632_20240517_153706_400209.pdf

3. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për DRAFT- RREGULLORE PËR TARIFA, GJOBA DHE NGARKESA KOMUNALE;

Njoftimi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/04/20240417141646.pdf>

Raporti; <https://kk.rksgov.net/kline/wpcontent/uploads/sites/15/2024/06/20240531154445.pdf>

Procesverbali; https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/BRN30055CAC5632_20240517_103342_400083.pdf

4. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për DRAFT-PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 – 2026;

Njoftimi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/04/20240424134538.pdf>

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/RAPORTI-NGA-PROCESI-I-ORGANIZIMIT-TE-KONSULTIMIT-PUBLIK-PER-DRAFT-PLANIN-LOKAL-TE-VEPRIMIT-PER-BARAZINE-GJINORE.pdf>

Procesverbali i takimit të parë; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/20240610095718.pdf>

Procesverbali i takimit të dytë; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/20240614112655.pdf>

5. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR PLANIN ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË KLINËS 2024-2032;

Njoftimi; https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/Scan_2018_02_20_02_32_02_403.pdf

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/10/Raporti.pdf>

Procesverbali; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/10/Procesverbali.pdf>

6. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për DRAFT – STATUTI I QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “NËNË TEREZA”;

Njoftimi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/11/NJOFTIMI-SHQIP.pdf>

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/12/RAPORTI-I-KONSULTIMIT-PER-QKMF.pdf>

Procesverbali; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/12/20241206103342.pdf>

7. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për RREGULLOREN PËR TRANSPARENCË TË KOMUNËS SË KLINËS DHE PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2025 – 2029;

Njoftimi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/11/20241125140535.pdf>

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2025/01/RAPORTI-NGA-PROCESI-I-ORGANIZIMIT-TE-KONSULTIMIT-PUBLIK-PER-RREGULLOREN-PER-TRANSPARENCE-TE-KOMUNES-SE-KLINES-DHE-PLANIN-E-VEPRIMIT-PER-TRANSPARENCE-KOMUNALE-2025-%E2%80%93-2029-WORD.pdf>

Procesverbali i takimit të parë; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/12/Procesverbal-nga-takimi-i-par.pdf>

Procesverbali i takimit të dytë; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/12/procesverbal-nga-takimi-dyte.pdf>

8. Linku i njoftimit, raportit si dhe procesverbaleve të publikuar për DRAFT-PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS 2025-2030;

Njoftimi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/12/NJOFTIMI-KONSULTIME-PUBLIKE-PVM.pdf>

Raporti; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2025/01/20250109151313.pdf>

Procesverbali; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2025/01/Procesverbal-27.12.2024-DUMM.pdf>

RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE KAB 2025-2027

Bazuar në LIGJI NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Lagjinin për Financat Publike dhe Përgjegjësit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal si dhe UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNA, Komuna e Klinës, përkatësisht Kuvendi Komunal Klinë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës kanë hapur procesin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore KAB 2025-2027, duke filluar me themelimin e grupit punues, vendim i datës 8 shkurt 2024, me numër protokolli: 01 Nr. 112-4276/2024, me gjithsej pesë anëtarë. Grupi punues ka qenë përgjegjës për hartimin e draft-dokumentit KAB 2025-2027, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga dëgjimet buxhetore dhe vendosjen lidhur me pranimin apo jo të tyre si dhe hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera që dalin nga Udhëzimi Administrativ të MAPL-ës nr. 04/2023. Pas marrjes së vendimit, grupi punues ka hartuar edhe planin e brendshëm të organizimit të debateve me publikun. Pas hartimit të planin e brendshëm të organizimit të debateve me publikun, ka realizuar kalendarin e dëgjimeve publike buxhetore me qytetarë me të gjitha detajet: vendin, kohën, emrat e fshatrave pjesëmarrëse etj. Para datës së takimeve, grupi punues ka nxjerrë edhe njoftimet për të gjitha institucionet komunale, qytetarët, OJQ-të, organizatat e biznesit, kryetarët e fshatrave të bashkësive lokale, media dhe të interesuarit tjerë për pjesëmarrje në këto takime, si dhe adresën për pjesëmarrjen me kërkesa dhe sugjerime në mënyrë elektronike. Është shfrytëzuar platforma elektronike “Platforma e Konsultimeve Publike – Zyra e Qeverisjes së Mirë”, si dhe njoftime të tjera për pranim/dorëzim të materialeve. Gjithashtu institucioni ka përdorë edhe forma kreative të

posterave për njoftim, median lokale “Klina Info”, si dhe radion lokale “Radio Alba”. Secilit takim i është montuar apo bërë edhe video për formën e organizimit, prezantimit dhe pjesëmarrjes për hire të transparencës.

Tabela 4. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027;

Tabela e Përgjithshme					
Numri i dëgjimeve e buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M/F)	Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
11 Dëgjime Buxhetore.	Në total 212 pjesëmarrës.	Në total 50 pjesëmarrës kanë ofruar propozime. 1 Grua, 49 Burra.	87 Kërkesa të regjistruara.	5 Gra, 207 Burra.	11 procesverbale të publikuara.

Verifikimi i të dhënave				
Dëgjimi buxhetor për KAB	Data e takimit	Linku i publikimit të njoftimit, procesverbali t dhe raportit	Numri i pjesëmarrësve në total dhe i ndarë sipas gjinisë	Numri total i rekomandimeve/propozimeve si dhe të ndarë në ato të miratuara dhe jo të miratuara
Takimi I-rë	31.05.2024 Ora 16:30 Vendi: Shtëpia e Fshatit, në fshatin Poterç i Epërm.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 34 pjesëmarrës, 0 Gra, 34 Burra.	5 Kërkesa të regjistruara, 4 të pranuar, 1 të refuzuara.
Takimi II-të	31.05.2024 Ora 18:00	Web faqen zyrtare,	Total 13 pjesëmarrës,	6 Kërkesa të regjistruara,

	Vendi: SHFMU "Azem Bejta", në fshatin Grabancië.	renditen në shtojcën më poshtë.	0 Gra, 13 Burra.	6 të pranuar, 0 të refuzuara.
Takimi III-të	31.05.2024 Ora 19:00 Vendi: SHFMU "Motrat Qirizai", në fshatin Zajm.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 9 pjesëmarrës, 0 Gra, 9 Burra.	6 Kërkesa të regjistruara, 5 të pranuar, 1 të refuzuara.
Takimi IV-të	03.06.2024 Ora 16:30 Vendi: SHFMU "Ali Krasniqi", në Ujmirë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 15 pjesëmarrës, 1 Gra, 14 Burra.	14 Kërkesa të regjistruara, 10 të pranuar, 4 të refuzuara.
Takimi V-të	03.06.2024 Ora 17:30 Vendi: Salla e Sporteve "Jetoni", në fshatin Gllarevë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 29 pjesëmarrës, 0 Gra, 29 Burra.	5 Kërkesa të regjistruara, 4 të pranuar, 1 të refuzuara.
Takimi VI-të	03.06.2024 Ora 19:00 Vendi: SHFMU "Tre Dëshmorët", në fshatin Jashanicë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 17 pjesëmarrës, 0 Gra, 17 Burra.	6 Kërkesa të regjistruara, 5 të pranuar, 1 të refuzuara.
Takimi VII-të	10.06.2024 Ora 16:30 Vendi: SHFMU "Atë Gjergj Fishta", në fshatin Jagodë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 25 pjesëmarrës, 0 Gra, 25 Burra.	12 Kërkesa të regjistruara, 12 të pranuar, 0 të refuzuara.

Takimi VIII-të	10.06.2024 Ora 17:30 Vendi: SHFMU “Atë Shtejfën Gjeçovi”, në fshatin Zllakuqan.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 17 pjesëmarrës, 3 Gra, 14 Burra.	11 Kërkesa të regjistruara, 8 të pranuar, 3 të refuzuara.
Takimi IX-të	10.06.2024 Ora 19:00 Vendi: SHFMU “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 20 pjesëmarrës, 0 Gra, 20 Burra.	4 Kërkesa të regjistruara, 4 të pranuar, 0 të refuzuara.
Takimi X-të	12.06.2024 Ora 17:00 Vendi: Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e lagjeve të qytetit.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 30 pjesëmarrës, 0 Gra, 30 Burra.	6 Kërkesa të regjistruara, 6 të pranuar, 0 të refuzuara.
Takimi XI-të	25.06.2024 Ora 10:00 Vendi: Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm qytetarë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 33 pjesëmarrës, 1 Gra, 33 Burra.	3 Kërkesa të regjistruara, 3 të pranuar, 0 të refuzuara.

Shtojca e veçantë e linçeve për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore, ku janë të publikuara **njoftimet, procesverbalet dhe raportet;**

Plani i organizimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore;
<https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/20240531095329.pdf>

Njoftimi me ekzekutivin; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/Njoftim-i-Degjimeve-Buxhetore-KAB.pdf>

Njoftimi i veçantë i Kuvendit Komunal; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/Ftese-per-Debat-me-Publikun-25.06.2024.pdf>

Projekt-akti Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/05/634-Klina-DRAFT-KAB-2025-2027.docx>

Procesverbali i takimit të parë (1); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/PROCESVERBALI-1-TAKIMI-POTERQ.pdf>

Procesverbali i takimit të dytë (2); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/PROCESVERBALI-2-TAKIMI-GRABANICE.pdf>

Procesverbali i takimit të tretë (3); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/PROCESVERBALI-3-TAKIMI-ZAJM.pdf>

Procesverbali i takimit të katërt (4); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/PROCESVERBALI-4-TAKIMI-UJMIR.pdf>

Procesverbali i takimit të pestë (5); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/PROCESVERBALI-5-TAKIMI-GLLAREVE.pdf>

Procesverbali i takimit të gjashtë (6); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/PROCESVERBALI-6-TAKIMI-JASHANICE.pdf>

Procesverbali i takimit të shtatë (7); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/20240628142954.pdf>

Procesverbali i takimit të tetë (8); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/20240628143120.pdf>

Procesverbali i takimit të nëntë (9); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/PROCESVERBALI-9-TAKIMI-SFERKE.pdf>

Procesverbali i takimit të dhjetë (10); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/06/PROCESVERBALI-10-TAKIMI-ME-LAGJE.pdf>

Procesverbal nga takimi i fundit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/11/Procesverbal-nga-mbledhja-Debat-me-Publikun-25.06.2024.pdf>

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjimet buxhetore të drejtpërdrejta, ato në formë elektronike si dhe ato të pranuar në formë fizike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa

raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 4 të këtij raporti.

PUBLIKIMI I RAPORTIT NGA ORGANIZIMI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2025-2027;

<https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/20240709101650.pdf>

RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR BUXHETIN E VITIT 2024

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Klinës, Nr. 01-110-1232/2010, të datës 07.04.2010, si dhe UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNA, komuna e Klinës ka organizuar dëgjimet buxhetore.

Grupi punues ka mbledhur komentet dhe në takimet e mbajtura me datë 13 shtator 2024 ka diskutuar kërkesat e qytetarëve dhe ka vendosur për pranimin refuzimin a po adresimin e tyre. Vlerësimi i kërkesave të qytetarëve është bërë duke pasur parasysh ndikimin e kërkesës në buxhetin e komunës ndikimin e kërkesës në komunitetin e gjerë dhe afërsisë së kërkesës me prioritetet e komunës për zonën. Grupi punues ka trajtuar edhe implikimet buxhetore të kërkesave dhe ndikimin e tyre në linjtë buxhetore.

Sipas standardeve të UA nr. 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsyetimeve që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kriterëve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon:

Pranuar: Kërkesa të cilat grupi punues i ka vlerësuar nevojë për qytetarët dhe ka rekomanduar të futen në buxhetin e komunës,

Pranuar pjesërisht: kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se ka nevojë dhe mund të përmbushen pjesërisht nga buxheti i komunës,

Refuzuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të përmbushen nga buxheti i komunës dhe janë jashtë mandatit,

Adresuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të adresohen nëpërmjet buxhetit për shkak se kërkesat adresohen nga institucionet e tjera apo mekanizmat administrativ të komunës dhe institucioneve të tjera.

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe WORD dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky raport në ditën e miratimit është bërë publik dhe i është dorëzuar Kryetarit të komunës dhe Asamblesë së Komunës së Klinës. Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar, kalendari i dëgjimeve, plani i punës, ftesat për pjesëmarrje, raportet e shkurta nga dëgjimet, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera provuese të cilat janë të listuar në fund të këtij dokumenti si anekse.

Sipas planit të punës komuna ka organizuar dhjetë dëgjime buxhetore dhe njëmbëdhjetë me takimin e Kuvendit Komunal, në të cilat kanë marrë pjesë 224 qytetarë fizikisht nëpër dëgjime, prej të cilëve 21 Gra dhe 203 Burra.

Duke përfshirë pjesëmarrësit që kontribuan në forma të tjera si me email dhe shkresa në formë fizike janë edhe 2 person me email dhe 54 persona të tjerë me Peticion (14 Gra dhe 42 Burra), kërkesë fizike, e që në total janë llogaritur gjithsej 280 kontribuues, prej të cilëve 35 Gra dhe 247 Burra.

Grupi punues ka listuar 66 kërkesa, prej të cilave, 49 janë pranuar, 10 janë refuzuar dhe 9 janë adresuar.

Tabela 5. Raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Buxhetin e vitit 2024;

Tabela e përgjithshme					
Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M/F)	Numri i procesverbalëve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
11 Dëgjime Buxhetore.	280 pjesëmarrës.	43 pjesëmarrës kanë ofruar propozime.	66 propozime të pranuar.	280 pjesëmarrës, 35 Gra, 247 Burra.	11 procesverbalëve të hartuara dhe publikuara pas takimeve.

Verifikimi i të dhënave

Dëgjimet buxhetor për Buxhetin e vitit 2024	Data e takimit	Linku i publikimit të njoftimit, procesverbalit dhe raportit	Numri i pjesëmarrësve në total dhe i ndarë sipas gjinisë	Numri total i rekomandimeve e/propozimeve si dhe të ndarë në ato të miratuara dhe jo të miratuara
Takimi I-rë	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Drenoc, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm dhe Dugajevë, datë 15.08.2024 , Ora 17:00, Vendi: SHFMU “Isa Boletini”, Drenoc.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 22 pjesëmarrës, 0 Gra, 22 Burra.	4 Kërkesa të regjistruara, 2 të pranuar, 2 të refuzuara.
Takimi II-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Qeskovë, Zajm, Këpuz, Deiq dhe fshatrat e tjera, datë 15.08.2024 , ora 18:30, Vendi: SHFMU “Azem Bejta”, Grabanicë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 28 pjesëmarrës, 0 Gra, 28 Burra.	7 Kërkesa të regjistruara, 6 të pranuar, 1 e adresuar.
Takimi III-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Volljakë dhe Sferkë, datë 16.08.2024 , ora 17:00, Vendi: SHFM “Dëshmorët”, Volljakë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 16 pjesëmarrës, 1 Gra, 15 Burra.	1 Kërkesë e regjistruara, 1 e pranuar.
Takimi IV-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus	Web faqen zyrtare, renditen	Total 16 pjesëmarrës,	5 Kërkesa të regjistruara,

	banorët e fshatit Përçevë, datë 16.08.2024 , ora 18:30, Vendi: SHFMU “Xhafer Gashi”, Përçevë.	në shtojcën më poshtë.	1 Gra, 15 Burra.	4 të pranuar, 1 e refuzuar.
Takimi V-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Shtupel, Kërmicë, Binxhë, Grabc, Dranashiq (komunitetin joshumicë), datë 19.08.2024 , ora 17:00, Vendi: SHFMU “Avni Zhabota”, Shtupel.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 27 pjesëmarrës, 1 Gra, 26 Burra.	5 Kërkesa të regjistruara, 3 të pranuar, 1 pjesërisht e pranuar, 1 e adresuar.
Takimi VI-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Budisalc, Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Videjë, Jagodë, Bërkovë, Krushevë dhe fshatrat e tjera, datë 19.08.2024 , ora 19:00, Vendi: SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, Zllakuqan.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 23 pjesëmarrës, 4 Gra, 19 Burra.	8 Kërkesa të regjistruara, 2 të pranuar, 5 të refuzuara, 1 e adresuar.
Takimi VII-të	Dëgjim publik me temë “Prioritetet e grave të komunës së Klinës, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të marginalizuara”, datë 21.08.2024 , ora 13:00,	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 13 pjesëmarrës, 12 Gra, 1 Burrë.	8 Kërkesa të regjistruara, 5 të pranuar, 3 të refuzuara.

	Vendi: SHFMU "Ismet Rraci", Klinë.			
Takimi VIII-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Gjurgjevik i Madh, Jashanicë, Dush i Vogël, Siqevë, Dobërdol dhe fshatrat e tjera, datë 21.08.2024 , ora 18:00, Vendi: SHFMU "Tre Dëshmorët", Jashanicë.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 13 pjesëmarrës, 0 Gra, 13 Burra.	7 Kërkesa të regjistruara, 7 të pranuar, 0 të refuzuara.
Takimi IX-të	Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus bujqit, fermerët, kultivuesit dhe afaristët që operojnë në Klinë, tema e diskutimit "Projektet investive në zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë", datë 22.08.2024 , ora 17:00, Vendi: Salla e Kuvendit Komunal.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 6 pjesëmarrës, 1 Gra, 5 Burra.	1 Kërkesë e regjistruar, 0 të pranuar, 1 e refuzuar.
Takimi X-të	Dëgjim i përgjithshëm me banorët e komunës së Klinës, datë 25.08.2024 , ora 17:00, Vendi: Salla e Kuvendit Komunal.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 29 pjesëmarrës, 1 Gra, 28 Burra.	9 Kërkesë e regjistruar, 8 të pranuar, 1 e adresuar.
Takimi XI-të	Dëgjim i përgjithshëm me banorët e komunës së Klinës, datë 25.08.2024 , ora 17:00, Vendi: Salla e Kuvendit Komunal.	Web faqen zyrtare, renditen në shtojcën më poshtë.	Total 33 pjesëmarrës, 7 Gra, 26 Burra.	3 Kërkesë e regjistruar, 8 të pranuar, 1 e adresuar.

Shtojca e veçantë e linçeve për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Buxhetin e vitit 2024, ku janë të publikuara **njoftimet, procesverbalet dhe raportet**;

Plani i organizimit të dëgjimeve buxhetore për Buxhetin e vitit 2024; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/20240724101435.pdf>

PDF; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/Plani-i-organizimit-te-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2025-1.pdf>

Kalendari i Dëgjimeve Buxhetore Publike për Buxhetin e vitit 2024; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/20240724101413.pdf>

Projekt-akti Draft-Buxheti për vitin 2024; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/Draft-Plani-i-Buxhetit-Komunal-te-Klines-per-vitin-2025-2027.docx>

Njoftimi nga Kuvendi dhe Ekzekutivi; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/07/NJOFTIMI-PER-BUXHET-SHQIP.pdf>

Njoftimi nga Kuvendi dhe Komiteti për Politikë dhe Financa; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/08/Ftese-per-Debat-me-Publikun-04.09.2024.pdf>

Procesverbali i takimit të parë (1); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240916105314.pdf>

Procesverbali i takimit të dytë (2); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/2.-DRAFT-PROCESVERBALI-GRABANICE.pdf>

Procesverbali i takimit të tretë (3); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240930084900.pdf>

Procesverbali i takimit të katërt (4); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240930084929.pdf>

Procesverbali i takimit të pestë (5); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240904112706.pdf>

Procesverbali i takimit të gjashtë (6); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240905084124.pdf>

Procesverbali i takimit të shtatë (7); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240906084700.pdf>

Procesverbali i takimit të tetë (8); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/8.-DRAFT-PROCESVERBALI-JASHANICE.pdf>

Procesverbali i takimit të nëntë (9); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/9.-DRAFT-PROCESVERBALI-ME-BUJQ-DHE-BIZNESE.pdf>

Procesverbali i takimit të dhjetë (10); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/10.-DRAFT-PROCESVERBALI-I-PERGJITHSHEM.pdf>

Procesverbali i takimit të njëmbëdhjetë (11); <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/11/Procesverbal-nga-Debate-me-Publikun-04.09.2024.pdf>

Grupi punës ka grumbulluar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të njëjtat pasi i ka vendosur në dokumentin punues i ka analizuar dhe komfor standardeve të përcaktuara më lartë ka vendosur për pranimin, pranime të pjesshëm, refuzimin dhe adresimin e kërkesave.

RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR DRAFT PLANIN E BUXHETIT PËR VITIN 2025:
<https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/20240930091324.pdf>

Formati në WORD; <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/09/RAPORTI-NGA-PROCESI-I-ORGANIZIMIT-TE-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PER-DRAFT-PLANIN-E-BUXHETIT-PER-VITIN-2025.docx>

Tabela 6. Konsultimi publik i Buxhetit për vitin 2024, më të dhënat/kërkesat nga qytetarët të pranuar në email dhe në formë fizike;

Publikimi në ueb-faqe / platforma	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 kërkesa e regjistruar.
Kërkesa më email të personat e caktuar	30 ditë	2 pjesëmarrës	6 kërkesa janë regjistruar.
Kërkesa në formë fizike	30 ditë	54 pjesëmarrës në Peticion.	2 kërkesa të regjistruar.

Tabela 7. Totali i kërkesave të pranuar dhe numri i kontribuuesve;

Metodat e dëgjimeve	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e	15.08.2024 58 minuta	22 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.

fshatrave Drenoc, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm dhe Dugajevë, datë 15.08.2024, ora 17:00, vendi SHFMU “Isa Boletini”, Drenoc.			4 kërkesa janë regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Qeskovë, Zajm, Këpuz, Deiq dhe fshatrat e tjera, datë 15.08.2024, ora 18:30, vendi SHFMU “Azem Bejta”, Grabanicë.	15.08.2024 39 min	28 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			7 kërkesa janë regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Volljakë dhe Sferkë, datë 16.08.2024, ora 17:00, vendi SHFMU “Dëshmorët”, Volljakë.	16.08.2024 37 min	16 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.
			1 kërkesë është regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatit Përçevë, datë 16.08.2024, ora 18:30, SHFMU “Xhafer Gashi”, Përçevë.	16.08.2024 59 min	16 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			5 kërkesa janë regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Shtupel, Kërnicë, Binxhë, Grabc, Dranashiq (komunitetin joshumicë), datë 19.08.2024, ora 17:00, vendi SHFMU “Avni Zhabota”, Shtupel.	19.08.2024 1 orë	27 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			5 kërkesa janë regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Budisalc, Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Videjë, Jagodë, Bërkovë, Krushevë dhe fshatrat e tjera, datë 19.08.2024, ora 19:00, vendi SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, Zllakuqan.	19.08.2024 1 orë e 14 min	23 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			8 kërkesa janë regjistruar.

Dëgjim publik me temë “Prioritetet e grave të komunës së Klinës, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të marginalizuara”, datë 21.08.2024, ora 13:00, vendi SHFMU “Ismet Rraci”, Klinë.	21.08.2024 56 min	13 pjesëmarrës	7 pjesëmarrëse ka parashtruar kërkesa.
			8 kërkesa janë regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Gjurgjevik i Madh, Jashanicë, Dush i Vogël, Siqevë, Dobërdol dhe fshatrat e tjera, datë 21.08.2024, ora 18:00, vendi SHFMU “Tre Dëshmorët”, Jashanicë.	21.06.2024 48 min	13 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			7 kërkesa janë regjistruar.
Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus bujqit, fermerët, kultivuesit dhe afaristët që operojnë në Klinë, tema e diskutimit “Projektet investive në zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë”, datë 22.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.	22.06.2024 32 min	6 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa.
			1 kërkesë është regjistruar.
Dëgjim i përgjithshëm me banorët e komunës së Klinë, datë 25.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.	25.06.2024 1 orë e 12 min	27 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			9 kërkesa janë regjistruar.
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal Klinë, organizuar nga Kuvendi Komunal.	04.09.2024 36 min	33 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
			3 kërkesa janë regjistruar.
Publikimi në ueb-faqe / platforma	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 kërkesa e regjistruar.

Kërkesa më email të personat e caktuar	30 ditë	2 pjesëmarrës	6 kërkesa janë regjistruar.
Kërkesa në formë fizike	30 ditë	54 pjesëmarrës në Peticion.	2 kërkesa të regjistruar.
Gjithsej:	30 ditë konsultime	280 kontribuues	66 Kërkesa

Shtojca Nr. 1 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore fizikisht të ndarë sipas gjinisë:

Femra	5
Meshkuj	207
Total:	224

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve në dëgjime në total të ndarë sipas gjinisë.

Femra	35
Meshkuj	247
Total:	280

Shtojca nr. 3 – Krahasimet me dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025:

Nr.		Buxheti 2024	Buxheti 2025
1.	Vendbanimet/Zonat	7 Dëgjime	11 Dëgjime
2.	Numri i Pjesëmarrësve	88 Pjesëmarrës	280 Pjesëmarrës
3.	Numri i Kërkesave	41 Kërkesa	66 Kërkesa
4.	Kërkesa të Pranuar	27 Kërkesa të Pranuar	49 Kërkesa të Pranuar


Gjatë debateve buxhetore për Draft – Buxhetin e vitit 2025-2027, pjesëmarrës kanë qenë **224 persona**, 2 person me email dhe **54 persona** të tjerë me Peticion, gjithsej **280 kontribuues**.

Nga të gjithë kontribuuesit, grupi punues ka regjistruar **66 kërkesa**, prej të cilave, **49 janë pranuar**, **10 janë refuzuar** dhe **9 janë adresuar**.

Përkthyer në përqindje janë këto shifra: **13.6% janë adresuar**, **15.1% janë refuzuar**, **74.2% janë pranuar**.

Shtojca Nr. 4 – Infografika e përfshirjes së kërkesave:

Trajtimi i Kërkesave



Komuna e Klinës është e përkushtuar për të siguruar që buxheti për vitin 2025 të reflektojë sa më mirë nevojat e të gjithë qytetarëve, andaj deri më sot është bërë edhe vendosja e njoftimeve në formë fizike duke mos e përjashtuar si option.

Linku: <https://www.facebook.com/KlineKomuna/posts/pfbid0Bg6tpDBsZl5B88z3eZCgg1lRocCgQ7KmiD2aNKDm6tzs6CsDSiAEG78s7KkA9r8Ml>

Komuna e Klinës ka publikuar postarët e njoftimeve në rrjetin social Facebook për hapjen e dëgjimeve buxhetore për Draft-Buxhetin e vitit 2025.

Linku: <https://www.facebook.com/KlineKomuna/posts/pfbid02lNwXc339dryWtSdCemhFbjX8Tn2ProwUSDFou3zYyyxyK8tAY66nCTqME8LzBWj1l>

Radio Alba si dhe Klina Infoo janë dy mediumet të cilat kanë promovuar postimet e Komunës së Klinës për Buxhetin e vitit 2025.

Radio Alba, linku:

<https://www.facebook.com/radioalba1/posts/pfbid02uTN7qDk1Z5ydCKnsw8dpUGXEz6ULvFcyAFzrWtVEyAz5fZK1k6QE5UmZmnsfC3sol>

Klina Infoo, linku: <https://www.klina.info/njoftim-per-degjime-buxhetore/>

Komuna e Klinës gjithashtu, për secilin takim ka bërë video gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për të pasur një dëshmi më shumë se si ka shkuar mbarëvajtja e dëgjimeve buxhetore. Linku: <https://www.facebook.com/KlineKomuna/videos>


Komuna e Klinës ka përmbyllur me sukses dëgimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore si dhe hartimin e buxhetit të vitit 2024. Gjatë këtyre dëgjimeve, qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, bizneset dhe grupet e tjera të interesit patën mundësinë të paraqesin kërkesat dhe prioritetet e tyre për investimet dhe shërbimet publike.

Procesi i dëgjimeve buxhetore është zhvilluar në mënyrë të hapur dhe transparente, duke siguruar përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara. Diskutimet u fokusuan në fusha kyçe si infrastruktura publike, arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale.

Pas analizimit të rekomandimeve dhe komenteve të pranura gjatë dëgjimeve, propozimi përfundimtar i buxhetit për vitin 2024, i është dorëzuar Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim. Komuna mbetet e përkushtuar për të siguruar një planifikim buxhetor që reflekton nevojat dhe prioritetet e qytetarëve, duke garantuar një menaxhim efikas dhe të përgjegjshëm të financave publike.

Procesin e Konsultimeve Publike për vitin 2024, në Komunën e Klinës e karakterizoi implementimi i garantuar i standardeve të UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË. Këto të dhëna do të përcjellën në njësinë përkatëse brenda Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti publikohet në faqen e komunës dhe dorëzohet në MAPL.

Vlora Tafili,
Zyrtare Përgjegjëse për Konsultim Publik



Klinë, 31.01.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org



RAPORTI I PUNËS I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2024

Klinë, shkurt 2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetarë,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush raportin e punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2024, i cili përfshinë punën një vjeçare, të arriturat e komunës, projektet dhe aktivitetet që kemi realizuar.

Viti 2024 ka qenë vit i realizimit të shumë projekteve të dobishme e të nevojshme për qytetarët, vit i realizimit të synimeve e objektivave të planifikuara, në përputhje me planin e punës, strategjinë zhvillimore dhe akteve të tjera në fuqi.

Me qëllim të përmushjes së obligimeve ligjore dhe rritjes së nivelit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit me qytetarë, gjatë vitit 2024 kam mbajtur dy takime me qytetarë, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Po ashtu, kemi organizuar kemi organizuar 20 dëgjime buxhetore për KAB dhe buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2025.

PËRMBATJA

Fjala e kryetarit.....	2
1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.....	4
2. Drejtoria e Arsimit.....	19
3. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.....	28
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....	33
5. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	40
6. Drejtoria për Punë Inspektuese.....	43
7. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	48
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	54
9. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	67
10. Drejtoria e Financave, Ekonomisë Dhe Zhvillimit.....	73

1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Raporti vjetor i punës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024 përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare të Drejtorisë së Administratës dhe njëkohësisht vështirësitë me të cilat jemi përballur gjatë këtij viti.

Megjithatë, pavarësisht sfidave, me angazhimin dhe përkushtimin tonë kemi arritur të realizojmë synimet dhe objektivat e parapara sipas Ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të Administratës Komunale, me qëllim që të arrihen objektivat e parapara në planin e Punës, për kushte sa më të mira për qytetarët e kësaj Komune.

Administrata komunale gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale për qytetarët. Ajo ka realizuar një riorganizim profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente me media, OJQ dhe shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare dhe duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim me qytetarët.

Gjatë vitit 2024, Komuna ka pasur për qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- Administratë publike në shërbim të qytetarëve
- Hapje e Komunës për qytetarët
- E drejta për t'u informuar, e cila është e drejtë e garantuar me ligj dhe që zbatohet dhe respektohet në Komunën e Klinës
- Kthimi i besimit të qytetarëve në institucionet publike përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbimet komunale
- Qytetarët të bëhen pjesë aktive e vendimeve të Komunës
- Klina me Platformë digjitale për pjesëmarrje me publikun
- Lajmërimi nga qytetarët për parregullsitë në çdo kohë dhe në çdo vend
- Qasja në dokumentet zyrtare.

Prandaj, në pajtim të plotë me planin e veprimit për vitin 2024, besojmë që të gjitha obligimet që dalin nga ky plan, në përputhshmëri të plotë me ligjet aplikative në fuqi, do t'i përmbushim me sukses edhe në vitin 2025.

Drejtoria e Administratës për vitin 2024 ka realizuar punët sipas Planit të Punës së Drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarët nga të gjitha zyrat me të cilat administron. Të specifikuar si më poshtë, janë kryer punët si në vijim:

1. SEKTORI I GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIMIT

Në Sektorin e Gjendjes Civile dhe Regjistrimit, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2024, janë kryer gjithsej 1,187 regjistrime të ndryshme, si: lindje, martesë dhe vdekje. Janë lëshuar gjithsej 37,993 lloje të certifikatave dhe akteve të tjera:

- *Aplikacione për humbje të shtetësisë: 143*

- *Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm, ndërrim të emrit dhe mbiemrit, korrigjime:*
242

Nga E-Kioska janë kryer këto shërbime:

- *Certifikata të lëshuara:* 1,496
- *Taksa të inkasuara:* 1,496.00 €.

Janë inkasuar gjithsej 42,737.60 € nga taksa administrative e Sektorit të Gjendjes Civile.
Projektet e përfunduara kapitale gjatë vitit 2024:

- *Ndërtimi dhe rinovimi i objektit të Komunës*
- *Blerja e një veture*

2. ZYRA E PROKURIMIT

Puna e Zyrës së Prokurimit është e themeluar në bazë të LPP dhe Organogramit të Komunës. Punën vet e kryen bazuar në LPP 04/L-042 dhe rregulloret në fuqi mbi Prokurimin Publik dhe Ligjin mbi menaxhimin e financave publike.

Zyra, në afatin ligjor, ka bërë planifikimin e Prokurimit Publik (PP), i cili është miratuar nga Kuvendi komunal dhe është dorëzuar në APP .

Në vitin 2024 kemi iniciuar 124 procedura të prokurimit.

Siç parashihet me nenin 9 të LPP, është bërë planifikimi i prokurimit dhe i njëjti në bazë të kërkesave të drejtorive është miratuar edhe nga asambleja Komunale, që në bazë të llojit janë:

1. <i>Inicime:</i>	<i>124 procedura</i>
2. <i>Kontrata të lidhura:</i>	<i>117</i>
3. <i>Kërkesa për qasje në dokumente:</i>	<i>23</i>
4. <i>Kërkesa për rishqyrtim:</i>	<i>34</i>
5. <i>Kërkesa për sqarim:</i>	<i>26</i>
6. <i>Procedura të anuluar:</i>	<i>20</i>
7. <i>Ankand publik:</i>	<i>1</i>
8. <i>Urdhër blerje:</i>	<i>1,598</i>

3. ZYRA LIGJORE DHE E PËRFAQËSIMIT

Gjatë vitit 2024, Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit, në bazë të rregullativës ligjore, ka kryer dhe përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë që i ka pasur në kompetencën e saj.

Në kuadër të kompetencës së saj, zyra ka kryer përfaqësimin e komunës në të gjitha shkallët e gjyqësorit në nivel vendi, duke përfshirë tërë aktivitetin e përgjegjësisë së përfaqësimit, gjegjësisht avokaturës shtetërore.

Përveç përgjegjësisë së lartcekur, Zyra Ligjore ka marrë pjesë sipas ftesave në debatet dhe takimet tjera me publikun që janë mbajtur gjatë periudhës raportuese. Zyra Ligjore, po ashtu ishte pjesë e seancave të Kuvendit të Komunës.

Gjithsej, numri i lëndëve gjyqësore është **496** lëndë të natyrave të ndryshme, duke përjashtuar ato që rrjedhin nga kontratat kolektive në arsim e shëndetësi. Gjatë vitit 2024 janë aktualizuar **11** lëndë të reja gjyqësore, si dhe janë mbajtur gjithsej **81** seanca përgatitore dhe të rregullta sipas thirrjeve nga ana e gjykatave.

Ndërsa lëndët gjyqësore që rrjedhin nga kontratat kolektive sektoriale në arsim dhe shëndetësi, të cilat janë aktualizuar viteve të fundit, gjithsej janë **1,832** lëndë të cilat janë të shpërndara tek zyrtarët përgjegjës të autorizuar.

Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit, si në vitet e mëparshme, ka përfaqësuar komunën edhe në nivelet ministrore sa i përket përfaqësimit të lëndëve konkrete administrative, ku ka lindur nevoja, po edhe këshillimeve përkatëse për të gjitha çështjet juridike. Zyrtarët e kësaj zyre kanë marr pjesë në takimet e rregullta të kolegjiut të zyrtarëve ligjorë dhe përfaqësuesve komunalë, si dhe takime tjera sipas ftesave përkatëse, në të cilat takime bëhen përpjekje për unifikimin e veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi.

Zyra Ligjore, po ashtu, në kuadër të kompetencave të veta, gjatë tërë vitit 2024 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për Zyrën e Kryetarit të Komunës, po ashtu edhe për tërë ekzekutivin komunal, si: vendime, kontrata, marrëveshje të ndryshme, autorizime dhe shkresa dhe akte të tjera të cilat renditen si më poshtë.

Sipas kërkesave për subvencionim, me rastin e lindjes së fëmijëve gjatë vitit 2024 janë aprovuar **373** kërkesa me vendime për **376** fëmijë të lindur, nga të cilat: **122** vendime për lindjen e fëmijës së parë, **104** vendime për lindjen e fëmijës së dytë, **84** vendime për lindjen e fëmijës së tretë, **41** vendime për lindjen e fëmijës së katërt, **14** vendime për lindjen e fëmijës së pestë, **4** vendime për lindjen e fëmijës së gjashtë, **3** vendime për lindjen e fëmijës së shtatë, **1** kërkesë është refuzuar me vendim si e pabazuar.

Për kompensimin e shpenzimeve të varrimit, gjatë vitit 2024 janë aprovuar **188** kërkesa si dhe **4** kërkesa janë refuzuar me vendime si të pabazuara.

Për ndihmë momentale dhe subvencionime në shëndetësi, sipas kërkesave janë aprovuar **172** kërkesa me vendime, si dhe janë hartuar **61** vendime të natyrave procedurale të ndryshme. Në total, gjatë vitit 2024 janë hartuar: **798** vendime, **12** kërkesa, **10** autorizime, **17** kontrata, **4** marrëveshje, **3** pëlqime, **12** lista, **2** përgjigje, **5** njoftime, **1** ankesë, **5** mendime juridike, si dhe disa shkresa përcjellëse.

Për të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në shërbimin e intranetit, Zyra e Kryetarit si dhe Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit, ka menaxhuar me statusin e lëndëve lidhur me vendosjen e tyre nga organet kompetente.

Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore, zyra, po ashtu ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkuara nga strukturat tjera të administratës komunale.

Për përfundim, mund të konkludojmë se Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit gjatë vitit 2024 ka pasur një aktivitet më të shtuar në përmbushjen e kompetencave ligjore të saj në respektim të ligjit.

4.SHËRBIMI PËR PUNË TË KUVENDIT

Shërbimi për Punë të Kuvendit për vitin 2024 ka përgatitur materialin për 11 seanca të rregullta dhe 2 seanca solemne, ndërsa debate me publikun janë mbajtur 2. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 janë miratuar 55 vendime, 7 plane të punës nga aktet e miratuara në kuvend pas vlerësimit të ligjshmërisë, 6 vendime janë kthyer në rishqyrtim, të cilat brenda afatit prej 30 ditësh janë rishqyrtuar në Kuvend dhe janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë.

Janë shqyrtuar raporti vjetor i punës së ekzekutivit, kuvendit, komiteteve dhe prokurimit, si dhe raporti i Auditorit të jashtëm së bashku me planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit. Janë miratuar vendime dhe rregullore të KK-së, janë shqyrtuar dhe miratuar raporte financiare. Të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë në afat të caktuar në MAPL.

Komiteti për Politikë dhe Financa: 12 (dymbëdhjetë) takime

Komiteti për Komunitete: 11 (njëmbëdhjetë) takime

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport: 0 (zero) takime

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: 0 (zero) takime

Komiteti për Shërbime Publike: 1 (një) takim

Komiteti për Pronë: 0 (zero) takime

Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim: 0 (zero) takime

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSB): 6 takime.

Takime me qytetarët – Kryetari ka mbajtur 2 takime, dhe një takim me Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.

5. ZYRA PRITËSE-ARKIVA

Nga Sektori i Zyrës Pritëse, në periudhën raportuese gjatë vitit 2024 janë regjistruar, skanuar dhe evidentuar në librin intern sipas Drejtorive:

1. Drejtoria e Administratës, gjithsej lëndë të regjistruara:	1,491
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, gjithsej lëndë të regjistruara:	74
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithsej lëndë të regjistruara:	306
4. Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, gjithsej lëndë të regjistruara:	610
5 Drejtoria për Financa, gjithsej lëndë të regjistruara:	812
6.Drejtoria e Arsimit, gjithsej lëndë të regjistruara:	1,823
7.Drejtoria e Bujqësisë, gjithsej lëndë të regjistruara:	3,627
8.Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjithsej lëndë të regjistruara:	393
9.Drejtoria e Urbanizmit, gjithsej lëndë të regjistruara:	1.032
10.Drejtoria e Inspektoratit, gjithsej lëndë të regjistruara:	296
11.Shërbimi i Kuvendit, gjithsej lëndë të regjistruara:	275
12. Presidenca, gjithsej lëndë të regjistruara:	3.286
13.Zyra e Prokurimit, gjithsej lëndë të regjistruara:	307
14. Zyra për Kthim dhe Komunitete, gjithsej lëndë të regjistruara:	57
Totali i lëndëve të regjistruara për vitin 2024 është:	14, 389 lëndë
Vlera totale e taksave të inkasuara për vitin 2024 është:	3,149.34 €

Nga ky sektor, përpos kësaj janë regjistruar dhe vërtetuar përshkrime dhe dorëshkrime gjatë kësaj periudhe, si dhe kërkesa të palëve.

Ky sektor, përpos asaj që u cek më lartë, në regjistrin e vërtetimeve, përshkrimeve dhe dorëshkrimeve, gjatë kësaj periudhe ka lëshuar edhe vërtetime, deklarata etj., me kërkesë të klientëve. Në Librin e Postës janë regjistruar dërgesa, të cilat janë dorëzuar PTK-së në Klinë.

Në regjistrin e postës në vend janë regjistruar shkresa të dala nga KK, të cilat janë shpërndarë në terren të gazetave zyrtare.

6. ZYRA E INFORMIMIT

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit. Sektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Më tej, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun mirëmban ueb-faqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

Zyra për Informim, që nga muaji janar e deri më tani ka arritur të mbulojë në terren rreth **148 ngjarje/lajme**, që përfshijnë vizita, takime e evenimente të ndryshme të të gjitha dikastereve institucionale të cilat janë shpalosur me kohë për publikun dhe mediat.

Ueb-faqja zyrtare: <https://kk.rks-gov.net/kline/lajmet/>

Gjithashtu, edhe në rrjetin social facebook: <https://ëëë.facebook.com/>

Ueb-faqja e Komunës së Klinës mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Faqja zyrtare në internet po mirëmbahet rregullisht dhe po shërben si një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm i informimit për qytetarët e komunës dhe palët tjera të interesuara.

Në periudhën e janar-dhjetor 2024, në ueb-faqe janë publikuar rreth **190 njoftime**, ku shumica prej tyre lidhen me konkurset, thirrjet publike, rezultate, njoftime për programe, lista etj.

Linku i vjegëzës “Konkurset dhe Njoftimet”; <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konkurset-e-njoftimet/?page=2024>

Hapësira e Kuvendit Komunal Klinë, në total me **150** (Njoftime, Procesverbale, Materiale dhe Vendime), linku: <https://kk.rks-gov.net/kline/category/procesverbalet/?page=2024>

Hapësira e Ekzekutivit Komunal Klinë, profili i kryetarit, në total me **110** (Vendime, Raporte dhe Marrëveshje të Bashkëpunimit), linku; <https://kk.rks-gov.net/kline/staff/zenun-elezaj/?page=2024>

Në kuadër të kategorisë së prokurimit publik, janë bërë publike **256 aktivitete të prokurimit dhe 116 kontrata publike.**

Kontratat: <https://kk.rks-gov.net/kline/category/projektet-ne-realizim/?page=2024>

Aktivitetet: <https://kk.rks-gov.net/kline/category/prokurimi/?page=2024>

Në kategorinë Dokumente janë publikuar **62 dokumente**, që janë plane të punës dhe plane veprimi, strategji, aplikacione etj.

Linku; <https://kk.rks-gov.net/kline/category/dokumente/?page=2024>



Te Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është riorganizuar vjegëza në ueb-faqe dhe tani përmban **njoftimet, procesverbalet si dhe raportet periodike.**

Linku; <https://kk.rks-gov.net/kline/keshilli-komunal-per-siguri-ne-bashkesi/?page=2024>

Për herë të parë, Komuna e Klinës ka bërë themelimin e të gjitha Këshillave Lokale, gjithsej **20** prej tyre, ku u është krijuar edhe vjegëza e veçantë “**Këshillat Komunale**”, e populluar tashmë me **41 dokumente.**

Këto ishin disa nga detajet e ueb-faqes zyrtare të Komunës së Klinës, me domenin kk.rks-gov.net

<https://kk.rks-gov.net/kline/>, ndërsa me fillim të vitit 2025, komuna e Klinës do të ketë ueb-faqen e re zyrtare me domenin kline.rks-gov.net <https://kline.rks-gov.net/>:



Kjo ueb-faqe zyrtare ka hyrë në funksion më datën **15 janar 2025**. Të gjitha dokumentet janë migruar nga kompania dizajnuese/implementuese e projektit deri më datën **3 dhjetor 2024**,

ndërsa prej asaj date e deri më tani kam arritur t'i rregulloj të gjitha vjegëzat me dokumente (një nga një), si dhe t'i migroj dhe rregulloj e vetme **254 dokumente/veprime**.

Për rregullimin dhe funksionalizimin e hapësirave në ueb-faqen e re janë shtuar edhe vjegëza të tjera, të cilat nuk i posedojnë komunat e tjera, si;

1. “Regjistri Kërkesën apo Ankesën”,

2. “Kontakto Zyrtarin Përgjegjës”

3. “Politikat e Privatësisë”

Sa i përket qasjes në **Dokumente Publike**, si zyrtare përgjegjëse gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, kam pranuar **30 kërkesa**; prej tyre **29 kanë marr përgjigje dhe 1** është refuzuar.

FORMULAR I RAPORTIMIT VJETOR PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2024:

<https://kk.rks-gov.net/kline/ep-content/uploads/sites/15/2025/01/FORMULAR-I-RAPORTIMIT-VJETOR-PER-QASJE-NE-DOKUMENTE-PUBLIKE-TE-KOMUNES-SE-KLINES-PER-VITIN-2024.pdf>

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË KOMUNËN E KLINËS PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2024;

<https://kk.rks-gov.net/kline/ep-content/uploads/sites/15/2024/12/RAPORTI-JANAR-QERSHOR-2024.pdf>

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË KOMUNËN E KLINËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2024;

<https://kk.rks-gov.net/kline/ep-content/uploads/sites/15/2024/12/RAPORTI-JANAR-DHJETOR-2024.pdf>

Duke monitoruar kështu **15 fusha të rrezikut**; 4 FUSHA TË PËRGJITHSHME, si dhe 11 FUSHA TË VEÇANTA, **43 nën fusha të rrezikut**; Fusha e përgjithshme e rrezikut; 12 nën fusha, Fusha e veçantë e rrezikut; 31 nën fusha si dhe **59 masa/veprime të propozuara për zbatim (rekomandime)**.

Gjatë vitit 2022, kam marr përgjegjësi shtesë, ku bazuar në vendimet e kryetarit të komunës, të datës 30.11.2022, me numër protokolli: 01.Nr.12040699/2022, jam caktuar si **Zyrtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**. Gjatë vitit 2024, kam bërë monitorimin dhe kontrollimin e dokumenteve të cilave u kërkohet mbrojtja e të dhënave personale, si dhe kam krijuar listën e dokumenteve të publikuara në mënyrë proaktive, duke raportuar tek **Agjencia për Informim dhe Privatësi**, linku;

<https://kk.rks-gov.net/kline/ep-content/uploads/sites/15/2024/10/20241028141651.pdf>

Gjatë vitit 2024, në rolin e Zyrtares përgjegjëse për Konsultim Publik i kam udhëhequr **16 procedura konsultative apo takime me publikun**. Të gjitha këto veprime janë bërë në përputhje me UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË, duke zbatuar të gjitha kriteret në përpikëri.

Me ç'rast janë mbajtur **34 takime konsultative dhe dëgjimore me qytetarë.**

Linku; <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/?page=2024>

Në fund të vitit 2024, në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Zyra për Informim ka hartuar **RREGULLOREN PËR TRANSPARENCË TË KOMUNËS SË KLINËS**, si dhe **PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2025 – 2029**, dokumente të cilat do të procedohen tutje për miratim në seancën e rregullt të punës të muajit shkurt të Kuvendit Komunal Klinë të vitit 2025.

Në avancimin tutje të transparencës komunale, Zyra për Informim ka dhënë **5 rekomandime**, tashmë të realizuara e të cilat do të luajnë një rol poentues në raportin e performancës si dhe raportin e përmbushjes së obligimeve të komunës ndaj agjendës evropiane.

Sfidë mbetet gjithashtu edhe nevoja për t'u trajnuar tani për ueb-faqen e re e cila sapo ka hyrë në fuqi, si dhe në fushat e marketingut digjital, mbi përdorimin efikas të platformave sociale (FB, Instagram, YouTube), për personelin në ZIMP, për mobilizim dhe aktivizim të audiencës në formatet më bashkëkohore.

7. NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZBGJ-së

Zyra për Barazi Gjinore, ka përmbledhur punën e këtij viti dhe ka realizuar një sërë aktivitete të cilat kanë qenë të përmbledhura në bazë të planit të punës dhe kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të grave në fusha të ndryshme përmes debateve, fushatave, sporteve promovuese (e drejta në trashëgimi dhe pronë) rekomandimeve, punëtorive dhe bashkëpunimeve ndërkomunale në nivel regjional. Përgjatë debateve janë diskutuar tema të ndryshme, duke filluar nga barazia gjinore në familje, shkollë e shoqëri, e drejta nga marrëdhënia e punës, integrimi gjinor, komunikimi menaxherial, ngacmimet seksuale, shëndeti e mirëqenia, pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse, pozita aktuale e grave në këto procese, edukimi për feminizmin, sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programet bujqësore, dhuna në familje, mbrojtja nga trafikimi, mbrojtja nga diskriminimi, e kështu me radhë. Po ashtu, vazhdojmë të shprehim përkushtimin ndërinstitutional për të jetësuar edhe më tutje ligjin për barazi gjinore dhe ndikimin për rritjen e bashkëpunimit për qëndrueshmërinë e një shoqërie demokratike, të barabartë dhe pa diskriminim.

Nga Zyra për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me grupet punuese, gjatë vitit 2024 janë punuar dhe miratuar në Asamblenë Komunale Strategji dhe Plane Lokale të Veprimit Komunal, si:

- **Dhuna në Familje - (Strategji katërvjeçare 2024-2027)**
- **Plani i Veprimit - (Plan trevjeçar 2024-2026 për Komunën e Klinës)**

Këto dokumente janë të një rëndësie të veçantë, me ç'rast hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Klinës, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në

Familje, si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e gjithë shoqërisë sonë. Parandalimi dhe luftimi i Dhunës në Familje kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështje të ndryshme, si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj.

- **Aktivitetet, punëtoritë dhe tryezat e realizuara nga Zyra për Barazi Gjinore për vitin 2024 janë si më poshtë:**
- **8 MARS- Dita Ndërkombëtare e Gruas.** Në kuadër të të cilit në bashkëpunim me zyrën për Komunitete dhe Kthim, kemi mbajtur një sërë aktivitete, ku morën pjesë nënkryetarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Fatjona Gashi, zyrtarja për Komunitete dhe Kthim, znj. Silvia Rashkoviç, mësimdhënëse e nxënëse nga shkollat e komunës së Klinës, përfaqësuese nga Policia e Kosovës, gra përfaqësuese nga asambleja komunale, përfaqësues nga KFOR-i, gra përfaqësuese nga jeta politike dhe media.
- **TETORI – Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit.** Mamografia funksionale në QKMF – Malishevë, me staf të kompletuar, iniciativë e grupit të grave dhe ZBGJ. Shërbimet përgjatë muajit tetor ishin pa pagesë dhe mesazhi nga kabineti radiologjik në bazë të njoftimit Tetori Rozë, fton të gjitha gratë të kryejnë ekzaminimet. Janë kryer gjithsej 204 echo dhe 37 mamografi.
- **25 NËNTORI – Dita Ndërkombëtare kundër Eliminimit të Dhunës ndaj Grave.** Brenda 16 ditëve të aktivizimit janë mbajtur shumë aktivitete sensibilizuese për vetëdijësimin dhe parandalimin e dhunës me Bazë Gjinore në koordinim edhe me policinë dhe institucione të tjera publike si dhe shoqërinë civile. Janë punuar dhe shpërndarë edhe fletëpalosje të cilat shpalosin të gjitha format e mbrojtjes së grave nga dhuna.

Gjatë vitit 2024 janë organizuar shumë aktivitete, punëtori dhe tryeza tjera në Koordinim me ABGJ, Drejtoritë Komunale, Shoqëritë Civile dhe OJQ-të, si:

- Pjesëmarrëse në punëtorinë e organizuar në kuadër të projektit të OJQ HUMAN, me
temën: “Roli i psikologëve dhe prindërve në projektet shkollore”.
- Angazhimi im si anëtare e grupit punues në punëtorinë e organizuar nga zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve, **me temën:** “Hartimi i Planit Trevjeçar i Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve”.
- Punëtori dyditore e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës me Zyrtaret për Barazi Gjinore, **me temën:** “Barazia Gjinore, Trendët dhe Strategjitë e Nevojave Inventive për Ndryshim dhe Përdorimi Elektronik në Rrjete Sociale. Fuqizimi i Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërnacional për Barazi Gjinore”.

- Punëtori dy ditore e organizuar nga OSCE-ja, **me temën:** “Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë, Perspektiva Gjinore mbi Ekstremizmin Gjinor; Ndikimi i Mediave në Nxitjen e Ekstremizmit; Parandalimi i Ekstremizmit; Misogjenia (urrejtja ndaj grave dhe vajzave) Misandrija (urrejtja ndaj burrave)”.

Tryezë e organizuar nga OJQ Human, **me temën:** “Të Drejtat e Gruas në Trashëgimi”, ku në këtë tryezë ishin të pranishme të gjitha Institucionet kryesore që kishin të bëjnë me trashëgimi, si: nënkryetarja, kryetarja e Gjykatës, policia, QPS-ja, avokate, notere, zyrtare të kadastrës, zyrtarja për barazi gjinore dhe radio lokale.

- Punëtori treditore e organizuar nga UN Eëomen Kosovë dhe financuar nga Bashkimi Evropian në mbështetjen e Projektit “Gender Equality Facility”, **me temën:** “Njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e akterëve të qeverisjes lokale për t’u angazhuar në mënyrë efektive në qeverisje të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe anëtarësimin e Kosovës në BE dhe përgatitjen e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal për t’iu përmbajtur Kartës Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Lokale.”

- Punëtori treditore për zyrtarët për Barazi Gjinore nga të gjitha Komunitet e Kosovës, **me**

temën: “Promovimi i Barazisë Gjinore Përmes Teknologjisë Informative të Avancuar.”

Në këtë trajnim morën pjesë 19 zyrtarë për Barazi Gjinore (ZBGJ). Qëllimi i trajnimit ishte forcimi i kapaciteteve të pjesëmarrësve në përdorimin e teknologjisë së avancuar digjitale, ndikimin e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike në aspektin gjinor, si dhe rëndësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale për hartimin e politikave gjinore.

- Punëtori treditore nga të gjitha zyrtarët për Barazi Gjinore të 137 Komunave dhe MFPT,

me temën: “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivelet Lokale”.

- Vizitë studimore në Shqipëri, në qytetin e Tiranës dhe Elbasanit dhe shkëmbim të përvojave,

me temën: “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor”.

Qëllimi i ZBGJ-së ishte promovimi i të drejtave të barabarta të grave dhe dhuna në familje; Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit kundër dhunës në familje; Ngritja e vetëdijes për dhunë në familje; Mbështetja e infrastrukturës për mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të dhunës; Nxitja dhe vetëdijesimi i grave, vajzave mbi të drejtën e trashëgimisë; Aktivitetet për shënimin e Ditëve Ndërkombëtare, etj. Të gjitha aktivitetet janë bërë në Koordinim me ABGJ-në, Drejtoritë Komunale, Shoqëritë Civile dhe OJQ- të.

- Punëtori treditore nga të gjitha zyrtarët për Barazi Gjinore të 137 Komunave dhe MFPT, **me temën:** “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivelet Lokale”.

- Vizitë studimore në Shqipëri, në qytetin e Tiranës dhe Elbasanit dhe shkëmbim të përvojave.

Sa i përket pjesës së raportimit të Zyrës për Barazi Gjinore në Raportin e Performancës Komunale dhe të dhënave që i popullojmë në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, Zyra për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me Zyrtaren Kryesore Financiare në Drejtorinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, konstatojnë që janë mbledhur këto të dhëna për raportin financiar rreth shpenzimeve të subvencioneve në baza gjinore:

RAPORT FINANCIAR RRETH SHPENZIMEVE TË SUBVENCIONEVE NË BAZA GJINORE

1. Buxheti total i shpenzuar për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë, subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik është **679,856.95 €**.
2. Buxheti i shpenzuar për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë për gra dhe vajza, subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik është **139,137.40 €**.
3. Numri i përfituesve të përgjithshëm është **885**.
4. Numri i grave përfituese është **431**.

8 ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Duke u mbështetur në bashkëpunimin shumë të mirë me stafin e administratës së Komunës së Klinës, koordinimin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin, janë përmbushur në vazhdimësi obligimet që kam si zyrtare për IE.

Në janar është punuar Raporti vjetor i punës i ZKIE për vitin 2023, i cili i është dërguar drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Në shkurt, ua kam përcjellë të gjithëve në strukturën udhëheqëse në Komunë Draft-Raportin e përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – dhjetor 2023. Raporti ishte i përmbledhur dhe i punuar nga MAPL –Divizioni për Integrime Evropiane. Në dokument janë përfshirë aktivitetet të cilat janë përmbushur, si dhe rekomandimet për aktivitetet që duhen adresuar.

9. ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Gjatë vitit 2024 janë kryer punët si në vijim: Është përkrahur stafi i administratës komunale i Komunës së Klinës në aspektin e teknologjisë informative, duke përfshirë intervenime në pajisjen e TI-së, si: kompjuterë, printerë, monitorë, dhe pajisje tjera periferike për të mbarrëvajtur punët në normalitet dhe për të qenë sa më efikas për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Shërbimi i IT-së ka bërë instalimin e kompjuterëve të rinj të cilët janë blerë nga administrata përgjatë vitit 2024, duke instaluar softuerë të nevojshëm me konfigurimet e nevojshme, konform udhëzimeve administrative dhe ligjeve në fuqi, si dhe kur ka qenë e nevojshme janë bartur shërbimet nga pajisjet e vjetra në pajisjet e reja. Në këtë pikë, konsideroj që Komuna e Klinës ka nevojë për të ngritur kapacitetet e pajisjeve të IT-së. Janë krijuar të gjitha llogaritë për stafin e ri të Komunës së Klinës dhe, me kërkesë të personelit, janë pasivizuar llogaritë e zyrtarëve që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës ose janë pensionuar.

Është përkrahur zyrtari përgjegjës për E-Kioskë gjatë këtij viti, sa herë që është kërkuar përkrahje teknike nga ai. Serverët Ëindoës që funksionojnë në komunën e Klinës janë përditësuar (Update) sipas rekomandimeve të ASHI dhe Prodhuesit.

Po ashtu, gjatë këtij viti është bërë edhe përkrahja në aspektin teknik për Zyrat e Gjendjes Civile në terren, ku janë bërë intervenime në distanca, por në bazë të nevojave është bërë edhe intervenim lokal që të jenë funksionale të gjitha zyrat, si në aspektin e lidhjeve VPN, ashtu edhe në funksionalitetin e pajisjeve, si: kompjuterë, monitorë, printerë, fotokopjues dhe skanerë. Në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Kërkesave (SEMeK) janë regjistruar kërkesat që kanë të bëjnë me zyrën e IT-së. Tikitat e hapura gjatë këtij viti janë 390 tiketa, të cilat janë zgjidhur që nënkuptojnë intervenime në infrastrukturën e TI-së, si në rrjet, serverë, administrim të sistemeve dhe pikat fundore që përfshijnë kompjuterë, printerë, skanerë, telefonë VoIP dhe pajisje tjera periferike.

Range: January 1, 2024 - January 3, 2025 (Europe/Berlin)

Departmenti	Topics	Agjenti	
Departmenti	Të Hapura	Caktuar	Overdue [?]
Komuna Kline	390	390	23
			Të mbyllura
			390

Gjatë këtij viti është përkrahur zyra e Informimit për publikimin e materialeve në ueb-faqe çdoherë kur e kanë pasur të nevojshme ndihmën e shërbimit të IT-së, si dhe janë dhënë rekomandimet dhe është përkrahur ueb-faqja e re e Komunës, ku nga kjo zyrë është përzgjedhur edhe IT e kësaj zyre që të jetë pjesë e grupit punues, ku e ka dhënë kontributin e tij në nivel të Kosovës.

Ka përgatitur sallën e Kuvendit për seancat e rregullta të kuvendit në aspektin e Teknologjisë Informative. Kjo zyrë ka bërë instalimin e dy sërçhave CISCO të cilët janë blerë nga Komuna me rekomandimin e kësaj zyre si dhe është bërë konfigurimi i tyre duke ngritur kapacitetin dhe kualitetin e shërbimit të rrjetit në Komunë. Po ashtu, janë instaluar dhe konfiguruar edhe dy pajisje tjera Netëork Drive (Disqe të rrjetit) me redondanc RAID 1, të cilat shërbejnë si fajl serverpër shënimet. Po ashtu, janë kryer punë të tjera me kërkesë nga eprori që kanë lidhje me Teknologjinë Informative.

10. ZYRA E PRANIMIT TË MALLIT

Nga ky Sektor është kryer puna e pranimi të mallit, të gjitha hyrjet dhe daljet e materialeve shpenzuese dhe kompjuterëve, printerëve, fotokopjeve e materialeve tjera shpenzuese. Gjithashtu, janë kryer edhe raporte të pagesave në free-balanc.

12. ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2023, kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- Konkurse për Administratën dhe procedura 10
- Konkurse të Arsimit 15
- Konkurse të Shëndetësisë 1
- Ankesa në KPMSHCK 22

- *Përgjigje në ankesat e KPMKSHC-së* 22
- *Vendime të pushimeve vjetore* 138
- *Janë miratuar gjithsej* 25,648 lëndë
- *Vendime për ndërprerje vullnetare të punës* 3
- *Vendime për ndërprerje të punës (Pensionim)* 8
- *Trajnime të zhvilluara* 37
- *Vendime për pushime të lehonisë* 3
- *Vendime për pezullim vullnetar* 3
- *Aktemërimet për të gjithë shërbyesit civilë* 120
- *Në vazhdimësi është bërë digjitalizimi i dosjeve personale të nëpunësve*
- *Janë përgatitur dhe publikuar në HRMS të gjitha konkurset nga Drejtoria e Arsimit dhe Shëndetësisë*
- *Kemi marrë pjesë në trajnimet e Forumit të Menaxherëve në nivel vendi.*

13. SEKTORI TEKNIK – LOGJISTIKA

Nga ky sektor, gjatë vitit 2024, me sukses janë kryer: ruajtja e objektit të komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organe dhe palët dhe punë tjera sipas nevojës.

14. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për periudhën raportuese për vitin 2024, sipas planit të punës të NJAB, këto auditime janë kryer që të gjitha në pajtueshmëri me planin e aprovuar vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, bazuar në nevojat reale dhe gjendjen e analizuar nga Auditorët, Komiteti i Auditimit dhe menaxhmenti i Komunës, që si qëllim parësor kanë mbështetjen e organeve të Administratës së nivelit komunal, zhvillimin dhe fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike në komunë.

Krahas auditimeve të përfunduara nga NjAB, janë kryer edhe punë tjera, si:

- Përgatitja e Planit vjetor për Njësine e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025
- Përgatitja e 6 Planeve të Auditimit të punës për secilin auditim të veçantë, me formularët e duhur përcjellës
- Përgatitja e raporteve gjashtë mujore dhe raportit vjetor i punës për NjQHAB dhe Kryetarin e Komunës
- Përgatitja e 6 Planeve të Veprimit të Menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve
- Përgatitja e orareve përcjellëse të rekomandimeve për monitorim nga auditimi i brendshëm për të gjitha auditimet e përfunduara për vitin 2024
- Mbajta e takimeve të rregullta me Komitetin e Auditimit

- Bashkëpunimi me Auditorët e jashtëm rreth punës së NJAB dhe ofrimi i shënimeve të cilat janë kërkuar nga ana e tyre
- Përcjellja e trajnimeve që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm, të cilat janë të detyrueshme për ushtrimin e punës së auditorit dhe për vazhdimin e licencimit
 - Konsultime me menaxhmentin lidhur me auditimet
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për menaxhmentin dhe sektorët e veçantë
- Konsultime profesionale me NjQHAB
- Janë kryer edhe konsultime duke dhënë rekomandime gojore tjera me ekzekutivin dhe punëtorët e administratës sipas nevojës dhe kërkesave .

15. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Sa i përket gjendjes së sigurisë janar – dhjetor 2024 në Komunën e Klinës, lëvizja e qytetarëve është e lirë dhe në nivel të kënaqshëm. Nuk ka asnjë eksces në lëvizjen e lirë të komuniteteve pakicë në Komunën e Klinës. Përveç këtyre, zyra ka kryer punët e saj të përditshme në terren, duke përcjellë gjendjen dhe nevojat e të kthyerve, si dhe punët brenda zyrës.

2. DREJTORIA E ARSIMIT

Investimet Kapitale

1. Furnizimi me 61 Tabela të Mençura për Shkollat e Komunës së Klinës

Një nga investimet më të rëndësishme në vitin 2024 ka qenë furnizimi me **61 tabela të mençura** për të gjitha shkollat e Komunës së Klinës, me një vlerë prej **65,888 euro**. Këto tabela kanë mundësuar integrimin e teknologjisë në mësimdhënie, duke lejuar përdorimin e mjeteve vizuale dhe digjitale për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe angazhimin e nxënësve. Instalimi i këtyre tabelave është bërë në shkolla të ndryshme, duke siguruar akses në mësimdhënie moderne për nxënësit dhe mësuesit tanë.

2. Ndërtimi i Fushës Sportive në SHFMU “Motrat Qiriazhi” Klinë

Në kuadër të investimeve për përmirësimin e kushteve për aktivitete fizike dhe shëndetësore, është ndërtuar një **fushë sportive** në SHFMU “Motrat Qiriazhi” në Klinë. Ky investim ka pasur një vlerë prej **20,000 euro** dhe ka për qëllim krijimin e mundësive për zhvillimin e aktiviteteve sportive për nxënësit, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit dhe disiplinës fizike të tyre.

3. Furnizimi me Pompë Termike në SHFMU “Motrat Qiriazhi” dhe “IAAP Fehmi Agani” Klinë

Për të siguruar kushte të përshtatshme për mësimdhënie gjatë periudhës dimërore, janë instaluar **pompë termike** në dy shkolla të Komunës së Klinës:

- **SHFMU “Motrat Qiriazhi” Klinë** ka përfituar pompë termike në vlerë prej **60,150 euro**,
- **IAAP “Fehmi Agani” Klinë** është pajisur gjithashtu me pompë termike në vlerë prej **84,593 euro** ku 45,320.00 Euro janë paguar nga buxheti i vitit 2024 ndersa pjesa tjetër është realizuar në vitin 2023.

Ky investim ka ndihmuar në sigurimin e kushteve të ngrohta dhe të qëndrueshme gjatë dimrit për nxënësit dhe mësuesit, duke rritur komoditetin dhe duke mundësuar një ambient të përshtatshëm për mësimdhënie.

4. Renovimi i Gjimnazit “Luigj Gurakuqi” Klinë

Një tjetër investim i rëndësishëm ka qenë **renovimi i Gjimnazit “Luigj Gurakuqi”** në Klinë, me një vlerë prej **56,689.40 euro**. Ky projekt ka përfshirë riparimin dhe përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të shkollës, krijimin e kushteve të mira për mësim dhe sigurinë e nxënësve, si dhe përmirësimin e kushteve të sanitariatit dhe infrastrukturës së shkollës.

Furnizimet me Mallra dhe Shërbime

1. Transporti i Nxënësve

Një nga prioritetet kryesore të Drejtorisë së Arsimit është siguria dhe mundësitë për nxënësit që jetojnë në zona të largëta. Për këtë arsye, gjatë vitit 2024 është realizuar një investim në **transportin e nxënësve** në vlerë prej **93,977.31 euro**, i cili ka mundësuar nxënësve që të udhëtojnë në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për të shkuar në shkollat e tyre.

Transporti u sigurua në këto relacione:

- Klinafc – Klinë
- Shtupel – Klinë
- Zajm – Klinë
- Gjurgjevik i Vogël – Klinë
- Kosh – Zllakuqan
- Radulloc – Zllakuqan
- Krushevë e Madhe – Zllakuqan
- Lagjja Bakajes – Shtupel
- Qupevë e Ulët – Gremnik
- Qupevë e Lartë – Volljakë
- Dugajevë – Drenoc
- Pjetërq i Ulët – Drenoc
- Qeskovë – Këpuz
- Rastok – Këpuz
- Bokshiq – Grabanicë
- Dollovë – Grabanicë
- Shtaricë – Ujmirë
- Dobërdol – Ujmirë

- Resnik – Jashanicë
- Jelloc – Jashanic

2. **Furnizimi me materiale higjienike dhe materiale për zyrë**

Për të siguruar kushte të mira për mësimdhënie dhe administratë, janë realizuar furnizime me materiale të nevojshme:

- **Material higjenik** për shkolla në vlerë prej **8,496.90 euro**. Ky furnizim ka kontribuar në mbajtjen e higjienës dhe pastrimin e ambienteve shkollore.
- **Materiale për zyrë** për administratën shkollore në vlerë prej **7,248.94 euro** për përmirësimin e kushteve të punës dhe organizimin më të mirë të punës administrative.
- **Furnizimi me Material Sportiv**

Për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe sporteve, Drejtoria e Arsimit ka realizuar furnizimin me **material sportiv** në vlerë prej **14,438.40 euro**. Ky investim ka mundësuar zhvillimin e aktiviteteve sportive, dhe ka kontribuar në rritjen e aftësive fizike dhe shëndetit të nxënësve.

- **Furnizimi me Lëndë Djegëse për Ngrohje**

Për të siguruar ngrohjen e shkollave gjatë periudhës dimërore, është realizuar furnizimi me **lëndë djegëse për ngrohje** në vlerë prej **53,180.94 euro**, duke mundësuar që shkollat të jenë të ngrohta dhe të ofrojnë kushte të përshtatshme për mësim.

- **Furnizimi me Shtretër dhe Materiale për Çerdhe**

Për të siguruar kushte të mira për edukimin e fëmijëve të vegjël, është realizuar furnizimi me **shtretër dhe materiale të nevojshme për çerdhe** në vlerë prej **4,540 euro**, duke siguruar mundësi më të mira për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

- **Furnizimi me Bimë për Gjelbërim**

Për të krijuar një ambient më të bukur dhe të këndshëm në shkolla, është realizuar furnizimi me **bimë për gjelbërim** në vlerë prej **992 euro**, duke kontribuar në pastrimin dhe bukurinë e hapësirave shkollore.

- **Sigurimi aksidental për nxënësit e IAAP “Fehmi Agani” Klinë**

Në vitin 2024, Drejtoria e Arsimit ka siguruar një **sigurim aksidental për nxënësit** e IAAP “Fehmi Agani” Klinë gjatë zhvillimit të mësimin në vendin e punës, me një vlerë prej **1,542.24 euro**. Ky sigurim ka për qëllim mbrojtjen e nxënësve nga çdo rrezik aksidental gjatë aktiviteteve praktike në terren, duke siguruar një mjedis të sigurt për zhvillimin e aftësive profesionale. Ky investim reflekton angazhimin e Drejtorisë për sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve në procesin edukativ.

Furnizimi me inventarë për shkolla

Investime të tjera janë bërë në furnizimin me inventarë për shkollat, përfshirë:

- SHFMU “Avni Zhabota” Klinë – 6,085 euro
- Çerdhja “Xhevë Lladrovci” Klinë – 7,200 euro
- SHFMU “Azem Bejta” Grabanicë – 4,556 euro
- SHFMU “Dëshmorët” Volljakë – 5,859 euro
- SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës” Gllarevë – 9,992 euro
- SHML “Luigj Gurakuqi” Klinë – 65,312 euro

Subvencione dhe Aktivitetet e Zhvillimit Profesional

1. Trajnime për Zhvillimin Profesional të Mësuesve

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Arsimit ka organizuar **trajtime për zhvillimin profesional të mësuesve**, për të përmirësuar aftësitë profesionale dhe për të siguruar cilësi më të lartë në mësimdhënie. Këto trajnime janë zhvilluar në bashkëpunim me organizata të akredituara dhe institucione të tjera të arsimit, duke u siguruar mësuesve mjete dhe teknika moderne për të zhvilluar mësimdhënien.

2. Shpërndarja e Bursave për Studentët

Drejtoria e Arsimit ka shpërndarë **80 bursa**, secila prej **600 euro**, për studentët e Komunës së Klinës. Ky investim ka përfshirë një vlerë totale prej **48,000 euro**, dhe ka mbështetur studentët në realizimin e qëllimeve të tyre akademike.

3. Organizimi i Garave dhe Olimpiadave

Nxënësit e Komunës së Klinës kanë marrë pjesë në një sërë **garash dhe olimpiadash** në fusha të ndryshme, përfshirë gjuha shqipe, matematika, gjuha angleze, fizika, dhe lëndë të tjera shkencore. Këto aktivitete kanë nxitur zhvillimin e talenteve të nxënësve dhe kanë kontribuar në ngritjen e nivelit të edukimit.

4. Testi i Arritshmërisë dhe Provimi i Maturës Shtetërore

Drejtoria e Arsimit ka administruar me sukses **Testin e Arritshmërisë dhe Provimin e Maturës Shtetërore**, duke siguruar një vlerësim të drejtë dhe të besueshëm të përgatitjes akademike të nxënësve dhe duke kontribuar në ngritjen e standardeve të arsimit në nivel lokal dhe kombëtar.

5. Organizimi i Ditës së shkollës

Përgjatë tërë vitit 2024 është organizuar Dita e shkollës në secilën prej shkollave në Komunën e Klinës dhe ne si DKA mbështetëm shkollat për një organizim sa më të mirë duke i'u ofruar zërim dhe materiale të nevojshme.

Bashkëpunimi me KFOR dhe Policinë e Kosovës

Drejtoria e Arsimit ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me **KFOR-in** dhe **Policinë e Kosovës**, duke përfitur nga **donacionet e KFOR-it** për shkolla, si dhe duke organizuar **ligjërata për sigurinë** nga Policia e Kosovës. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në krijimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit dhe stafin arsimor dhe ka kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mësimdhënies.

Përfundimi i Raportit Vjetor të Drejtorisë së Arsimit për vitin 2024

Viti 2024 ka qenë një vit i mbushur me sfida, por edhe me arritje të mëdha për arsimin në Komunën e Klinës. Drejtoria e Arsimit ka realizuar një sërë investimesh, aktiviteteve dhe projekteve që kanë përmirësuar cilësinë e arsimit dhe kanë ofruar mundësi më të mira për nxënësit, mësuesit dhe të gjithë aktorët e arsimit në këtë komunë.

Investimet kapitale kanë qenë një nga shtyllat kryesore të angazhimit tonë, me fokus në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe ofrimin e kushteve më të mira për mësim. Furnizimi me tabela të mençura, ndërtimi i fushave sportive, renovimi i shkollave dhe pajisja

me pompë termike janë disa nga investimet që kanë kontribuar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe moderne për mësimdhënie dhe nxënie. Këto investime jo vetëm që kanë përmirësuar kushte për mësim, por gjithashtu kanë rritur angazhimin dhe motivimin e nxënësve dhe mësuesve.

Në fushën e furnizimeve me mallra dhe shërbime, Drejtoria ka mundësuar një sërë furnizimesh të rëndësishme, përfshirë transportin e nxënësve, furnizimin me materiale higjienike dhe materiale për zyrë, si dhe me lëndë djegëse për ngrohje, duke siguruar kushte të mira për të gjithë nxënësit dhe mësuesit, si në ambientet e brendshme ashtu dhe në ato të jashtme të shkollave.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm ka qenë zhvillimi i aktiviteteve të trajnimeve profesionale për mësuesit, të cilat kanë kontribuar në avancimin e kapaciteteve dhe aftësive të stafit mësimor. Këto trajnime kanë qenë një mundësi e shkëlqyer për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë së procesit edukativ.

Në aspektin e nxënësve, Drejtoria ka shpërndarë bursat për studentët dhe ka mbështetur pjesëmarrjen e nxënësve në gara dhe olimpiada shkencore. Ky përkushtim ka kontribuar në zhvillimin e talenteve dhe ka nxitur konkurrencën pozitive mes nxënësve të Komunës së Klinës.

Po ashtu, bashkëpunimi me KFOR-in dhe Policinë e Kosovës ka qenë i rëndësishëm për sigurinë dhe mbrojtjen e nxënësve dhe stafeve arsimore. Këto marrëdhënie kanë mundësuar përfitime të ndihmave dhe donacioneve për shkolla, si dhe organizimin e ligjëratave për sigurinë, që janë jetike për krijimin e një ambienti të sigurt dhe të mbrojtur për të gjithë.

Drejtoria e Arsimit ka vazhduar të angazhohet për një arsimin më të inkluziv, duke mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta dhe duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë. Po ashtu, janë realizuar aktivitete për zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, duke siguruar një përgatitje më të mirë të nxënësve për të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale.

Në përfundim, mund të themi me bindje se viti 2024 ka shënuar një progres të rëndësishëm në arsimin e Komunës së Klinës. Megjithatë, shumë sfida ende mbeten për t'u përballuar, dhe Drejtoria e Arsimit do të vazhdojë të punojë me përkushtim për të adresuar këto sfida dhe për të ofruar mundësi më të mira për çdo nxënës dhe mësues.

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vazhdueshme dhe angazhimin në këtë proces të rëndësishëm për zhvillimin e arsimit në Komunën e Klinës. Angazhimi dhe bashkëpunimi i të gjithëve janë thelbësorë për arritjen e qëllimeve tona për një arsimin më të mirë dhe të drejtë për çdo fëmijë në këtë komunë.

Drejtoria e Arsimit do të vazhdojë të punojë dhe investojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në krijimin e mundësive më të mira për zhvillimin e talentit dhe aftësive të çdo nxënësi. Me angazhim të përbashkët, ne mund të sigurojmë një të ardhme më të ndritur për të gjithë.

Raport vjetor I buxhetit 2024**KATEGORIA EKONOMIKE - PAGA DHE MEDITJE**

Institucioni	Buxheti I Aprovuar	Shpenzimi	Mjetet e pashpenzu ara	Perqin dja e realizi mit
FONDI 10	5,342,413.09	5,342,413.09	0.00	100.00
FONDI 21 TE HYRAT VETANAKE	25,750.00	25,750.00	0.0	100.00
TOTALI	5,368,163.09	5,368,163.09	0.00	100.00

KATEGORIA EKONOMIKE - MALLRA DHE SHERBIME

Institucioni	Buxheti I Aprovuar	Shpenzimi	Mjetet e pashpenzu ara	Perqin dja e realizi mit
FONDI 10	515,714.00	509,841.77	5,872.23	98.86
FONDI 21 TE HYRAT VETANAKE	43,750.00	27,007.93	16,742.07	61.73
FONDI 22 TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA	31,197.73	28,450.00	2,747.73	91.19
TOTALI	590,661.73	565,299.70	25,362.03	95.71

KATEGORIA EKONOMIKE - SHPENZIMET KOMUNALE

Institucioni	Buxheti I Aprovuar	Shpenzimi	Mjetet e pashpenzu ara	Perqin dja e realizi mit
FONDI 10	57,000.00	57,000.00	0.00	100.00
FONDI 22 TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
TOTALI	67,000.00	67,000.00	0.00	100.00

**KATEGORIA EKONOMIKE - SUBVENCIONE DHE
TRANSFERE**

Institucioni	Buxheti I Aprovuar	Shpenzimi	Mjetet e pashpenzu ara	Perqin dja e realizi mit
FONDI 10	40,000.00	39,400.00	600.00	98.50
FONDI 22 TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA	2,800.00	0.00	2,800.00	0.00
TOTALI	42,800.00	39,400.00	3,400.00	92.06

KATEGORIA EKONOMIKE - SHPENZIMET KAPITALE

Institucioni	Buxheti I Aprovuar	Shpenzimi	Mjetet e pashpenzu ara	Perqin dja e realizi mit
FONDI 10	160,000.00	148,170.00	11,830.00	92.61
FONDI 21 TE HYRAT VETANAKE	50,000.00	35,183.00	14,817.00	70.37

FONDI 22 TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA	37,500.00	36,689.40	810.60	97.84
TOTALI	247,500.00	220,042.40	27,457.60	88.91

**RAPORT I PËRMBLEDHUR I SHPENZIMEVE I TË GJITHA KATEGORIVE
EKONOMIKE SIPAS FONDEVE**

Institucioni	Buxheti I Aprovuar	Shpenzimi	Mjetet e pashpenzu ara	Perqin dja e realizi mit
FONDI 10	6,115,127.09	6,096,824.86	18,302.23	99.70
FONDI 21 TE HYRAT VETANAKE	119,500.00	87,940.93	31,559.07	73.59
FONDI 22 TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA	81,497.73	75,139.40	6,358.33	92.20
TOTALI	6,316,124.82	6,259,905.19	56,219.63	99.11

3. DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës raporton punët e realizuara gjatë vitit 2024. Gjatë këtij viti, drejtoria ka funksionuar me stafin si në vijim:

- Udhëheqësi i sektorit për Pronësi
- Udhëheqësi i sektorit për Gjeodezi
- Zyrtarët për pranimin e qytetarëve
- Zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP
- Zyrtarët ligjorë
- Zyrtari për shërbim pronëso- juridik
- Gjeodetët.

Punët kryesore të realizuara në vitin 2024:

1. Rritja e stafit punues

Janë rekrutuar gjeodetë dhe juristë shtesë për të përmirësuar kapacitetet e drejtorisë.

2. Informimi i qytetarëve

Është siguruar informimi i qytetarëve me kohë për miratimin ose refuzimin e kërkesave të tyre drejtuar Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.

3. Menaxhimi financiar

Është mbajtur një raport tabelar i pagesave mujore të realizuara nga gjeodetët, zyrtarët përgjegjëse në RDPP dhe zyrtarët në sportel.

4. Përfundimi i lëndëve të papërfunduara

Janë përmbyllur kërkesat e papërfunduara nga gjeodetët e licencuar dhe janë procesuar lëndët e legalizimit të shtëpive, objekteve dhe lokaleve në geoportal.

5. Ofrimi i shërbimeve në terren

Shërbimet e matjeve në terren janë ofruar sipas nevojës, bazuar në kërkesat e drejtorive të Komunës së Klinës.

6. Menaxhimi i lëndëve në Intranet

Janë menaxhuar lëndët përmes sistemit të brendshëm të intranetit, duke përfshirë miratimin ose refuzimin e tyre.

7. Vlerësimi i pronës dhe shpronësimi

- Është kryer vlerësimi i pronës për shpronësim dhe këmbime në zonën kadastrale Klinë/Dresnik.
- Janë kryer shpronësimet për rrugën "Malë Bashota" dhe zonën e "Malushganit"


8. Këmbimet kadastrale

Janë realizuar këmbime pronësore në zonat Klinë dhe Dresnik, duke marrë parasysh interesin e përgjithshëm publik.

Raporti sipas departamentit dhe statusit të zgjidhjes

Nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, paraqet tabelarin dhe grafikën e lëndëve sipas statusit të zgjedhjes.

<u>Drejto</u> <u>ria</u>	<u>Pranu</u> <u>ar</u>	<u>Në</u> <u>Proc</u> <u>es</u>	<u>Miratu</u> <u>ar</u>	<u>Refuzu</u> <u>ar</u>	<u>Hedh</u> <u>ur</u> <u>Posht</u> <u>ë</u>	<u>Pezullu</u> <u>ar</u>	<u>Anulu</u> <u>ar</u>	<u>Përfund</u> <u>uar</u>	<u>Tot</u> <u>ali</u>
DKGJ P	8	19	4310	31	2	42	62	0	4481



Pra, siç shihet në tabelë gjatë periudhës njëvjeçare, janar – dhjetor 2024, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur 4481 kërkesa të ndryshme përmes sistemit të

intranetit. Mirëpo, në këto nuk janë të përfshira kërkesat nga prokuroria, gjykata, policia dhe drejtoritë komunale në Komunë.

Nëse mblidhen edhe këto kërkesa, të cilat nuk janë të përfshira në sistemin intranet, numri total i kërkesave në bazë të evidencave zyrtare është 4524. Të gjitha janë të regjistruara, evidentuara dhe protokolluara.

GJATË VITIT 2024 NË DREJTORINË PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI KONSTATOJMË SE:
--

<i>Janë lëshuar 3542 certifikata të pronësisë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës</i>
--

<i>Janë lëshuar 47 certifikata që pala nuk posedon pronë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës</i>

<i>Janë lëshuar 1713 kopje të planit me pagesë nga zyrtarët përgjegjës</i>

<i>Janë lëshuar 1040 certifikata të pronësisë pa pagesë për raste sociale nga zyrtarët përgjegjës</i>
--

<i>Janë lëshuar 50 certifikata të pronësisë pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës</i>

<i>Janë lëshuar 50 kopje të planit pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës</i>
--

-Ndërsa në bazë të kërkesave, siç janë të gjeodetëve të licencuar, qoftë për ndarje-bashkim të parcelave, legalizimeve, vendosje në sistem të parcelave, historiatet, ekspertiza, aktvendime, marrëveshje të plotfuqishme të gjykatave ose organeve të tjera kompetente, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur gjithsej **610 kërkesa**.

Ndërsa, tek zyrtarët përgjegjës për regjistrimin dhe modifikimin e të dhënave në RDPP, kanë arritur gjithsej 1,300 lëndë, për të cilat janë nxjerrë vendime për secilën prej tyre. Këto përfshijnë kryesisht kontratat noteriale, lëndët e gjeodetëve dhe vendimet e gjykatës.

Për nevoja të ndryshme të qytetarëve, përveç trajtimit të kërkesave dhe kthimit të përgjigjeve për to, janë ofruar edhe shërbime të tjera, si:

- Lëshimi i certifikatave të pronësisë, certifikatave për nevoja sociale dhe certifikatave që dëshmojnë mosposedimin e pronës.
- Shërbime nga gjeodetët, duke përfshirë identifikimin e parcelave, lëshimin e kopjeve të planit, matjet për nevoja komunale dhe për kërkesa të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë.
- Sigurimi i hartave Ortofoto dhe rindërtimi i informatave kadastrale në formë digjitale.


- Ofrimi i shërbimeve përmes modelit të sistemit informativ mbi tokën dhe pronën.
- Bartja e pronësisë bazuar në dokumente valide dhe të verifikuara nga noteri, gjykata dhe vendimet e tjera të organeve administrative.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I TË HYRAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024 SIPAS MUAJVE

01.01.2024-31.12.2024, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
6421€	5588€	8273€	7005€	6717€	6563€	6418€	5529€	7714€	6125€	5597€	4636€

Të hyrat vjetore në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, nga zyrtarët në sportel, gjeodetët dhe zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP janë: 76, 586.00 Euro.



4. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

SEKTORI I KULTURËS

Sektori i kulturës gjatë tërë vitit ka realizuar punët në bazë të raportit të punës dhe disa që nuk ishin të planifikuara, të cilat po i cekim më poshtë.

- Më 21 janar u shfaq komedia “Koftë kismet” në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.

-Në muajin shkurt, kemi bërë përgatitjet për organizimin e 16-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Aktivitetet kulturore të zhvilluara:

-15.02.2024 - Ekspozitë personale e piktorit Sejdi Kapllanaj, në hollin e Galerisë së Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.

- Program artistik për fëmijë me balet dhe valle popullore, Dance with trings “Kosovë, ne të dalim zot” në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.

-16.02.2024 - Ora Letrare e Pavarësisë dhe Promovim letrar i librit të autores Antigona Desku, në sallën e Kuvendit Komunal.

- Program artistik me këngë e valle popullore, në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.
- Në muajin mars filluan përgatitjet për Festivalin Folklorik “I këndojmë lirisë”, edicioni i 22-të.
- **04.04.2024** – Dita e të Zhdukurve të Luftës në Klinë, ekspozitë përkujtimore, në hollin e Galerisë Qendra e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.
- Në prill- mbledhja e Këshillit Organizativ të Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë”, përgatitjet rreth festivalit.
- **05.04.2024** - Promovimi i librit “Koha si Violinë”, autorja Marqe Tanushi Selmanaj, në Kuvendin Komunal.
- 25.05.2024** - Trupa e teatrit “Osman R. Gashi” përfaqësoi Klinën me dramën “Nëna” në Festivalin e Teatrove në Manifestimin “Lulëkuqet e Prillit” në Kamenicë, ku u shpërblye me vendin e parë dhe aktoren më të mirë.
- **25.04.2024** - U mbajt takimi letrar dhe përrurim i veprës “Ç’është dashuria” të poetit Italian Dante Mafia.
- 25.05.2024**- Takim Letrar me shkrimtarin Agim Gjakova, bashkëorganizim me Forumin e intelektualëve “Luigj Gurakuqi” Klinë dhe ASS Club “Beqir Musliu” Gjilan.
- 28.05.2024** - Përgatitjet e fundit për shënimin e edicionit të 22-të të Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë”.
- 6-8.06.2024** - U mbajt Festivali Folklorik “I këndojmë lirisë” në Klinë, edicioni i 22- të, festival për tri netë me radhë që organizohet në ditëlindjen e komandant Mujë Krasniqit. Hapja zyrtare në Çabiq, pastaj defileu dhe programi për tri net në skenë në Sheshin “Mujë Krasniqi” ku morën pjesë ansamble, shoqëri artistike dhe rapsodë me këngë e valle. Pjesëmarrës ishin mbi 500 persona në skenë.
- 18.06.2024** – Dita e Çlirimit të Klinës, u mbajt ekspozitë kolektive e artistëve figurativë të Klinës si dhe programi artistik me këngë dhe valle e recitale, në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.
- **26.06.2024** - U mbajt Takim Ndërkulturor Letrar.

- **23-28.07.2024** - U mbajt “Camping Fest” edicioni i 6-të në Dresnik, Ujmirë, Klinë, e organizuar nga OJQ “ArtEko” e mbështetur nga Komuna Klinë- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Camping Fest promovoi trashëgiminë kulturore, zhvillimin e turizmit lokal, afirmimin e vlerave kulturore, promovimin e prodhimeve vendore etj., si Lokalitetin Arkeologjik në Dresnik, Kullën e Bekë Sylë Millakut dhe Parkun e qytetit “Irir Merturi”. Camping Fest i dedikohet edhe ditëve të diasporës.

- **27.08.2024** - U mbajt promovimi i librit “Fluturat në kafaz” i autores Antigona Desku.

- **06.09.2024** - Në sallën e Asamblesë Komunale, u organizua manifestimi tradicional “Ora e Tahir Deskut” i 15-ti me radhë, ku u shpërblye vepra më e mirë letrare dhe u nda Çmimi “Tahir Desku”.

- **04.10.2024** - U mbajt promovimi i veprave “ E kaluara në kujtesën time” dhe “ Mendime filozofike të motivuara politikisht ” të autorit Gani Morina, në bibliotekën “Kongresi i Manastirit”.

Për nder të 28 Nëntorit, më 26 Nëntor, në hollin e Galerisë së Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit” u mbajt ekspozita tradicionale “ART Klina 2024”- edicioni i nëntë.

-**26.11.2024** - U mbajt programi me këngë dhe valle në Qendrën e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.

SEKTORI I SPORTIT

Aktivitetet kanë filluar në muajin janar dhe kanë përfunduar në dhjetor, në bashkëpunim me OJQ të ndryshme që kanë qëllim të mirë për rininë e Klinës.

Gjatë vitit që lamë pas, kemi pasur takime me Departamentin e Rinisë në kuadër të MKRS-së, me organizata rinore si dhe punëtori që kanë për qëllim angazhimin e rinisë në projekte të ndryshme.

Kemi filluar me aktivitete të shumta kulturore, sportive dhe rinore. Kemi pasur edhe bashkëpunim me klube sportive, OSCE-në, me rrjetin e të rinjve si dhe bashkëpunime të ndryshme.

Aktivitetet të cilat janë mbajtur në këtë vit janë të ndryshme, me qëllimin e mirë të bashkëpunimit të rinisë dhe sportit ndërmjet veti.

Aktivitete Kulturore në bashkëpunim me Zyrën e Rinisë dhe Kulturës:

- Ora letrare, poezi, recitale me rini
- Ekspozitë në artet figurative
- Valle, këngë
- Aktivitete të tjera

Aktivitete Sportive:

Turnir për Ditën e Pavarësisë (17 Shkurt):

- Futboll për të rinjtë
 - Volejbolli për femra
 - Basketbolli për meshkuj
 - Shah-Mehmet Kryeziu
 - Ping-Pong
- Turnir për Ditën e Çlirimit të Klinës
- Turniri tradicional “Mujë Krasniqi” dhe të gjithë dëshmorët e Klinës.

Kemi pasur edhe sesione informuese në bashkëpunim me QKMF “Nënë Tereza” si dhe me Stacionin Policor, dega Klinë.

Gjithashtu, është mbajtur një aktivitet në kuadër të projektit të përbashkët "Promovimi i dialogut ndër-komunal" me komunat e regjionit të Dukagjinit. Në këtë aktivitet kanë marr pjesë komuna e Pejës, Gjakovës, Istogut, Deçanit dhe Junikut. Aktiviteti është mbajtur në Gjakovë.

Raporti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me hapësirat sportive, të cilat i ka nën menaxhim për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe garave të klubeve të Klinës që marrin pjesë në ligat përkatëse të Kosovës, është si më poshtë:

Nr.	EMRI I ASETIT	HAPËSIRA NË M²
1	Stadiumi i qytetit “18 Qershori”	15563,28
2	Fusha ndihmëse e futbollit	7700
3	Palestra sportive “Adem Jashari”	2767
4	Fusha e tenisit	290
5	Fusha e volejbollit (ambient të jashtëm me rërë)	230

		Totali: 26550.28
--	--	-------------------------

SEKTORI I RINISË

Gjatë vitit që lamë pas kemi pasur takime me Departamentin e Rinisë në kuadër të MKRS-së, me organizata rinore si dhe punëtori që kanë për qëllim angazhimin e të rinjve në projekte të ndryshme.

Kemi filluar me aktivitete të shumta kulturore, sportive dhe rinore. Kemi pasur edhe bashkëpunim me Qendrën Rinore “Ardhmëria”, OJQ Zana, OSCE-në, me rrjetin e të rinjve si dhe me bashkëpunime të ndryshme.

Aktivitetet të cilat janë mbajtur në këtë vit kanë qenë të ndryshme, me qëllimin e mirë bashkëpunimin e rinisë ndërmjet veti.

Me Qendrën Rinore “Ardhmëria” kemi pasur aktivitete të përbashkët gjatë vitit që lamë pas.

Aktivitete Kulturore në bashkëpunim me Zyrën e Sportit dhe Kulturës:

- Ora letrare, poezi, recitale me të rinjtë
- Ekspozitë në artet figurative
- Valle, këngë

ZYRA PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Zyra për Trashëgimi Kulturore ka arritur me sukses të përmbushë objektivat dhe aktivitetet të parapara në planin vjetor të punës në bashkëpunim ndër-institucional me të gjitha institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore.

Objektiva kryesore e këtij viti për Zyrën e Trashëgimisë ishte realizimi i tri projekteve për konservimin dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Komunën e Klinës. Pas aprovimit të MKRS-së, në vitin 2025 do të fillojnë punime për restaurimin e Mullirit të Isuf Halilit në Poterq të Epërm, Kullës së Gjon Mark Çunit në Dresnik, si dhe Kullës së Nue Jakut në Videjë.

Në vitin 2024 ka vazhduar Planin i Menaxhimit për Lokalitetin Arkeologjik të Dresnikut, i cili është pjesë e projektit “Ruajtja dhe Mbrojtja e Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut”, financuar nga U.S. Ambassadors Fund for Cultural Preservation (AFCP) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa implementuar nga Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës. Deri më tani janë mbajtur tri punëtori mbi menaxhimin e këtij lokaliteti, ndërsa nga viti 2025 vazhdon faza e dytë.

Projekti “Rilindja Kulturore nga liqeni i Shkodrës në Kosovë - Udhëtimi në Kohë” i financuar nga Bashkimi Evropian, MNE-Kos, partner me Komunën e Klinës, vazhdon të implementohet dhe do të përfundojë në korrik të vitit 2025.

Sa i përket promovimit të trashëgimisë kulturore në Klinë, për herë të parë kemi realizuar tryezën shkencore me temën **“Trashëgimia kulturore në Komunën e Klinës”**

ARKIVI HISTORIK I KLINËS

Në vazhden e punëve për sistemimin e lëndës arkivore, është punuar në rregullimin e materialit arkivor të disa fondeve.

Fondet e rregulluara

Emri i Fondit	Vitet	Lëndë gjatësi	Nr. kutive, librave	Nr. faqeve
Biblioteka “Kongresi i Manastirit”	1964-1991	1 m	9 Libra (Regjistra të lexuesve)	2,614
Miniera e “Boksitit”, Volljakë	1963-2015	1.2 m	7 kuti	3,467
Rindërtimi i shtëpive të djegura gjatë luftës 1998/99	2000-2005	1.5 m	15 kuti	9,016
SHFMU “Motrat Qiriazit” Klinë	1997-2000	5 m	151 libra (ditarë pune)	27,862
				Gjithsej faqe: 42, 956
				Gjithsej metra: 8.7 m

Krahas punës në rregullimin e lëndës arkivore, prioritet për arkivin ka qenë puna me palë, pranimi i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre.

Numri i kërkesave

Kërkesa të pranuar	Të realizuara	Të parealizuara për shkak të mungesës së lëndës në arkiv	Kopje A3 të lëshuara	Kopje A4 të lëshuara
112	80	32	181	149

Gjatë vitit 2024, Arkivi Historik i Klinës ka kryer edhe punë shtesë jashtë planit të punës për vitin 2024 në skanimin dhe dorëzimin e lëndës arkivore në IKKL.

Kryetari i Komunës së Klinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Krimeve të Kryera të Luftës për dorëzimin e materialit arkivor të krimeve dhe dëmeve të luftës të kryera në komunën e Klinës gjatë viteve 1998/99.

Materialet e dorëzuara dhe të skanuara nga Arkivi Historik i Klinës në IKKL Prishtinë

Emri i Fondit	Vitet	Lëndë gjatësi	Nr. kutive, fotove	Nr. faqeve
Fondi i luftës	1998/99	0.10 m	1 kuti 477 foto 2 video incizime (2 h e 47 minuta)	702
Rindërtimi i shtëpive të djegura gjatë luftës	1999-2007	4 m	40 kuti	21,640

BIBLIOTEKA E QYTETIT “KONGRESI I MANASTIRIT”

Duke u bazuar në planifikimin e punës për këtë vit, kemi realizuar shumicën e punëve të planifikuara me pasurimin e fondit librar, përpunimin e librit dhe regjistrimin e librit, mbajtjen e evidencës së lexuesve, kërkesat e vazhdueshme ndaj lexuesve për ruajtjen dhe kthimin e librit në bibliotekë, pastaj mbajtjen e orëve letrare, etj.

Biblioteka “Kongresi i Manastirit” në vitin 2024 ka evidentuar 426 lexues të cilët kanë qenë aktiv në leximin e librit. Në mesin e lexuesve, përveç nxënësve, kemi edhe studentë, punëtorë dhe pensionistë.

Furnizimet për pasurimin e fondit librar janë bërë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, po ashtu edhe nga vetë autorët e librave. Biblioteka këtë vit është pasuruar me 559 tituj dhe 1,228 ekzemplarë, ku në total tani biblioteka ka në fondin e vet gjithsej 33,062 ekzemplarë.

Më datë 05.03.2024 kemi pasur vizitë nga nxënësit e shkollës “Ismet Rraci” me mësuesen Bora Marleku, në ambientet e Bibliotekës, dhe interesimin e nxënësve për kushtet dhe mundësitë që ka biblioteka për lexim. Po ashtu, vizita janë bërë edhe nga nxënës të shkollës së Zllakuqanit, Shtupelit dhe “Motrat Qiriazit” në Klinë.

Më datë 13.08.2024, në ambientet e bibliotekës, është mbajtur një aktivitet kulturor me shkrimtarët lokalë dhe mysafirë nga Skenderaj, ku në këtë aktivitet është bërë prezantimi i dorëshkrimeve të fundit të autorëve të Klinës. Për nderim të tyre, kemi pasur të ftuar edhe

lexues (anëtarë) të bibliotekës, ku janë prezantuar dhe përshëndetur shkrimtarët me disa poezi.

Më datë 04.10.2024, është bërë promovimi i librit të autorit klinas, z. Gani Morina, me titull “E kaluara në Kujtesën Time”. Promovimi u mbajt në ambientet e bibliotekës me prezencë të shumë autorëve të Klinës.

Po ashtu, ishin për vizitë në ambientet e bibliotekës edhe fëmijët e çerdhes në Klinë.

Më 11.11.24, kemi bërë një intervistë në Tëvë1 mbi gjendjen dhe organizimin e frekuentimit të bibliotekës nga të rinjtë dhe qytetarët në përgjithësi. Po ashtu, gjatë vitit 2024, kemi pasur intervistë edhe në Kohavizion dhe në Radio Kosova.

5. DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Me fillimin e vitit 2024 është bërë Plani i punës, në bazë të të cilit Drejtoria e Bujqësisë do t'i kryejë të gjitha punët dhe aktivitetet e saj.

Ne, si Drejtori e Bujqësisë, përveç planit tonë të punës, kryejmë edhe detyra që dalin nga Ministria e Bujqësisë, e veçanërisht aplikimin e fermerëve për subvencionim, raportimin për realizimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore, korrje-shirjeve, ndërrimin e kulturës bujqësore nga toka pyjore në tokë bujqësore (sipas kërkesave të fermerëve), raportimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, organizimin e shërbimeve këshillimore etj.

Në muajin janar, më datë 15.01.2024, ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencionim të qumështit, majmëri të viçave dhe therjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, i cili ka zgjatur deri më 13.02.2024.

Duke pasur parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë herët në pranverë, ne paraprakisht, si drejtori, kemi përgatitur planin e mbjelljeve pranverore dhe njëkohësisht kemi këshilluar fermerët që t'i aplikojnë të gjitha masat agroteknike, si dhe të përdorin farëra cilësore dhe të certifikuar për mbjellje në mënyrë që të arrihen rendimente sa më të larta.

Këtë plan po e paraqesim edhe në formë tabelore për vitin 2024:

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha	Sipërfaqet e realizuara ha

1.	Misër	2995	2990
2.	Tërshërë	260	255
3.	Perime	200	145
4.	Patate	145	150
5.	Bimë foragjere	785	785
6.	Të tjera	85	80
	Gjithsej	4470	4405

Siç shihet nga tabela, plani i mbjelljeve pranverore është realizuar pothuajse në tërësi me disa ndryshime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve të mbjella.

Gjatë kësaj kohe, ne si Drejtori e Bujqësisë vazhdimisht kemi monitoruar procesin e mbjelljeve pranverore dhe kemi këshilluar fermerët t'i përmbahen masave agroteknike.

Më datën 13.03.2024 ka filluar aplikimi për subvencione që mbështeten nga Ministria e Bujqësisë -Agjencioni i Zhvillimit të Bujqësisë së pagesave direkte për sipërfaqe dhe derivate për këto kultura bujqësore: grurë, misër, thekër, tërshërë, elb, luledielli, pemë dru frutor, pemë të imëta, perime, si: spec, domate, patate, lakër, qepë, hudhër, kunguj, bimë aromatike. Po ashtu në blegtori për numër të krerëve, si: lopë qumështore, dele qumështore, dhi qumështore, dosa, bletë, pula vojse.

Me fillimin e aplikimit të subvencioneve, Drejtoria e Bujqësisë paraprakisht i ka njoftuar fermerët për afatin dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe gjatë kësaj periudhe procesi ka shkuar mjaft mirë dhe numri i aplikuesve krahasuar me vitin e kaluar ka qenë më i madh. Duke pasur parasysh afatin shumë të shkurtër për aplikim, ne jemi angazhuar dhe kemi punuar edhe jashtë orarit të punës, në mënyrë që të mos mbetet asnjë fermer pa aplikuar. Afati për aplikim ka zgjatur deri më 29.04.2024. Këtë vitë kanë aplikuar gjithsej 1130 fermerë për të gjitha llojet e subvencioneve.

Para fillimit të korrje-shirjeve është formuar komisioni në nivel komunal për përcjelljen e kësaj fushate. Ky komision, nga fillimi deri në përfundim, ka monitoruar fazën e korrje-shirjeve, inspektimin e autokombajnave për gjendjen teknike të tyre dhe vazhdimisht i kemi këshilluar fermerët që të mos bëjnë djegien e hamulloreve duke pasur parasysh se janë të dëmshme për tokën bujqësore dhe ambientin përreth.

Rendimenti i grurit këtë vit ka qenë shumë i mirë duke marrë parasysh se kushtet klimatike kanë qenë shumë të favorshme dhe nuk është atakuar nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Më datën 01.08.2024 deri 02.09.2024 është hapur aplikimi për dorëzimin e faturave të plehut, dëshmitë për sasinë e grurit të dorëzuar në pikat grumbulluese si dhe për qumësht dhe viça për majmëri.

Pas përfundimit të aplikacioneve, dokumentacionet e kompletuara edhe në formë fizike i kemi dërguar në MBPZHR për subvencionim përkatësisht në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë.

Për këtë subvencion kanë aplikuar gjithsej 840 fermerë.

Nga Drejtoria e Bujqësisë këtë vit janë realizuar këto projekte :

- Projekti i serrave në sipërfaqe 32 m² - përfitues 50 fermerë
- Projekti i serrave në sipërfaqe 100 m² - përfitues 20 fermerë
- Motokultivator- përfitues 50 fermerë
- Freza- përfitues 35 fermerë
- Shpërndarëse të plehut – përfitues 45 fermerë
- Shtrimi i disa rrugëve fushore në Zllakuqan e Krushevë të Madhe
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Grabanicë
- Projekti komunë-Islamik për mekanizëm bujqësor dhe serra- përfitues 400 fermerë

Projektet dhe subvencionet kanë ndikuar në zhvillimin e bujqësisë si dhe rritjen e të ardhurave për ekonomi familjare.

Përpos punëve me palë në zyrë, vazhdimisht ne kemi vizituar fermerët: Lavërtarë, Bletarë, Pemëtarë, Blegtorë, të cilët i kemi mbështetur në dhënien e këshillave në këto fusha, orientimin e tyre për një bujqësi të qëndrueshme dhe të zhvilluar. Po ashtu janë shpërndarë edhe broshura me tema të caktuara në lëmin e bujqësisë.

Drejtoria e Bujqësisë, në bashkëpunim me departamentin e shërbimeve këshillimore në nivel të Ministrisë së Bujqësisë, duke filluar nga fundi i qershorit deri në muajin dhjetor, kemi organizuar trajnime për fermerë me tema të ndryshme si:

- Sëmundjet e bletëve
- Të ushqyerit e gjedheve nga ushqimi veror në atë dimëror
- Përdorimi i herbicideve në lavërtari
- Mbrojtja e pemëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të ushqyerit e tyre
- kultivimi i perimeve në serra dhe ambiente të hapura.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë mbi 150 fermerë, të cilët kanë shfrytëzuar edhe përvojat praktike.

Për të qenë sa më të suksesshëm dhe për t'u kryer në afat optimal mbjelljet vjeshtore, ne vazhdimisht

kemi këshilluar fermerët që të bëjnë përgatitjen me kohë të sipërfaqeve tokësore, të përdorin farërat cilësore të certifikuara dhe plehtrat minerale.

Para fillimit të mbjelljeve vjeshtore, ne si Drejtori e Bujqësisë kemi hartuar planin për mbjelljet vjeshtore të cilin po e paraqesim në formë tabelore për vitin 2024/2025:

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha	Sipërfaqet e realizuara ha
1.	Grurë	4520	4470
2.	Elb	125	120
3.	Thekër	65	60
4.	Foragjere	550	560
	Gjithsej	5260	5210

Gjatë këtij, viti kushtet klimatike kanë qenë shumë të favorshme për mbjellje, të cilat kanë ndikuar edhe në rritjen e sipërfaqeve të mbjella me kultura vjeshtore.

Ne si Drejtori e Bujqësisë kemi bashkëpunim me Organizatat jo qeveritare dhe me drejtoritë komunale të Bujqësisë së Komunave tjera.

Në kuadër të Festivalit “I Këndojmë Lirisë” kemi organizuar Panairin e Produkteve Bujqësore, në të cilin fermerët e Klinës dhe të Komunave tjera kanë ekspozuar prodhimet e tyre për tri ditë radhazi sa ka zgjatur festivali. Në këtë panair, përveç fermerëve të komunës së Klinës, ka pasur edhe fermerë të Komunave të regjionit që kanë ekspozuar produktet e tyre.

6. DREJTORIA E INSPEKTORATIT

Duke u udhëhequr nga parimet themelore të ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe interesave publike të tij, efikasitetit, dëgjimit të palëve në procedurë, vlerësimit të lirë të dëshmive, vendosjes dhe plotfuqishmërisë së aktvendimeve, Drejtoria për Punë Inspektuese e Komunës së Klinës ka përmbushur planin e saj të punës në pikat më kyçe, si: kontrollin inspektues të zbatimit të ligjshmërisë nga lëmi i shërbimeve publike, ndërtimit, bujqësisë dhe ambientit, tregut, dhe atij të trafikut, legalizimin e ushtrimit të aktivitetit biznesor të subjekteve ekonomike dhe joekonomike etj.

Me qëllim të ndërtimit të strategjisë afatgjate në jetësimin e sundimit të Ligjit dhe luftimin e Informalitetit -veprimeve kundërligjore të subjekteve që iu nënshtrohen kontrollit inspektues, Organet e Drejtorisë për Punë Inspektuese në periudhën raportuese kanë ndërmarr një serë aktiviteteve dhe veprimesh koordinuese në bashkëveprim edhe me Policinë e Kosovës në: kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, kontrollin e bizneseve, mbikëqyrjes së rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK-së, KEDS-it, dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve, hapësirave publike, respektimit të orarit të punës së bizneseve hoteliere sidomos gjatë punës në orët e vonshme të natës, mbarëvajtjes së tregjeve javore, mbikëqyrjen e transportit publik, mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit, kontrollin e artikujve ushqimor dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësore dhe afatshmërisë të përdorimit të tyre, kurse ndërlikur me këtë nga ana e drejtorisë janë nxjerr një numër i konsideruar i

akteve-urdhëresave ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Këtu duhet shtuar se organizimi i punëve dhe detyrave të punës nga ana e eprorit të organit dhe inspektorëve, pos punëve të ushtruara në orarin e rregullt të punës, është bërë edhe gjatë ditëve të vikendit, festave fetare dhe shtetërore dhe me caktimin e kujdestarive si dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat, si dhe në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjeno-teknike dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore, është inkasuar shuma prej 14, 165.04 €; dhe në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjeno-teknike të hapësirave punuese-lokaleve në të cilat ushtrohet aktiviteti ekonomik, janë inkasuar 8, 366.28 €.

Në total, të hyrat për vitin 2024 janë 22, 531.32 €.

Nga personat fizikë dhe ata juridikë në nivel të drejtorisë janë proceduar **296** kërkesa të ndryshme, nga të cilat **284** janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore. Nga këto, **9** janë refuzuar si të pabazuara, **2** janë pezulluar dhe **1** është anuluar.

Më qëllim të informimit të ndërsjellë në relacionin: Organet e Inspektoratit dhe Drejtoria në raport me drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës, si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë dhe Ministrinë gjegjëse, janë hartuar informata, raporte, memorandume dhe relacione tjera zyrtare sipas kërkesave të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.

Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara, pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit inspektues, sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar më numrin e banorëve në komunën tonë.

Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit organ të inspektoratit, pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje, e që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

INSPEKTIMET NGA LËMI PUBLIK

Në këtë lëmë, në periudhën raportuese janë ushtruar **105** mbikëqyrje inspektuese, e që ka rezultuar me **73** procesverbale të përpiluara në vend. Në objektiv të kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorët tjerë në aksione të përbashkëta, inspektimi i tarracave në hapësirat publike, dalja në vend dhe shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizikë dhe juridikë të natyrës përkatëse. Në stinën e dimrit, organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirim të rrugëve nga reshjet dhe punët tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij.

- ❖ Inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike nga dëmtimet, kyçje ilegale, dëmtimin e rrugëve dhe veprimet tjera ilegale;
- ❖ Inspektimin dhe largimin e pengesave tjera (panove, reklamave të ndryshme, tarracave etj.) nga sipërfaqet publike të cilat nuk janë të pajisura me pëlqim nga organet kompetente;
- ❖ Inspektimin dhe largimin e shitësve ambulantë dhe pengesave tjera, mbikëqyrjen e mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve tjera publike;
- ❖ Mbikëqyrjen e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara dhe zbrazen pa leje të materialeve (rërës, dheut, materialeve tjera ndërtimore);
- ❖ Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, sipas ankesave të qytetarëve;
- ❖ Gjoha dhe procesverbale për mosrespektim të urdhrit të Inspektorëve.

Janë shqiptuar gjithsej **4** gjoha në vlerë prej **775.00** euro, prej të cilave:

Ushtrim veprimtarie të tregut në vende të palejuara; për mosrespektim të afatit për aplikim për shfrytëzim të hapësirës publike; mosrespektim të afatit të caktuar kohor për kthim në gjendje të mëparshme.

INSPEKTIMET NGA LËMI I NDËRTIMIT

Në këtë resor, në mungesë të inspektorit të ndërtimit, duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese si komision inspektues i përbërë nga të gjithë inspektorët në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit, janë ushtruar **78** kontrole, duke përfshirë edhe ato monitoruese inspektuese. Janë hartuar **65** procesverbale në vend dhe janë inspektuar dhe mbajtur nën kontroll të gjitha ndërtimet e reja, dhe ato të cilat kanë qenë në ndërtim e sipër nga vitet e kaluara, duke shtuar këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie gjatë ditëve të vikendit dhe atyre të festave të ndryshme. Po ashtu, është koordinuar dhe bashkëvepruar me inspektorët tjerë në kuadër të drejtorisë në punët e përbashkëta, si në punët e tregjeve javore, inspektimi i tarracave në hapësirat publike me Inspektorët e Shërbimeve Publike, në kuadër të mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit etj. Nga ky organ janë shqiptuar **9** gjoha në vlerë prej **8,410.04 €**.

INSPEKTIMET NGA LËMI I KOMUNIKACIONIT/TRAFIKUT

Ky organ, në vitin raportues **2024**, ka ushtruar mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtjen e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosjen në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me këtë janë hartuar

42 procesverbale, janë lëshuar **17** aktvendime dhe inkasuar **780.00 €**, për lëvizje të mjeteve që kalojnë peshën mbi **3.5 ton** në zonën e ndaluar për qarkullim në pjesën qendrore me kalldrëm. Janë shqiptuar dy gjoba në vlerë **100.00 €** për taxi.

Në total, realizimi i të hyrave është 880.00 euro në lëmin e komunikacionit, si dhe janë evidentuar monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve, si brenda lokalitetit të Klinës, ashtu edhe jashtë saj, përkatësisht në qendrat e lokalitetit në territorin e Komunës së Klinës.

Është asistuar në vendosjen dhe shenjëzimin e shenjave vertikale dhe horizontale në qytet dhe në fshatrat e Komunës së Klinës. Janë bërë procesverbale dhe fotografi për punët të cilat janë kryer, si:

- ❖ Vendosja e vendkalimeve të këmbësorëve prej 850 m²;
- ❖ Është bërë vendosja e afër 246 shenjave të komunikacionit në tërë territorin e komunës së Klinës, në rrugët ekzistuese dhe rrugët të cilat janë asfaltuar gjatë vitit 2024, si shenja të rrezikut, lajmërimit, urdhrave të prerë etj;
- ❖ Furnizimi dhe realizimi i vijës ndarëse të shiritave të qarkullimit afër 3000 metra shirit ndarës;
 - ❖ Furnizimi dhe vendosja e pasqyrave së trafikut 9 copë, të formës rrethore ose drejtkëndëshe;
 - ❖ Furnizimi dhe pajisja e vendkalimeve hekurudhore në të gjitha vendkalimet me gjithsej 162 shenja;
 - ❖ Shenjat e vendndalimeve të autobusëve, janë vendosur 20 shenja.

Po ashtu, është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese në aksione të përbashkëta të planifikuara nga Drejtoria.

INSPEKTIMET NGA LËMI I BUJQËSISË DHE AMBIENTIT

Gjatë periudhës raportuese për vitin **2024**, nga lëmi i Inspektimit të Bujqësisë dhe Ambientit, janë ushtruar aktivitete si:

- Inspektime të eksploatesve të resurseve natyrore si rërës, gurit dhe zhavorrit;
- Verifikimi i bartjeve të zhavorrit me mjete transportuese nëse janë të pajisura me dokumentet e nevojshme apo bëjnë bartje ilegale të zhavorrit;
- Inspektime për hedhje të mbeturinave në hapësira publike;
- Inspektime për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit;

- Kontrolle për kualitetin e prodhimeve bujqësore;
- Kontrollimin e barnatoreve bujqësore nëse janë të pajisura me aktvendime për ushtrimin e veprimtarisë.

Nga këto aktivitete janë bërë **73** kontrolle inspektuese, prej tyre janë hartuar **73** procesverbale mbi konstatimin e gjendjes, si dhe **10** gjoba të shqiptuara. Nga këto gjoba: **2** gjoba për eksploatim dhe bartje të zhavorrit në mënyre ilegale; **7** gjoba për hedhje të mbeturinave në hapësira publike; **1** gjobë për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit dhe; **1** rast për inicim procedure për kundërvajtje në Gjykatën Themelore dega Klinë. Gjatë vitit 2024 janë inspektuar të gjitha objektet dhe veprimtaritë e tjera të cilat kanë leje mjedisore komunale. Numri i objekteve që janë të pajisura me leje mjedisore komunale është 18 dhe të gjitha këto zbatojnë rregullativat mjedisore të LMK-së. Gjatë vitit 2024 kemi shqiptuar gjoba për mos posedim apo mos zbatim të LMK-së; njëkohësisht nuk kemi pasur fletëparaqitje në gjykatë.

Në total, realizimi i të hyrave është 1, 750.00 €.

INSPEKTIMET NGA LËMI I TREGUT

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe mbi bazën e obligimit ligjor për përpilimin dhe skicimin e shënimeve dhe të dhënave për punën dhe aktivitetin e ushtruar dhe punëve të kryera gjatë vitit **2024**. Më poshtë do të listohen punët dhe aktivitetet punuese të organit të Inspektoratit të Tregut sipas strukturës dhe tipeve të kontrollit të ushtruar ndaj subjekteve që i janë nënshtruar mbikëqyrjes inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore pozitive të Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, atë për Tregtinë e Brendshme, të Mbrojtjes së Konsumatorëve, Njësive matëse.

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit (pajisje me Certifikata për Regjistrim të Biznesit), të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera, pajisja me Aktvendime.

Procesverbale të hartuara mbi faktimin e gjendjes e që i referohen të njëjtit aktivitet për përcaktimin e veprimeve dhe procedimin e mëtejshëm administrativo-procedural-**71 procesverbale**.

Puna e Komisionit Inspektues në përcaktimin e kushteve minimale teknike, sanitare-higjienike, ku janë pajisur **68** lokale me Aktvendime dhe inkasuar **8, 306.28 €**, nga bizneset ku janë plotësuar urdhërpagesat për kompensim të pagesave në emër të taksës.

Në koordinim me Zyrën për Biznese është punuar në zgjidhjen e kërkesave për lejimin e zgjatjes së orarit të punës së subjekteve afariste nga lëmi i hotelarisë dhe kafiterisë, që është në përputhje me Rregulloren përkatëse komunale, ku shënohet vetëm **1** rast.

Në bashkëpunim me Inspektorin Sanitar dhe të tjerë janë larguar nga qarkullimi mallrat dhe produktet ushqimore me afat të skaduar për përdorim, të prishura, pa deklaracion për shitje,

ku është inkasuar shuma prej **60.00 €** në emër të taksës për punën komisionare konform Rregullores për Taksat, Ngarkesat dhe Tarifat. Kurse vlera e mallit të asgjësuar është **29, 659.54 €**.

Gjoha të shqiptuara ndaj subjekteve dhe individëve për shkelje ligjore (të përcaktuara me dispozita ligjore) gjatë ushtrimit të aktivitetit afarist apo të ngjashme për **5** raste, që kapin shumën totale prej **2, 350.00 €**. **Në total, realizimi i të hyrave është 10,718.28 euro. Si dhe një gjobë në vlerë prej 1, 000.00 € e cila nuk është inkasuar ende.**

Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve punuese për vitin raportues, nuk është përfshirë puna, qoftë vetanake, qoftë në bashkëveprim me Inspektorët e Tregut pranë MTI-së sipas Planit të Veprimit të Inspektoratit të Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, për çka, sipas një vije të veçantë, ka qenë e nevojshme korrespondimi dhe raportimi për të njëjtët.

PROPOZIMI I MASAVE:

Duke konkluduar mbi konstatimet e sipërsënuara dhe efektet e arritura nga periodha raportuese, paraqitet domosdoshmëria në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në:

- Shtimin e numrit të Inspektorëve sipas standardeve ligjore në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve në Komunë.

7. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBOJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës ushtron gjithë veprimtarinë e vet në bazë të dispozitave ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve të Asamblesë Komunale.

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit veprojnë:

Shërbimi i Ndërtimit dhe Banimit	Në kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:	- Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit
Zyra për Mbrojtje të Mjedisit		- Legalizimi
Planifikimi Urban		- Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit – Planifikimit
		- Leje mjedisore komunale
		- Mirëmbajtja e sistemit të adresave
		- Hartim të paramasave dhe parallogarive, përgatitje të projekt-propozimeve, raporte teknike, procesverbale, shkresa etj

Zyra për Projekte		- Menaxhim dhe mbikëqyrje të ecurisë së punimeve për të gjitha projektet, pranime teknike për projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera, si dhe bënë inspektime në terren sipas kërkesave të palëve.
-------------------	--	--

Gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka pranuar gjithsej 1043 lëndë, nga të cilat:

73 kërkesa për leje ndërtimi, prej të cilave 57 janë miratuar, 12 janë refuzuar dhe 4 lëndë janë ende në proces.

19 kërkesa për leje mjedisore, prej tyre 18 janë miratuar dhe 1 është refuzuar.

90 kërkesa për legalizim të ndërtimit, prej tyre 62 janë miratuar, 24 janë në listën e pritjes, 4 janë refuzuar dhe 2 janë në proces të vazhdimit të punimeve.

Ndërsa, të tjerat janë kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për legalizim, fatura dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ka vendosur si më poshtë:

729 lëndë të miratuara, prej të cilave janë:

Kushte të ndërtimit	Leje ndërtimi	Leje mjedisore	Leje legalizimi	Leje rrënimi		
75	57	18	90	4		
492 lëndë janë: referenca, vërtetime, pëlqime, procesverbale, vendime, fatura, njoftime, shkresa dhe kërkesa të ndryshme.						
Lëndë që janë në proces	Lëndë të refuzuara	Lëndë të pezulluara	Lëndë të hedhura poshtë	Lëndë të anuluar	Lëndë të pranuar	Lëndë të ceduar
5	81	148	24	56	0	0

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit këtë vit ka krijuar të hyra buxhetore në vlerë prej

283, 699.13 € nga lejet e ndërtimit, kushtet e ndërtimit, lejet mjedisore komunale, legalizimi, pëlqimet etj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka menaxhuar, mbikëqyrur dhe realizuar projektet si më poshtë:

N R	Nr. i kontratës	Emërtimi i kontratës	Vlera e kontratës 2023-24-25 (€)	Rrugë të asfaltuara (m)	Kanalizim fekal (m)	Trotuar	Ndriçim elektrik (m)	Shtrati i lumit (m)	Përfundimi i projektit
1	84-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Zllakuqan-Pataqan -Berkovë	119,804.00	500					Vazhdon
2	78-2024	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë	649,909.00			500			Vazhdon
3	91-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot1	1,709,978.00						Vazhdon
4	92-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot2	1,977,619.35						Vazhdon
5	93-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot3	1,154,823.27						Vazhdon
6	94-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot4	1,420,000.77						Vazhdon
7	95-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot5	2,023,000.00						Vazhdon
8	96-2023	Ndërtimi i urës dhe rrugës në fshatin Budisalc-Rudic	60,178.20						Përfunduar
9	120-23	Asfaltimi i rrugëve Gremnik, faza II	44,900.00	1200.00					Përfunduar
10	97-2024	Projekte zbatuese	300,000.00						Vazhdon
11	85-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore, Ranoc-Leskoc	49,978.00		1000.00				Vazhdon
12	12-2024	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim në fshatin Poterq dhe Ndërtimi i rrugëve Poterq-Dugajevë - Drenoc	214,815.00						Vazhdon
13	15-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Klinë-Shtupel-Kërrnicë	299,000.00	1856.00					Vazhdon
14	17-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollovë	169,999.82	1000.00		730.00	730.00		Vazhdon
15	079-2023	Asfaltimi i rrugëve Krushevë e Vogël	64,485.00	969.00					Përfunduar
16	081-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Ujmirë, Siqevë, Shtaricë, faza III	34,688.50	150.00	1200.00				Përfunduar
17	134-23	Ndërtimi i liqenit akumulues për uji të pijes	149,450.00						Përfunduar
18	139-23	Ndërtimi i ujësjellësit ne komunën e Klinës	40,982.00						Përfunduar

19	112-23	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Dresnik-Dollc, faza III	198,500.00	1,150.00					Përfunduar
20	28-2024	Ndërtimi i trotuarit Klinë-Zllakuqan (Krushevë e Vogël)				700.00	700.00		Përfunduar
21	83-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë	64,941.00	500	1200.00				Vazhdon
22	042-2023	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videjë Paskalicë- Krushevë e Madhe	100,000.00						Përfunduar
23	113-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Dresnik-Dollc, faza II	43,999.95		2410.00				Përfunduar
24	118-23	Fasadimi i objekteve të vjetra, fasada V	25,999.00						Përfunduar
25	66-2024	Ndërtimi i liqenit akumulues për uji të pijes, faza II	29,948.00			105.00	505.00		Përfunduar
26	14-2024	Ndërtim i rrugëve dhe infrast. nëntokësore Videjë Paskalicë- Krushevë e Madhe	119,000.00	1430.00			630.00		Përfunduar
27	91-2023	Ndërtim i trotuarit me ndriçim në fshatin Shtupel dhe Budisalc	97,699.99						Përfunduar
28	073-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Caravik Çabiq, faza III	61,000.00						Përfunduar
29	083-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Resnik- Jellovc Jashanicë	229,999.00						Përfunduar
30	076-2023	Rregullimi i parqeve në Klinë	20,000.00						Përfunduar
31	40-2023	PZHK	27,376.00						Vazhdon
32	103-2023	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në Klinë (SHESHI)	289,894.80						Përfunduar
33	63-2022	SHTEGU I BIÇIKLETAVE	474,970.00						Përfunduar
34	031-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Zajm Deiq	264,000.00		453.00	1200.0	1200.0		Përfunduar
35	070-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Zllakuqan Pataqan Berkovë	78,040.59	300.00					Përfunduar
36	072-2023	Rregullimi i shtratit të lumit Klina	746,046.00				1065.00	500.00	Përfunduar
37	110-2023	Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë	849,921.63						Vazhdon
38	109-2023	Hartimi i projekteve zbatuese	50,000.00						Përfunduar
39	89-2024	Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë-Volljakë	8600						Përfunduar

40	79-2024	Punë shtesë Asfaltimi i rrugëve lokale Gremnik	4125,00	160.00					Përfunduar
41	14-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Krushevë e Madhe	119,000.00	1430.00			630.00		Përfunduar
42	13-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Sferkë-Volljakë-Qupevë	249,500.00	3500,00					Vazhdon
43	20-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Madh	99,944.50	1100.00					Vazhdon
44	72-2024	Ndërtimi i segmenteve të rrugëve Mal Bashota,Prekë Prendi,Dosidej Obradoviq,Bekim Fehmiu dhe infrastruktura nëntokësore Klinë-Dollc-Dresnik	349,999.00	1000.00	1000.00				Vazhdon
45	70-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në fshatrat Zajm-Deiq	18,669.90		1000.00				Përfunduar
46	71-2024	Rregullimi i shtratit të lumit Drenoc	18,902.00					200	Përfunduar
47	52-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Jashanicë-Pogragjë-Resnik si dhe Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastruktura rrugore në Gryken e Jarinës-Pogragjë-Jashanicë	225,428.00	2000.00					Vazhdon
48	42-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Këpuz-Rastokë	61,190.00	200.00	1000.00				Vazhdon
49	41-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogël-Klinafc	104,997.00	1000.00	1000.00				Vazhdon
50	36-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Budisalc-Rudicë dhe urës Rudicë	39878.00	600.00	600.00			200m pastrim	Përfunduar
51	39-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë	82,000.00	1250.00	100.00				Vazhdon
52	27-2024	Ndërtimi i kanalizimit Shtupel-Binxhë-Grabc	79,999.00		4000.00				Përfunduar
53	110-2024	Punë shtesë –Ndërtimi i kanalizimit Shtupel-Kërrnicë-Binxhë-Grabc	7570.00		385.00				Përfunduar
54	108-2024	Ndërtimi i shtratit Lumëbardhi i Pejës Drenoc-Grabanicë	31,550.00					300.00	Vazhdon
		TOTALI		21295.0	15,348.0	3235.0	5460.0	1000.0	

Pra, gjatë periudhës 2024 janë punuar :
21, 295. 00 m (21.29 km) rrugë të asfaltuara

15, 348. 00 m kanalizim fekal

3, 235. 00 m trotuar

5, 460. 00 m ndriçim publik

1, 000. 00 m rregullim i shtratit të lumenjve

Rrugë të asfaltuara në komunën e Klinës në total janë: 480.76 km

Trotuare të ndërtuara në total janë: 33.48 km

Shtegu i biçikletave në total është: 4.9km

Gjatë kësaj periudhe, punëtorët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë marr pjesë në komisione për hapje dhe vlerësime të ofertave për projekte të ndryshme të Drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtorive të tjera, si dhe komisione të ndryshme.

Janë mbajtur takime të ndryshme me donatorë si dhe dikasteret e linjës me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfitimit të projekteve të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe është bërë plani i punës dhe plani i prokurimit për vitin 2025, raporte mujore rreth punës së drejtorisë, janë bërë vlerësimet dhe sistemitet e dosjeve të këtij viti, si dhe punë tjera që kanë të bëjnë me planifikimin , detyrat dhe aktivitetet e drejtorisë.

Është bërë shënimi i datave mjedisore, siç janë: Dita e tokës 22- prilli

Ta pastrojmë Kosovën -24 maji

Dita e Mjedisit -5 qershori.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka bërë edhe punë të tjera si: inspektime në terren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe parallogari për rrugë, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, detyra projektuese, kërkesa, projekt-propozime, raporte, mbikëqyrje të projekteve, pranime teknike etj.

8.DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Fushëveprimtaria:

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtoria ka këtë fushëveprim:

- ✓ Vlerëson nevojat lokale shëndetësore;
- ✓ Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesin parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga MSh;
- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
- ✓ Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve si dhe Qendrës për Punë Sociale;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;

- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- ✓ Harton propozimet për lirimet nga pagesa për shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- ✓ Ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesin parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të mjekësisë familjare, dhe përcjellja e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;
- ✓ Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuara në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor; kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ndërmerr masa parandaluese për zbulimin dhe diagnostikimin e hershëm, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- ✓ Organizon dhe zbaton procesin e imunizimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si një nga masat themelore të kujdesit ndaj shëndetit publik;
- ✓ Kujdeset për përparimin e shëndetit të fëmijëve, të rinjve dhe grupeve tjera;
- ✓ Promovon shëndetin oral dhe kujdesin themelor stomatologjik si dhe shëndetin mendor, në pajtim me metodat e avancuara;
- ✓ Kujdeset për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të qytetarëve të komunës, nëpërmjet aktiviteteve parandaluese (por duke mos u kufizuar vetëm në këto), si: promovimi i mënyrës së shëndoshë të jetesës, edukimit shëndetësor, ndërmarrjes së masave të përgjithshme kundër epidemive dhe preventive, si: dezinfektimi hapësinor, deratizimi dhe dezinfektimi, kontrollimi i mjedisit, kontrollimi i shkaktarëve, si dhe parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve, lëndimeve dhe gjendjeve me rëndësi sociale mjekësore;
- ✓ Zhvillon programe për aftësimin profesional të punëtorëve shëndetësorë nëpërmjet “Zhvillimit të vazhdueshëm profesional” (ZHVP), me qëllim të ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor;
- ✓ Bashkëpunon me kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- ✓ Vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;
- ✓ Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;
- ✓ Vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;

- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;
- ✓ Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit të komunës;
- ✓ Kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- ✓ Bashkëpunon me ministrinë përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera në nivelin lokal, përmes QPS – së;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturve komunale në këtë fushë;
- ✓ Përgatit planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
- ✓ Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministrinë e linjës.

QKMF / QMF / AMF – Raport i punës

Objektivi kryesor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, përgjatë vitit 2024, ka qenë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rritja e numrit të shërbimeve mjekësore të ofruara në QKMF, është përmirësuar furnizimi me medikamente për pacientët, janë përmirësuar shërbimet e patronazhit, kujdesit paliativ, etj.

Furnizimet mjekësore (barna dhe pajisje mjekësore) janë bërë me kohë dhe në sasi të mjaftueshme falë investimeve nga Komuna e Klinës si dhe nga Lista Esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Qytetarët tanë kanë marrë shërbime cilësore në QKMF dhe janë furnizuar në masë të madhe me barna.

Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikë - Edhe në shërbimin e diagnostikës në QKMF janë kryer numër i madh i shërbimeve cilësore, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit, me aparatura moderne dhe pa kosto për shumicën e qytetarëve. Më shumë se 22,000 qytetarë kanë kryer shërbime diagnostike, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit. Gjatë vitit 2024 është bërë furnizimi me pajisje të reja mjekësore në sektorin e diagnostikës me theks të veçantë aparati i Mamografisë, vënia në funksion të të cilit ka ndikuar që shumë gra të kryejnë këtë shërbim pa pagesë në Klinikë të cilat do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e shërbimeve të ofruara si dhe do të rrisin edhe gamën e shërbimeve në diagnostikën e QKMF-së. Vlera e pajisjeve të reja të blera në QKMF nga buxheti i komunës është rreth 85,000 euro. Gjithashtu, kemi pranuar donacione në pajisje të reja nga KFOR-i si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Gjatë vitit 2024 nuk kanë munguar edhe investimet kapitale në QKMF, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për qytetarët e komunës sonë. Janë krijuar hapësira të reja dhe është bërë renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore, ordinancave specialistike dhe barnatores së QKMF-së. Vlera e investimeve kapitale gjatë vitit 2024 ka qenë rreth 200,000 euro, prej tyre nga buxheti i komunës janë shpenzuar rreth 45,000 euro, rreth 140,000 janë shpenzuar nga zyra e BE-së në kuadër të projektit "EU for All", projekt ky që ka për qëllim përmirësimin e kushteve për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në objektin e QKMF në Klinë.

Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore ka qenë prioritet edhe përgjatë vitit 2024. Është bërë trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante si dhe janë kryer procedurat e rekrutimeve për stafin mjekësor dhe teknikëve të infermierisë.

Ka vazhduar bashkëpunimi me donatorët ekzistues dhe janë zhvilluar takimet e reja me donatorët potencialë, ku janë prezantuar objektivat tona parësore dhe projektet e planifikuara.

Vizitat Mjekësore

	Jana r	Shku rt	Mars	Pril l	Maj	Qersh or	Korr ik	Gusht	Shtat or	Teto r	Nënt or	Dhjet or	Total i
Mjekësia Familjare	713 6	5788	333 1	295 9	517 3	4116	482 1	6107	4743	388 6	3881	3984	559 25
Pediatria	878	631	817	518	704	672	523	612	629	673	524	843	802 4
Gjinekolo gjia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Stomatolo gjia	153	165	68	153	155	102	193	181	150	0	166	143	162 9
Specialist ika	186 6	1921	149 5	214 8	198 7	1465	929	2118	1844	202 9	1746	1447	210 95
Totali	100 33	8505	571 1	577 8	801 9	6355	646 6	9118	7366	658 8	6317	6417	966 73

Vëmendje e madhe i është kushtuar programit për kujdesin mjekësor për të moshuarit, kujdesit paliativ dhe pacientëve terminal si dhe kujdesit mjekësor për komunitetet pakicë.

Është rritur angazhimi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët 0-3 vjeç si dhe gratë shtatzëna dhe lehonat, duke pasur mbështetje të vazhdueshme edhe nga programi i UNICEF-it. Është bërë ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk kanë mundur të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF.

	Totali
Mjekësia Familjare	55925

Pediatria	8024
Gjinekologjia	0
Stomatologjia	1629
Specialistika	21095
Totali	96673

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Trendi Mujor	10033	8505	5711	5778	8019	6355	6466	9118	7366	6588	6317	6417

**Shërbimet
Shëndetësore**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Barnatorja	670	321	680	533	808	586	583	784	710	783	665	625	7748
Echo	0	0	0	3	0	0	0	0	60	15	11	0	89
Ekg	142	95	162	87	42	139	35	120	198	153	86	119	1378
Injeksione	4059	2305	2684	2287	2447	2205	2781	3947	3259	3257	2746	3154	35131
Infuzione	2424	1536	1891	1326	1603	1841	2201	3025	2064	1838	1394	1600	22743
Inhalime	106	207	207	112	123	88	113	137	205	223	167	208	1896
Laboratori	1397	1282	1388	1374	1426	1135	1402	1184	1380	1411	1260	1526	16165
Lidhje	625	626	743	612	674	677	803	931	793	920	847	856	9107
Qepje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rëntgeni	518	508	606	520	535	419	543	401	467	651	394	234	5796
Vaksinimi	170	159	169	207	265	298	250	227	270	1282	546	197	4040
Terreni	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	10111	7039	8530	7061	7923	7388	8711	10756	9406	10550	8129	8532	104136

Totali 12 Mujor i shërbimeve	
Barnatorja	7179
Echo	89
Ekg	1378
Injeksione	35131
Infuzione	22743

Inhalime	1890
Laboratori	16165
Lidhje	9107
Qepje	0
Rëntgeni	5796
Vaksinimi	4040
Terreni	0

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Trendi Mujor i shërbimeve	10111	7039	8530	7061	7923	7388	8711	10756	9406	10550	8129	8532

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	12 Mujori
Trendi Mujor i shërbimeve	10033	8505	5711	5778	8019	6355	6466	9118	7366	6588	6317	6417	86663
Trendi Mujor i vizitave	10111	7039	8530	7061	7923	7388	8711	10756	9406	10550	8129	8532	104136
Totali	20134	15544	14241	12839	15942	13743	15177	19874	16772	17138	1444	14949	190799

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatarja
Furnizimi i Barnatores nga M.SH	15%	20%	25%	20%	25%	25%	25%	20%	20%	20%	20%	25%	20%
Insulinë	177	154	175	156	174	173	165	181	175	182	174	185	173
Insulinë për fëmijë	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6.00
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Të aksidentuar	11	6	6	7	9	8	10	15	6	11	13	17	119
Vdekje	1	2	0	1	1	1	0	1	0	2	0	1	10
Psikologjike	12	14	20	5	3	7	2	4	2	8	5	12	94
Vizitat në shtëpi, nëna dhe fëmijë	32	20	18	26	9	18	11	34	16	29	18	21	252

dhjetor 2024	Periudha janar -
janë 1293	Shërbimet e Patronazhit
sezonal janë 1337.	Vaksina kundër gripit
pacientë janë 250	Në këshillimore,
prej tyre pozitiv 8 dhe negativ 5 (9M, 4F)	Në pulmologji numri i pacientëve me TBC janë 13;

1	Gjithsej Nr. i QKMF-ve	1	Klinë
2	Të cilat përmbushin kërkesat për inventarë mjete , ofrimin e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike	QKMF KLINË	
3	Gjithsej Nr. i QMF-ve	3	QMF Zllakuqan
4	Të cilat përmbushin kërkesat për inventarë, mjete , ofrimin e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike	QMF Sferkë QMF Ujmirë	
5	Gjithsej Nr. i AMF-ve	10	AMF-Gillarevë AMF-Caravik
6	Të cilat përmbushin kërkesat për inventarë mjete , ofrimin e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike	AMF-Jashanicë e Epërme AMF-Drenoc AMF-Grabanicë AMF-Jagodë	
7	Gjithsej numri i ekepeve të Mjekësisë Familjare 1 Mjek Specialist dhe 2 Infermierë	3	3 Mjekë specialistë dhe 6 Infermierë
8	Gjithsej numri i ekepeve të Stomatologjisë 1 Doktor i Stomatologjisë dhe 1 Teknik /Asistent	2	2 Doktorë të Stomatologjisë dhe 2 Teknikë/Asistentë
9	Gjithsej fëmijë të planifikuar për program të Imunizimit	380	
10	Gjithsej fëmijë në program të cilët janë Imunizuar HEPAT IT B	1705 35	Nxënës të kl. I- VI Fëmijë
11	Regjistër i Imunizimit të Drejtorisë së Shëndetësisë për fëmijë të moshës 0-3 vjeçare në nivel të Komunës	2135	Fëmijë -0-3 vjeç
	Tot ali	3875	Fëmijë të Imunizuar

15.1.1.	15.1.1.	E dhena	1						
		E dhena :	1						
		E dhena :	3						
		E dhena :	0						
		E dhena :	10					Formula	
		E dhena :	10	Treguesi	66.67			"=(G5/G4)*33,33+(G7/G6)*33,33+(G9/G8)*33,34"	
15.2.1.	15.2.1.	E dhena	3						
		E dhena :	2						
		E dhena :	38000	Nr Popullates				Formula	
				Treguesi	506.7			"=(1-(2000-G16/G14)/2000)*50+(1-(5000-G16/G15)/5000)*5	
15.3.1.	15.3.1.	E dhena	100					1: Gjithsej fëmijë të r për program imunizimi t;	
		E dhena :	120	Treguesi	120			E dhena 2: Gjithsej të cilët janë	



REGJISTRIMI I VIZITAVE NE SHTEPI PËR GRA SHTATZËNA DHE FËMIJË 0-3 VJEÇ 2024

Komuna e Klines		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
1	Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	87	93	138	115	148	113	134	100	154	127	130	105	1444
2	Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	14	3	8	6	17	13	15	19	24	4	13	8	144
3	Numri total i vizitave në shtëpi të kryera	101	96	146	121	165	126	149	119	178	131	143	113	1588
4	Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë	17	11	18	14	19	21	19	18	16	13	14	10	190
5	Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	16	10	10	13	20	12	16	17	14	22	18	9	177
6	Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	33	21	28	27	39	33	35	35	30	35	32	19	367
7	Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç	27	24	28	22	27	22	19	16	25	23	31	21	285
8	Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç	8	13	26	15	27	22	37	17	31	25	20	13	254
9	Numri i vizitave të ketërta për fëmijët 0-3 vjeç	6	25	22	26	17	15	16	14	27	22	21	21	232
10	Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç	13	10	33	25	32	21	26	17	38	22	26	31	294
11	Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para	3	2	5	6	7	8	5	6	4	3	5	3	57
12	Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë	11	3	8	6	7	5	11	10	10	4	10	5	90
13	Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë	3	0	0	0	10	8	4	9	14	0	4	3	55
14	Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	5	0	2	6	11	2	2	4	7	2	2	0	43
15	Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	3	0	0	0	0	1	0	0	2	0	1	0	7
16	Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	0	0	0	1	3	0	1	1	3	0	0	0	9
17	Numri i vizitave shitesë për fëmijë dhe shtatzëna (Jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	0	3	1	3	6	2	2	1	3	1	0	3	25
18	Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	3	4	2	4	2	5	8	7	9	4	3	4	55
19	Numri i rasteve sociale të identifikuar dhe të referuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20	Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
21	Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)	0	0	0	0	1	1	2	1	0	1	0	0	6
22	Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	5	6	5	4	5	5	6	4	5	8	5	6	8

Komuna e Klinës			Lindjet e gjalla	Targeti Minimal	Targeti Maksimal	Vizitat e arritura deri më tani
			469	1407	2345	1588
Komuna e Klinës		Lindjet e gjalla	Targeti Minimal	Targeti Maksimal	Vizitat e arritura deri më tani	
		469	1407	2345	1588	

Komuna e Klinës	Lindjet e gjalla	Targeti Minimal	Targeti Maksimal	Vizitat e arritura deri më tani
	469	1407	2345	1588

Qendra për Punë Sociale, në bazë të fushëveprimtarisë së saj, ka bërë përpjekje për kryerjen e misionit të saj në mënyrën më të mirë duke u mbështetur në detyrat dhe obligimet që posedon në raport me ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët pa dallim. Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar implementimit të politikave që janë nxjerrë nga niveli qeveritar në implementimin e standardeve për mbrojtjen e kategorive të ndryshme sociale që kanë nevojë për këto shërbime.

Në kuadër të misionit të QPS-së, një trajtim i veçantë i është kushtuar kategorive më të rrezikuara dhe që kanë nevojë për shërbimet që ju ofron ky institucion, në veçanti për: fëmijët e braktisur, fëmijët pa kujdes prindëror, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, personat e moshuar dhe pa përkujdesje, personat me nevoja të veçanta, delikuentët, etj.

Mision tjetër i QPS-së ka qenë edhe ofrimi i ndihmës financiare nëpërmjet sektorit të Asistencës Sociale për familjet nevojtare të cilat i plotësojnë kriteret që janë të parapara në Ligjin dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, gjithmonë duke u bazuar edhe në verifikimin dhe monitorimin e këtyre familjeve nevojtare.

Fusha e trajnimit

Gjatë vitit 2024, stafi i Qendrës Për Punë Sociale ka marrë pjesë në disa trajnime kryesisht të fushës sociale, ku edhe janë certifikuar. Certifikatat janë të nevojshme për ri-licencimin e zyrtarëve që ofrojnë shërbime sociale.

Bashkëpunimi me Organizatat Jo Qeveritare

Kur jemi të bashkëpunimi me Organizatat Jo Qeveritare, ne, si Institucion, kemi pasur një bashkëpunim mjaft të mirë me të gjitha ato Organizata që për mision kanë mirëqenien e qytetarëve. Andaj, unë do t'i veçoja disa nga këto:

- **OJQ “Arbeiter Samariter Bund- ASB”** me seli në Prizren, ku është realizuar suksesshëm projekti "Mbështetje e Integruar Socio ekonomike për familjet e prekura pakicë dhe shumicë në Klinë”.
- **Caritas Umbria** - e cila çdo herë na përgjigjet në kërkesat tona për ndihmë për familjet në nevojë.
- **Qendra për Mirëqenien e Gruas - Shtëpia e Sigurt në Pejë**, ku kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë, ku çdo herë na janë përgjigjur pozitivisht në kërkesat tona

për strehimin e viktimave të dhunës në familje, duke respektuar kështu memorandum bashkëpunimit të kësaj Organizate me Komunën e Klinës.

- **Terre des hommes**- Organizatë kjo që përpos trajnimeve të organizuara, herë pas here na ka ndihmuar në ofrimin e ndihmës direkte (veshmbathje, pajisje shkollore, medikamente mjekësore) për disa familje.
- **Shoqata Humanitare Bamirëse “Dushkaja”** me seli në Gjakovë, ku janë ndihmuar shumë familje në nevojë me veshmbathje të përdorura, të ardhura nga Gjermania.
- **UNICEF** - United National International Children’s Emergency Fund (Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet).
- **OFAP** - Organizata për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror.
- **GIZ** – Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar.
- **Save the Children në Kosovë**- kemi pasur një bashkëpunim të mirë edhe me OSBE dhe **Syri Vision** – një organizatë me seli në Pejë, që realizon veprime lokale të bazuara në praktikën më të mirë.

Pjesa kryesore

Raporti është përpiluar duke u ndarë sipas sektorëve që funksionojnë në kuadër të QPS-së, atë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe Sektorin e Asistencës Sociale.

Spektori i Shërbimeve Sociale

Gjatë vitit 2024, Spektori i Shërbimeve Sociale ka kryer shërbime të ndryshme në përkrahje të familjeve dhe personave në nevojë sociale. Në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri te përkrahja për familjet me probleme sociale, kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve, kujdesi dhe mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa tjera).

Bashkëpunimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale me Institucione të tilla si Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, institucionet shkollore, zyra për ndihmë juridike falas, dhe OJQ të ndryshme ka qenë në nivelin më të mirë të mundshëm. Gjatë vitit 2024, Shërbimi Social ka realizuar vizita në familje të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë në strehim familjar, fëmijë nën kujdestari. Gjithashtu, ka marr pjesë në intervistimin e të miturve në polici, në seanca gjyqësore, si dhe ka realizuar vizita tjera në familje të ndryshme ku është paraqitur nevoja e ofrimit të shërbimeve sociale.

Më poshtë e keni raportin e sektorit të Shërbimeve Sociale në formë tabelore

Nr.	Shërbimet e kryera	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve aktive (ekzistuese)	Vërejtje

1	Kujdestari për fëmijë	2	21	
	Kujdestari për raste të veçanta	2	2	
2	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	15	0	
3	Adoptime – Periudhë provuese për Adoptim	0	0	
4	Dhunë në familje	25	23	
5	Strehim familjar brenda familjes biologjike/nr fëmijëve	1	9	
6	Strehim në shtëpinë e sigurt në Pejë	7	0	
7	Vendosje të fëmijëve në SOS fshatin e fëmijëve në Prishtinë	0	1	
8	Strehim i personave madhorë në Institutin e Special në Shtime dhe Deçan	0	6	
9	Strehim i fëmijëve në shoqatën “Caritas Umbria”, në Leskoc	0	3	
10	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	31		
11	Çrregullime familjare	4	2	
12	Përcjellje të kontaktit fëmijë-prind	8	8	
13	Shkurorëzime	25	0	
14	Fëmijë nga prindërit e shkurorëzuar	41		
15	Strehim i të moshuarve në shtëpinë për të moshuar në Gurrakoc dhe Skenderaj	0	5	
16	Vërtetime dhe deklarata	496		
17	Kërkesa për mbështetje financiare familjes për fëmijë me nevoja të veçanta	14	85	
18	Pjesëmarrje në seanca gjyqësore dhe polici	116		
19	Kujdestari për përfaqësime në seanca gjyqësore	3		
20	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të së drejtës prindërore	0		
21	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të zotësisë së veprimit	3		
22	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për shërim të detyrueshëm	1		
23	Kërkesa të ndryshme, Gjykatë, Polici, QKMF, Shëndeti Mendor në Pejë, konstatime zyrtare, pëlqime etj	33		
24	Regjistrime të fëmijëve në Zyrën e Gjendjes Civile	2		
25	Lindje jashtëmartesore	1		
26	Anamneza sociale	3		

Sektori i Asistencës Sociale

Në periudhën që po raportojmë, numri i familjeve përfituese të Ndhmës Sociale në të dy kategoritë është 711.

Gjithashtu, gjatë periudhës që po raportojmë në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, organizata humanitare, biznese të ndryshme dhe organizata joqeveritare, kemi ndihmuar disa familje nevojtare me pako të ndryshme (higjienike, ushqimore, veshmbathje).

Më poshtë e keni raportin e sektorit të Asistencës Sociale në mënyrë tabelore për periudhën raportuese:

Aktivitetet	Kategoria I dhe II
Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë	59
Sa prej tyre janë të aprovuara	40
Sa prej tyre janë të refuzuara	7
Sa janë në shqyrtim	12
Numri i rasteve të ndërprera	29
Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e As. sociale	3
Numri i ankesave të aprovuara	0
Numri i ankesave të refuzuara	2
Nr. ankesave në shqyrtim	1

Realizimi i të hyrave nga Tarifat Administrative në Qendrën për Punë Sociale

Bazuar në Rregulloren mbi Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, në Institucionin e QPS-së tarifohen disa nga vërtetimet që i lëshon ky institucion. Gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, kemi arritur që të grumbullojmë një shumë të konsiderueshme të të hollave, të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës së Klinës. Në vazhdim, në mënyrë të detajuar i keni të hyrat që janë grumbulluar për periudhën janar – dhjetor 2024:

Muaji	Përshkrimi	Nr. & tarifa adm.	Shuma totale - Euro
Janar - Dhjetor 2024	Vërtetim që nuk i është marr ose kufizuar aftësia për të vepruar (për marrjen e lejes për armëmbajtje)	273 x 20 €	5,460.00 €
Janar - Dhjetor 2024	Vërtetim për lirim / fitim nga shtetësia e Kosovës	170 x 10 €	1,700.00 €
Janar - Dhjetor 2024	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i Asistencës Sociale	47x 2 €	94.00 €
Janar - Dhjetor 2024	Anamnezë sociale	4 x 5 €	20.00 €
			Totali: 7,274.00€

Sfidat

- Grumbullimi e të hyrave vetanake të mbledhura nga QPS në një kod të veçantë buxhetor të Qendrës për Punë Sociale/Shërbime Sociale, mjete që do të mund të shfrytëzoheshin për pagesat e punëtorëve që angazhohen jashtë orarit të punës/kujdestari, si dhe për nevoja tjera për ndihmë të menjëhershme familjeve në nevojë sociale.
- Rritja e buxhetit të Qendrës për Punë Sociale, tek kategoria e shpenzimeve -mallra dhe shërbime.
- Sigurimi i një veture për nevojat e Institucionit, pasi që me një veturë të vetme nuk po arrijmë t'i kryejmë të gjitha shërbimet në terren.

Përfundimi

Qendra për Punë Sociale, kujdeset për banorët e Komunës sonë në nevojë për shërbime sociale dhe ndihmë financiare, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni dhe orientime tjera. Shuma e të hollave që shpërndahen përmes këtij Institucioni brenda një viti kalendarik është rreth **1.1 milion euro**, duke përfshirë këtu familjet përfituese të Asistencës Sociale, familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta si dhe familjet që kanë në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare. Konsiderojmë se, edhe përkundër disa sfidave, periudhën që po raportojmë e kemi përmbyllur me sukses, krejt kjo falë punës së stafit të QPS-së, me punën dhe angazhimin e të cilëve është bërë realizimi i planit dhe detyrave të punës. Gjithashtu, falë edhe bashkëpunimit të mirë me DSHMS-në, DPSF-në, si dhe me Institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Mbesim me shpresë që angazhimi dhe bashkëpunimi në vitin e ardhshëm do të rritet, në mënyrë që të arrihet në plotësi realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave për vitin 2025.

9. DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, gjatë këtij viti është preokupuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Gjatë periudhës vjetore 2024, në sektorin e shërbimeve publike, nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej: **363 kërkesa**, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe disa rrugica nëpër lagje të qytetit, riparimin e gropave në rrugët me asfalt, furnizimin me ujë dhe riparim të ujësjellësit, riparimin dhe kyçjen në kanalizim, leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, kërkesat për ndriçimin publik dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, pastrimin e rrugëve nga bora, si dhe kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimor dhe material ndërtimor për ndërtim apo renovim të shtëpive. Varësisht nga mundësitë buxhetore, jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

Përshkrimi	Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01.01.2024 – 01.01.2025 D.SH.P.E
Pranuar	2
Në Proces	0
Miratuar	287
Refuzuar	57
Hedhur Poshtë	7
Pezulluar	5
Ceduar	0
Anuluar	5
GJITHSEJ	363

Ndërsa, sa ju përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për këtë vit, shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2024:

- **Trajtimi i qenve endacakë**

Qentë endacakë janë problem i gjithë Kosovës. Komuna e Klinës është ndër komunat e pakta të Kosovës që ka lidhur kontratë për trajtimin e qenve endacakë. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka lidhur kontratë me shumën 30,000 €, ku janë trajtuar, sterilizuar, shëruar, larguar dhe ushqyer qentë endacakë. Është bërë kastrimi i tyre dhe janë mbajtur, ushqyer dhe mbikëqyrur deri në shërimin e plotë të tyre. Pastaj, ata janë lëshuar përsëri në vendin ku janë kapur. Atyre ju ka kaluar tërbimi dhe rreziku nga ta, çka ka rezultuar në një sukses për ne, sepse janë eliminuar shumë rreziqe për qytetarët.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i kamerave të qytetit**

Është bërë zgjerimi i rrjetit të kamerave dhe vendosja e tyre në vende të reja. Tek salla “Adem Jashari” janë vendosur pesë kamera dhe është bërë mirëmbajtja e kamerave. Kontrata është lidhur më 18.04.2024 dhe është me vlerë 15,000 Euro.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik**

Gjatë këtij viti, në këtë kontratë kemi punuar në shumë fshatra për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, si p.sh., Zllakuqan, Volljakë, Rudicë, Ujmirë, Rixhevë, Gllarevë, Jagodë, Budisalc, Grabanicë, Gjurgjevik i Vogël, Deiq, Zajm dhe në Klinë dhe lagjet përreth qytetit. Kjo kontratë ka përfunduar në gusht të vitit 2024.

Kontrata e re për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në komunën e Klinës është lidhur më 27.09.2024 dhe është kontratë dyvjeçare.

- **Shtrimi i rrugëve fushore**

Gjatë vitit 2024, kemi vazhduar me shtrimin e rrugëve me zhavorr. Operatori ekonomik ka punuar në fshatin Gllarevë, në Jashanicë te lagjja e Hotëve dhe te varrezat, në Jashanicë te lagjja e Shpatve dhe varrezat e kuqve, në Jashanicë te lagja Haziraj dhe Isenaj, në Resnik tek rruga e Arave, dhe në Resnik te rruga e varrezave të fshatit dhe varrezat e martirëve, në Poterq, Gjurgjevik i Vogël, Rixhevë te varrezat e fshatit, Shtupel, Çabiq, Grabanicë, Zllakuqan, Krushevë e Madhe në rrugë fushore dhe po ashtu te lagjja me komunitet, në Gremnik, Dollovë, Qeskovë dhe në fshatra të tjerë. Kjo kontratë ka përfunduar në fund të vitit 2024.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit**

Qyteti i Klinës ishte qyteti më i dekoruar në krahasim me qytetet tjera. Patëm numër të madh të qytetarëve që vinin edhe nga qytetet tjera, posaçërisht nga qytetet fqinje, për të kënaqur me atmosferën e krijuar për më shumë se një muaj rresht. Ka qenë kontratë trevjeçare dhe ka përfunduar me këtë vit.

- **Mirëmbajtja e stacionit të autobusëve në Klinë. Shërbime dhe siguri në stacionin e autobusëve të Klinës**

Komuna e Klinës ka lidhur kontratë ku kemi kërkuar që të ketë siguri dhe mirëmbajtje në stacionin e autobusëve. Kompania ka angazhuar punëtorë që kanë bërë mirëmbajtjen e objektit dhe stacionit në tërësi, duke u përkujdesur për rampën, personat dhe linjat e autobusëve sipas detyrave të përcaktuara në kontratë.

- **Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik**

Komuna ka investuar **206,550€** dhe ka lidhur kontratë më 08.05.2024, duke intervenuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik. Kemi zgjeruar ndriçimin në fshatra dhe pjesë ku nuk kishte ndriçim më herët, si p.sh., fshatrat Dush, Sferkë, Qupevë, Poterq, çabiq, Zabergjë, Përqevë, Radulloc, Zajm, Qeskovë, Bokshiq, Këpuz, Krushevë e Madhe dhe do të vazhdojmë në vitin 2025 në fshatrat Krushevë e Vogël, Drenoc, Leskoc etj.

Komuna ka lidhur kontratë me titull: **“Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbra (parqeve) në Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc”** lidhur nga komuna e Klinës më datën 12.06.2024, me nr. bazë 55-2024, me nr. protokolli 01/352-18993/24, me nr. prokurimi 634-24-4343-5-2-1, me vlerë 36,150.00€ dhe me plan dinamik 30 ditë. Kontrata në fjalë është ekzekutuar në fshatin Caravik dhe përfshijnë hapësirën rekreative për fëmijë, restaurimin e kronit të vjetër të fshatit, shtigjet e ecjes, ulëset dhe ndriçimin e parkut dhe ndriçimin e rrugës kryesore nga parku deri te shkolla fillore, si dhe gjelbërimin e ulët dhe të lartë. Kontrata është përfunduar.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka ekzekutuar edhe një kontratë me titull: **“Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbra (parqeve) në Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc”** lidhur nga komuna e Klinës me datën 10.06.2024, me nr. bazë 54-2024, me nr. protokolli 01/352-18730/24, me nr. prokurimi 634-24-4352-5-2-1, me vlerë 27,799.19 € dhe me plan dinamik 30 ditë. Kontrata në fjalë është ekzekutuar në fshatin Zajm dhe përfshijnë hapësirën e shtigjeve të ecjes, gjelbërimin e ulët dhe të lartë, ulëset dhe ndriçimin, gjithashtu rregullimin e kanalit për ujërat atmosferike. Kontrata është përfunduar.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka kontratë me titull **“Rindërtimi i infrastrukturës mbiotokësore me asfalt në Jashanicë-Shtupel-Resnik-Klinë-Videjë ”**, lidhur nga komuna e Klinës më datën 26.03.2024, me nr. bazë 22-2024, nr. protokolli 01/351/9907/24, me vlerë 224,475.00 €. Kemi punuar në fshatrat Shtupel, Jashanicë, Klinë, kryesisht me punimet e sanimeve të asfaltit, rikonstruimin e kabëzave, vendosjen e gypave dhe kapakëve të pusëve. Kontrata është në realizim.

Komuna e Klinës ka lidhur edhe kontratë me titull: **“Ndërtimi i rrethojave të varrezave në Zajm, Dobërdol, Sferkë, Gllarevë, Ujmirë”** lidhur nga komuna e Klinës më datën 16.06.2024, me nr. bazë 57-2024, me nr. protokolli 01/351-18933/24, me nr. prokurimi 634-24-4242-5-2-1, me vlerë 129,940.00€ dhe me plan dinamik 12 muaj. Deri tani është punuar në fshatrat Dobërdol dhe Ujmirë. Kontrata është në realizim.

- **Mirëmbajtja e drunjve dekorativë**

Në qytet kemi rreth **200** trupa të drunjve dekorativë, duke filluar nga sheshi “Ndue Perlleshi”, “Mujë Krasniqi”, “Nënë Tereza” e deri te sheshi “Faruk Elezaj”. Duke qenë se për tre vite rresht kjo pjesë e qytetit ishte në ndërtim për shkak të punimeve të tunelit dhe kalldrëmit, drunjët kishin pësuar dëmtime të mëdha. Prandaj, është dashur që në mënyrë profesionale të trajtohen të gjithë këta drunj, duke filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimi i tokës përreth, etj. Tani pemët kanë marrë formë të mirë dhe të njëtrajtshme, kanë rritje të mirë dhe janë të shëndetshme. Vlera e kontratës është 12,972.00€ dhe kontrata është trevjeçare.

- **Marrëveshje me Fondin për Energji Efiçiente (FKEE) për shtimin e masave efiçiente**

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka aplikuar dhe ka arritur një marrëveshje të rëndësishme mes Komunës së Klinës dhe Fondit për Energji Efiçiente, përmes së cilës është siguruar një

investim prej 648,000 Euro. Ky investim ka si qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e disa banesave fituese në qytetin e Klinës, duke shtuar masat për energji eficiente dhe Komuna ka për te bashkëfinancuar vetëm 10%.

Ky investim do të mundësojë një rritje të cilësisë së jetesës për qytetarët, duke u dhënë mundësinë të përfitojnë dhe të kursejnë shpenzimet mujore për energjinë elektrike dhe ngrohjen, ku do të ndërrohen dritaret, dyert, izolim me 12cm stiropor, kulmi me pjesët e tij përbërëse dhe do të montohet një inverter për ftohje-ngrohje të hapësirës, si dhe disa punë tjera përcjellëse. Për më tepër, ky projekt është në përputhje me angazhimet për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e emetimeve të gazrave serë, duke pasur një ndikim pozitiv në klimën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Klinës.

Drejtoria e Shërbimeve Publike është koordinatore dhe po vazhdon të punojë në mënyrë aktive për realizimin e këtij projekti dhe do të sigurojë mbështetje për qytetarët e përfshirë, duke i udhëzuar ata për të shfrytëzuar plotësisht mundësitë që ofron ky investim. Drejtoria e Shërbimeve Publike ka aplikuar edhe për ndërtesa tjera në Fondin për Energji Efiçiente dhe është në pritje të përgjigjeve për mbi 20 ndërtesa të tjera publiko-kolektive.

- **Furnizim me pajisje dhe mjete pune për zjarrfikësit**

Edhe këtë vit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka investuar në furnizimin e mjeteve për ndërhyrje të zjarrfikësve, duke u furnizuar me 1 hidrant, 2 fiskaja, 1 fshesë për mirëmbajtje dhe 1 vinç kran për tërheqje, të cilin e kanë montuar në kamion dhe maska kundër tymit.

- **Furnizim me uniforma për zjarrfikësit**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë edhe furnizimin e zjarrfikësve me uniforma, duke kuptuar angazhimin dhe punën e rrezikshme që bëjnë zjarrfikësit tanë. Ne kemi bërë një furnizim me uniforma duke i ndërruar uniformat e vjetra të tyre, të cilat në terren kanë pësuar dëmtime.

- **Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza Zllakuqan-Jashanicë-Gllarevë**

Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në fshatin Gllarevë, një projekt shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm, ka përfunduar.

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Gllarevë ka qenë një nga premtimet e kryetarit Elezaj. Vlera e kontratës është 245,996.00€.

- **Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe parqeve, trotuareve**

Komuna e Klinës ka lidhur marrëveshje më datën 22.02.2024 për kryerjen e shërbimeve të kërkuara sipas kontratës, me pastrimin e shesheve dhe hapësirave gjelbëruese, me kompaninë

KRM “AMBIENTI”, njësia operative në Klinë. Kompania ka kryer me sukses shërbimet e kërkuara nga Komuna e Klinës, duke përfunduar obligimet e dhëna. Kontrata është trevjeçare.

- **Njësia e Zjarrfikësve në Klinë**

NJPZSH në Klinë, gjatë kësaj periudhe kohore, aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2024 dhe, si zakonisht, ka arritur t’i përmbush me sukses objektivat e parapara me plan.

NJPZSH ka vazhduar ta mbajë nivelin e gatishmërisë për reagime në rast nevojë edhe për raste emergjente për periudhën e lartcekur.

Ne jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrës që na obligojnë ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës.

NJPZSH është përgjigjur në thirrjet për raste emergjente sipas obligimeve dhe me kapacitetet tona ekzistuese, si dhe jemi përgjigjur me kohë qytetarëve të dëmtuar dhe kemi lëshuar vërtetime për zjarret (dëmet) e ndodhura.

Në NJPZSH në Klinë, disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës janë në nivel. Ndërrimet janë kryer sipas orarit të paraparë dhe niveli i gatishmërisë, si zakonisht, ishte në nivel të lartë për t’ju përgjigjur kërkesave-nevojave të qytetarëve të komunës sonë dhe më gjerë sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuese.

Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH gjatë periudhës janar-dhjetor janë paraqitur në tabelarin që pason:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve të tjera janar-dhjetor 2024:														
2024	Nr. i përgj. i daljeve	Nr. i zjarreve	Nr. Teknik	Nr. i shërbimeve	Aksident e rrugore	Vërs hime	Të reshjeve	Të lënduar			Të vdekur			Githsej
Janar	7	6	0	0	1	0	0	0	2	0	0	1	1	7
Shkurt	39	38	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	39
Mars	24	21	1	1	1	0	0	0	2	2	0	1	0	24
Prill	19	15	3	1	0	0	0	0	5	5	0	0	0	19
Maj	6	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
Qershor	7	5	1	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	7
Korrik	39	31	5	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	39
Gusht	69	61	5	2	1	0	0	0	1	0	1	0	0	69

[illegible]

10. DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

Gjatë vitit 2024 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal, udhëzimet administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë që dalin nga to. Të gjitha këto janë realizuar sipas Planit të Punës, të aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2024, siç vijon:

Spektori për Financa

- Gjatë vitit 2024, në zyrën e Bizneseve janë regjistruar 141 biznese të reja, përfshirë 42 biznese individuale, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar 99, si dhe biznese të shuara 35.
- Gjithashtu janë lëshuar edhe 62 licenca për taksë, 18 aktvendime të linjave për itinerar të autobusëve, dhe 6 aktvendime të zgjatjes së orarit për biznese.
- Janë lëshuar më se 75 akte administrativo-juridike që ndërlidhen me Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
- Janë lëshuar 18 certifikata të gjendjes ekonomike.
- Janë certifikuar të gjitha pagesat për mallra e shërbime dhe për punë.
- Janë lëshuar 16 aktvendime për shfrytëzimin e hapësirës komunale.
- Janë lëshuar 13 vërtetime për pension.
- Janë lëshuar 28 vendime pas shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave .
- Janë bërë të gjitha zotimet për shpenzimet e bëra gjatë vitit.
- Janë realizuar pagesa për taksa komunale për vetura dhe për automjete të rënda.
- Është bërë regjistrimi i rregullt i të hyrave vetanake të paguara përmes arkës dhe bankës.
- Është bërë regjistrimi i pasurisë komunale në Freebalance.
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave me Departamentin e Thesarit në baza mujore.
- Janë bërë kërkesa për alokim të të hyrave sipas realizimit dhe buxhetit të planifikuar;

Spektori për Buxhet

Janë përgatitur dhe lëshuar 1,713 aktvendime të ngarkesave me taksën për licenca të subjekteve afariste që operojnë në komunën e Klinës në vitin 2024, të cilat aktvendime ju janë dorëzuar të gjithë obliguesve të taksave në afatin e paraparë ligjor.

Për borxhin e papaguar janë dërguar 279 vërejtje për biznese dhe 99 vërejtje për lokale dhe banesa.

Një vendim është marrë gjatë vitit 2023, por që ka pasur për bazë vitin 2024. Falja e qirasë për banesa është bërë për 12 muaj, vetëm për ata që janë të rregullt me pagesa sipas vendimit të Kuvendit Komunal 01Nr.06-43414/2023. Në vitin 2024 është liruar një banesë (personi në fjalë nuk ka borxhe dhe është në parapagim).

Në këtë sektor, problem kyç është mosregjistrimi i disa subjekteve afariste që operojnë ilegalisht në komunën tonë dhe ato që i kanë mbyllur subjektet afariste, por nuk ju kanë nënshtruar procedurave ligjore të çregjistrimit, që paraqesin problem serioz gjatë ngarkesave

vjetore të atyre subjekteve që nuk kanë sjellë prova të dëshmuara për ndërprerje të veprimtarisë, respektivisht të mosaktivitetit afarist të tyre. Në koordinim me organet tjera relevante kompetente, si Inspektoratin Komunal, është punuar në zgjidhjen e këtij problemi.

- Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2023;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për të gjitha programet;
- Janë përgatitur Pasqyrat financiare 2024;
- Janë bërë raporte financiare periodike gjatë vitit;
- Është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2025;
- Shkresat për Ministrinë për EF në lidhje me transferet brenda programeve dhe kërkesat të ndryshme për realizim të projekteve;
- Është bërë evidencimi i tyre sipas programeve dhe kodeve ekonomike në Excel;
- Barazimi i rregullt i shpenzimeve me MF në baza tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore.
- Regjistrimi taksës komunale në biznes etj

Spektori i tatimit në pronë

Spektori i Tatimit në Pronë gjatë periudhës janar- dhjetor 2024 ka kryer këto punë:

Vlera e tatimit të faturuar për njësi të objekteve për vitin 2024 është 404, 360.33 €

Vlera e tatimit të faturuar për njësi të parcelave për vitin 2024 është 648, 579.05 €

Vlera Totale e tatimit të faturuar për vitin 2024 për objekte dhe parcela është 1, 052,939. 38 €.

Gjatë kësaj periudhe të vitit fiskal janar- dhjetor 2024, nga ZTP janë inkasuar gjithsej 550, 999.44 €, që është 59,537.16 € më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Nëse krahasojmë tatimin e faturuar dhe tatimin e inkasuar për vitin 2024, del se kemi inkasuar afërsisht rreth **52.32 %** të tatimit të faturuar.

Gjatë vitit 2024 kjo zyrë ka kryer edhe shumë punë të tjera, si: lëshimi i certifikatave dhe lëshimi i faturave apo kartelave financiare për qytetarë, pra për persona fizikë dhe juridikë.

Po ashtu, në vitin 2024 është bërë verifikimi i pronave në terren nga anketuesit. Janë verifikuar kryesisht zona e parë, e dytë dhe e tretë.

Prej tyre, regjistrime të reja (objekte të reja) të cilat tatimohen për herë të parë janë 308, të verifikuara me ndryshime 628, modifikimi i të dhënave të tatimpaguesit 1904.

Ankesat për tatimin në pronë

Të gjitha ankesat e vitit 2024 janë shqyrtuar. ZTP i ka pranuar gjithsej 53 ankesa të natyrave të ndryshme. Prej tyre, 42 janë aprovuar, 10 janë refuzuar dhe 1 është aprovuar pjesërisht. Kërkesat e pranura janë 32 të natyrave të ndryshme, prej tyre 27 janë aprovuar dhe 5 janë refuzuar.

Zyra e Tatimit në Pronë gjatë vitit 2024 ka verifikuar edhe tatimpaguesit me borxhe mbi shumën 300 € dhe ka marrë vendim. Më poshtë keni tabelën me vlerat e tyre:

	Viti 2024		
Masat e mbledhjes së detyruar të ndërmarra nga komunat	2024	Janar-Gusht 2024	0
Letërkujtesa	232		232
Kontrata për pagesë me këste	3		3

Si brengë që është paraqitur gjatë këtij viti vlen të përmendet se te tatimi në pronë për objekte ka pasur zbritje. Po ashtu, është ngarkuar tatimi për toka bujqësore, ku qytetarët kanë paguar më pak, sepse shumica e qytetarëve nuk i kanë pronat në emër të tyre. Disa ndërmarrje që janë privatizuar dhe ato që janë në proces të privatizimit nuk kanë qasje të duhur, së bashku me MEF-in, për inkasimin e mjeteve financiare të tatimit në pronë të objekteve, qoftë të privatizuara, apo ato që janë në proces të privatizimit, e që organi kompetent i privatizimit nuk e detajon se cili obligues mbetet përgjegjës për kryerjen e këtyre obligimeve tatimore.

Risi tjetër te tatimi në pronë janë edhe ngarkesat për shfrytëzuesit faktikë, që në fakt nuk janë pronarë juridikë të pronave. Ky problem lidhet më së shumti me pronarët e nacionalitetit joshqiptar, pronat e të cilëve shfrytëzohen nga persona të tjerë që dëshirojnë t'i shmangen ngarkesave të tilla.

Pastaj, rast tjetër që na pengon në këtë drejtim është se kamata e precizuar sipas ligjit nuk merret përsipër nga obliguesi faktik dhe juridik i pronarit legjitim, qoftë ai person fizik apo juridik.

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2024

Për të analizuar realizimin e buxhetit për vitin fiskal 2024, do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore, si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetorë të vitit paraprak. Shtojca e Raportit Financiar të vitit 2024 i bashkëngjitet këtij raporti.

Në Zyrën e Thesarit është tejkaluar planifikimi i realizimit të pagesave të certifikuara gjatë vitit 2024 sipas Buxhetit të aprovuar në vlerë prej: **14,548,717€**.

Në çështjen e pagesave të Zyrës së Thesarit, mendojmë se gjatë këtij viti janë realizuar në përputhshmëri me Planin e Punës së vitit 2024 dhe në afat të paraparë .

Gjatë vitit 2024 vlen të ceket se realizimi i të hyrave dhe shpenzimi i buxhetit, si në projekte kapitale dhe kategoritë tjera buxhetore, është realizuar në aspektin më pozitiv gjatë periudhës dhjetëvjeçare të raportimit.

Ka dhe shumë çështje që duhet të cekën, por në tërësi mendojmë që ky vit kalendarik ka qenë një vit i realizimit të plotë të objektivave tona të planifikuara dhe në disa raste edhe të tejkaluara.

Me këtë raport jemi përpjekur që në pika më kryesore t'i përfshijmë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë që i kemi të përcaktuara sipas ligjeve aplikative në fuqi, me kusht që në të ardhmen këto obligime t'i rrisim, si në aspektin cilësor, ashtu edhe sasior.



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-4995 /25

Klinë: 12.02 /25

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 07.02.2025

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e 12-të të rregullt për vitin 2025, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në Kuvend këto pika:

Pika 1. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2024.

-Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, i cili theksoi se: Viti 2024 ka qenë vit i realizimit të shumë projekteve të dobishme dhe të nevojshme për qytetarët, vit i realizimit të synimeve dhe objektivave të planifikuara, në përputhje me planin e punës dhe strategjinë zhvillimore. Në këtë raport janë të përfshira të gjitha punët të cilat janë kryer nga secila drejtori veç e veç. Raporti i punës ka nevojë për disa përmirësime, por deri në seancë do të sjellim draftin me përmirësime.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2024, rekomandoi që i njëjti të përmirësohet aty ku është e nevojshme dhe të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i raportit të konsultimeve publike për periudhën janar-dhjetor 2024.

-Kryesuesi theksoi se, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, raportin e konsultimeve publike për periudhën janar-dhjetor 2024 kemi obligim ligjor që ta shqyrtojmë në Kuvend, ku në këtë raport përfshihet puna e cila është bërë lidhur me të gjitha konsultimet publike të cilat i ka zhvilluar Komuna e Klinës gjatë vitit 2024 për Draft-Buxhetin e komunës për vitin 2025, si dhe akte të tjera për të cilat janë mbajtur konsultime publike.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të konsultimeve publike të mbajtura gjatë vitit 2024, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt janar-shkurt 2025.

Kërkesë e parashtruar nga z.Granit Hyseni nga Klina, me anë të së cilës kërkon t'i mundësohet marrja në shfrytëzim e një pjese të parcelës përafërsisht 15 ari, parcela 546-1 ZK Klinafc. Gjithashtu thekson se: shprehem i gatshëm që në rast të marrjes së një pjese të kësaj parcele të lartshënuar, jam i gatshëm të paguaj taksat dhe të lidh marrëveshje ashtu siç i përcakton ligji.

-Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga z. Granit Hyseni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit, ku do të veprohet sipas Ligjit Nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

-Po ashtu, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë të ndërmarrë masa lidhur me qentë endacakë të cilët janë në numër të shumtë dhe po rrezikojnë qytetarët e Komunës së Klinës. Po ashtu të raportoj në Kuvend lidhur me masat e ndërmarra dhe trajtimin e tyre.